



LUFTA KUNDËR BULLIZMIT DHE EKSTREMIZMIT NË SISTEMIN ARSIMOR NË SHQIPËRI

Studim Kombëtar mbi Bullizmin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm në Sistemin Arsimor Shqiptar

RAPORT STUDIMOR

Autorizuar nga: **Këshilli i Evropës**

Autorët: **Edmond DRAGOTI (Prof. Dr); Emanuela ISMAILI (Dr.)**

TIRANA, 2017

Këshilli i Evropës: 2017

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet,
riprodhohet ose përcillet në asnjë formë apo me
asnjë mjet, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.)
apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, rregjistrimin
apo çdo sistem ruajtje ose nxjerrjeje informacioni,
pa pasur miratimin paraprak me shkrim nga
Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasburg
Cedex ose publishing@coe.int).

Ky dokument u prodhua me ndihmen financiare të
Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk mund
të merren në asnjë mënyrë si përfaqësim i opinionit
zyrtarë të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të
Evropës.

Publikuar në kuadër të Projektit “Lufta Kundër
Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në
Shqipëri” të Instrumentit Horizontal të Bashkimit
Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin
Perëndimor dhe Turqinë.

KONTEKSTI

"Studimi kombëtar mbi bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në sistemin arsimor shqiptar" është autorizuar nga Këshilli i Evropës për të adresuar mungesën e të dhënave aktuale dhe të besueshme në lidhje me natyrën dhe prevalencën e fenomenit të bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në kontekstin arsimor shqiptar dhe për të siguruar një bazë nga ku të ndërmerren veprime/ ndërhyrje të bazuar në të dhëna.

Ky studim gjithëpërfshirës, i kryer nga ndërveprimi i përbashkët i Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Departamentin e Punës Sociale dhe Politikave Sociale dhe Institutit të Studimeve të Opinionit Publik (ISOP), synon të sigurojë informacion në nivel kombëtar, rreth asaj se çfarë është bullizmi dhe sjelljet ekstremiste, format që ata marrin, nga cilët praktikohen, ndaj kujt drejtohen, dhe motivet pse kanë ndodhur. Përveç kësaj, studimi jep informacion rreth ndërhyrjes që duhet të ndërmarrin shkollat për të luftuar bullizmin dhe sjelljet ekstremiste.

Për të pasur një panoramë të plotë të problemit dhe për ta parë atë nga këndvështrime të ndryshme, rezultatet e këtij studimi sasior janë marrë nga tre burime: nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

FALENDERIMET

Instituti i Studimit të Opinioneve Publik-ISO dëshiron të falënderojë të gjithë individët që dhanë kontributin e tyre në këtë studim, veçanërisht mësuesit, nxënësit dhe prindërit për kohën e tyre, kontributin dhe motivimin për të marrë pjesë në studim. Gjithashtu, një falënderim special i shkon dymbëdhjetë Drejtorive Rajonale Arsimore të çdo qarku për gatishmërinë që treguan dhe mbështetjen që dhanë përgjatë këtij studimi.

Për më shumë, ne do donim të falënderonim disa njerëz që dhanë kontributin e tyre në këtë projekt:

- Hartuesen e kampionit: Rudina Rama (Prof.As. Dr.)
- Statisticienen: Aida Guxho (Dr.)
- Supervizorët e punës në terren: Fiona Todhri (Prof.As.Dr.); Irida Agolli (Prof.As.Dr.); Eris Dhamo (Dr).

AKRONIMET

KE	Këshilli i Evropës
FF	Luftëtarët e Huaj
IED	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
ISOP	Instituti i Studimit të Opinionit Publik
REA	Autoriteti Rajonal Arsimore
RED/EO	Zyrat Rajonale Arsimore/ Zyrat e Arsimit
ROBVQ	Pyetësi i Rishikuar i Agresor/ Viktimë e Oleusit
UN	Kombet e Bashkuara
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
VE	Ekstremizmi i Dhunshëm
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

LISTA E GRAFIKËVE

- Grafiku 1 Ndarja e nxënësve sipas kategorive
- Grafiku 2 Shpërndarja e nxënësve sipas nivelit të shkollës
- Grafiku 3 Shpërndarja e nxënësve sipas llojit të shkollës
- Grafiku 4 Shpërndarja e nxënësve që ushtrojnë bullizëm sipas klasës dhe gjinisë
- Grafiku 5 Nxënësit që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë, sipas gjinisë
- Grafiku 6 Nxënësit që kanë ushtruar bullizëm ndaj një nxënësi tjetër 2-3 herë në muaj ose më shumë, sipas gjinisë
- Grafiku 7 Nxënësit të cilët janë agresor gjithashtu edhe viktima të bullizmit (të dyja ndodhin 2-3 herë në muaj ose më shumë)
- Grafiku 8 Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë
- Grafiku 9 Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë dhe gjinisë
- Grafiku 10 Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë dhe klasës
- Grafiku 11 Prevalenca e bullizmit sipas llojit të shkollës
- Grafiku 12 Prevalenca e bullizmit sipas rajonit
- Grafiku 13 Format e bullizmit sipas nxënësve të cilët raportuan se kishin pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë
- Grafiku 14 Format e bullizmit midis vajzave të cilat raportuan se kishin pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë
- Grafiku 15 Format e bullizmit midis vajzave të cilët raportuan se kishin pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë
- Grafiku 16 Format e bullizmit sipas nivelit të shkollës (2-3 herë në muaj ose më shumë)
- Grafiku 17 Format e bullizmit sipas llojit të shkollës (2-3 herë në muaj ose më shumë)
- Grafiku 18 Nxënësit viktima të bullizmit ndaj një formë të vetme bullizmi sipas gjinisë (2-3 herë në muaj)
- Grafiku 19 Kohëzgjatja e bullizmit e raportuar nga nxënësit të cilët kishin pësuar bullizëm 1-2 herë ose më shumë
- Grafiku 20 Gjinia e nxënësve të cilët kanë pësuar bullizëm dy tre herë në muaj ose më shumë dhe e atyre që ushtrojnë bullizëm ndaj tyre
- Grafiku 21 Vendet ku ndodh bullizmi, të raportuara sipas nxënësve (nga nxënësit të cilët kanë pësuar bullizëm 1-2 herë ose më shumë)
- Grafiku 22 Vendet ku ndodh bullizmi, të raportuara sipas gjinisë (për nxënësit të cilët pësojnë bullizëm 1-2 herë ose më shumë)
- Grafiku 23 Raportimi i bullizmit sipas gjinisë së nxënësve (që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë) dhe vendi ku kanë raportuar
- Grafiku 24 Ku kanë më shumë besim nxënësit, sipas klasës (që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë)
- Grafiku 25 Nxënësit të cilët kanë frikë se mund të pësojnë bullizëm në shkollë
- Grafiku 26 Ndërhyrja: Nxënësit të cilët kanë thënë se nxënësit e tjerë në shkollën e tyre përpiqen të ndalojnë një incident bullist në shkollë
- Grafiku 27 Ndërhyrja: Nxënësit të cilët raportuan se mësuesit apo të rriturit e tjerë në shkollë janë përpjekur të ndalojnë një incident bullist në shkollë
- Grafiku 28 Ndërhyrja: Nxënësit të cilët kanë thënë se prindërit janë përpjekur për të ndaluar një incident bullist në shkollë (nga prespektiva e viktimës dhe agresorit)
- Grafiku 29 Ndërhyrja në bullizëm: Agresorët që raportuan se të rriturit në shkollat e tyre përpiqen të flasnin me ta për sjelljen e tyre
- Grafiku 30 Mësuesit sipas ndarjes gjinore
- Grafiku 31 Mësuesit sipas eksperiencës në punë
- Grafiku 32 Mësuesit sipas pozicionit në punë
- Grafiku 33 Mësuesit sipas sektorit
- Grafiku 34 Prevalenca e bullizmit sipas perspektivës së mësuesve

- Grafiku 35 Format e bullizmit sipas perspektivës së mësuesve
- Grafiku 36 Bullizmi virtual sipas mësuesve
- Grafiku 37 Sjelljet bulliste sipas gjinisë
- Grafiku 38 Vendet ku ndodh bullizmi sipas mësuesve
- Grafiku 39 Motivet nxitëse të bullizmit
- Grafiku 40 Numri i incidentëve bulliste në shkollë
- Grafiku 41 Ekzistenca e një politike anti-bulliste
- Grafiku 42 Trajnimi i mësuesve
- Grafiku 43 Niveli i besimit të mësueseve për ekzistencën e një udhëzuesi kundërbullizmit në nivel kombëtar
- Grafiku 44 Ndërhyrja në shkollë: çfarë kishin bërë shkollat kur kishte ndodhur një incident bullist në shkollat e tyre?
- Grafiku 45 Besimet e mësuesve rreth dhunës dhe intolerancës
- Grafiku 46 Prevalenca e sjelljeve ekstremiste/intolerante në shkolla
- Grafiku 47 Strategjitë për parandalimin e ekstremizmit dhe intolerancës në shkolla sipas mësuesve
- Grafiku 48 Niveli i shkollë së fëmijës
- Grafiku 49 Moshë/ klasa e fëmijës
- Grafiku 50 Lloji i shkollës së fëmijës
- Grafiku 51 Gjinia e fëmijës
- Grafiku 52 Prevalenca e bullizmit sipas perspektivës së prindërve
- Grafiku 53 Format e bullizmit sipas prindërve
- Grafiku 54 Bullizmi virtual sipas prindërve
- Grafiku 55 Vendet ku ndodh bullizmi sipas prindërve
- Grafiku 56 Raportimi i bullizmit nga prindi
- Grafiku 57 Burimet ku prindi raporton
- Grafiku 58 Burimet ku do të raportojnë në të ardhmen (prindërit në total)
- Grafiku 59 Prindërit të cilët kanë shpesh frikë se fëmija i tij po pëson bullizëm në shkollë
- Grafiku 60 Niveli i besimit të prindit tek shkolla dhe veprimet që shkollat kanë ndërmarrë kur prindërit kanë raportuar
- Grafiku 61 Strategjitë e parandalimit të bullizmit sipas prespektivës së prindërve

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Dallimet midis konflikteve normale midis bashkëmoshatarëve kundrejt incidenteve bulliste
Tabela 1.1.	Shpërndarja e numrit të shkollave sipas rajoneve
Tabela 2	Nxënësit të cilët janë përfshirë në bullizëm (total)
Tabela 3	Klasa dhe numri i nxënësve të cilët ushtrojnë bullizëm (2-3 herë ose më shumë)
Tabela 4	Përfshirja e nxënësve në fenomenin e bullizmit në të ardhmen
Tabela 5	Empatia e nxënësve me viktimat e bullizmit
Tabela 6	Përgjigjet ndaj incidenteve të bullizmit të bashkëmoshatarëve: ndërmarrja e veprimeve për të ndihmuar
Tabela 7	Ndërhyrja në shkolla sipas nivelit për të luftuar fenomenin e bullizmit
Tabela 8	Intolerance/ndjeshmëria gjinore në marrëdhëniet e ndryshme në shkolla

TABELA E PËRMBAJTJES

KONTEKSTI	3
FALENDERIMET	4
AKRONIMET	5
LISTA E GRAFIKËVE	6
LISTA E TABELAVE	8
I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	11
II. GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT	12
III. REKOMANDIME	14
1. Rekomandime për strukturat qendrore dhe vendore.....	15
2. Rekomandime për drejtoritë e shkollave	16
3. Rekomandime për mësuesit.....	17
4. Rekomandime për prindërit	18
1. HYRJE	20
1.1 Sfondi i studimit.....	20
1.2 Përkufizimi i bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.....	24
1.3 Përshtatja e instrumentit kërkimor, rrjedhimet kulturore dhe linguistike/ gjuhësore	26
1.4 Ekstremizmi i Dhunshëm	27
1.5 Kuadri ligjor mbi fenomenin e bullizmit	30
1.6 Kuadri ligjor në lidhje me ekstremizmin	34
2. METODOLOGJIA	39
2.1 Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore	39
2.2 Metoda kërkimore.....	39
2.3 Madhësia e kampionit	40
2.4 Instrumenti i studimit.....	41
2.5 Përkthimi i pyetësorëve në kontekstin shqiptar	42
2.6 Testimi në terren i instrumentit të Olweus mbi konsistencën e brendshme dhe të besueshmërisë test–ritest.....	43
2.7 Administrimi i pyetësorëve.....	44
2.8 Analiza e të dhënave sasiore	45

3. ANALIZA E TË DHËNAVE TË STUDIMIT	48
3.1 Përceptimi i nxënësve dhe qëndrimet e tyre mbi fenomenin e bullizmit.....	48
SESSION I: Të dhënat sociodemografike të kampionit të nxënësve.....	48
SESSION II: Shkalla e përhapjes së fenomenit të bullizmit sipas karakteristikave me të cilat ai shfaqet.....	49
SESSION III. Ndjenjat e nxënësve në lidhje me viktimën dhe agresorin dhe qëndrimet e tyre lidhur me veprimtaritë bulliste	62
SESSION I IV: Si reagojnë të tjerët?.....	65
3.2 Besimet, qëndrimet dhe sjellja e mësuesve ndaj bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.....	68
SESSION I: Të dhënat socio-demografike të kampionit të mësuesve	68
SESSION II: : Shkalla e përhapjes së bullizmit dhe karakteristikat me të cilat shfaqet ai.....	71
SESSION III - Strategjitë për të parandaluar bullizmin.....	75
SESSION IV: Ekstremizmi Dhunshëm.....	78
3.3 Perceptimet dhe qëndrimet e prindërve mbi bullizmin në shkollë.....	81
SESSION I. Të dhënat socio-demografike.....	81
SESSION II: Shkalla e përhapjes së bullizmit dhe karakteristikat me të cilat shfaqet ky fenomen	83
SESSION III: Perceptimi i prindërve për klimën e shkollës dhe besimin e tyre mbi rolin e shkollës për të luftuar bullizmin	85
4. DISKUTIME MBI GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT	88
4.1 Prevalenca dhe karakteristikat e dukurisë së bullizmit: (shpeshësia, format, motivet , vendndodhja, dhe raportimi)	88
4.2 Qëndrimet, besimet dhe reagimet e aktorëve të ndryshëm në shkollë (bashkëmoshatarët, mësuesit dhe prindërit) kundrejt sjelljeve bulliste.....	97
4.3 Qëndrimet dhe perceptimet që kanë mësuesit mbi ekstremizmin e dhunshëm në shkollë	100
4.4 Politikat dhe ndërhyrjet që përdor shkollat në trajtimin e rasteve të bullizmit.....	102
5. BIBLIOGRAFIA	106
6. Shtojcë	112
6.1 Frekuencat e Pyetësorit të Nxënësve.....	112
6.2 Frekuencat e pyetësorit të mësuesve	130
6.3 Frekuencat e Pyetësorit të Prindërve.....	164

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Sjelljet agresive dhe dhuna ndaj fëmijëve janë një problem serioz që rrezikon zhvillimin, mirëqenien e fëmijëve, çënojnë të drejtat themelore, dinjitetin dhe mund të rrezikojnë jetën e tyre.

Siguria e të gjithë pjesëtarëve në ambientin shkollor dhe mungesa e sjelljeve agresive është një kusht thelbësor për promovimin e një shkolle efektive që rrit mirëqenien akademike, emocionale dhe sociale të nxënësve të saj. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve thekson rëndësinë e mbrojtjes së cilësisë së jetës së fëmijës dhe të drejtën e tyre për tu edukuar në një mjedis të sigurt, pa dhunë, ngacmime dhe neglizhim.

Kuadri ligjor garanton të drejtën e fëmijëve për të mësuar në një mjedis pa dhunë dhe pa u diskriminuar. Paragrafi 3 i Neni 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndalet në të drejtën e fëmijëve për të gëzuar një mbrojtje të veçantë nga shteti, duke u shprehur në këtë mënyrë: *“Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi ..., që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.”*. Kjo mbrojtje duhet të ofrohet nga shteti në çdo mjedis ku rriten, zhvillohen dhe edukohen fëmijët.

Ky parim përforcohet në Kushtetutë nga sanksionimi i së drejtës për arsim (neni 57), duke garantuar ofrimin dhe realizimin e kësaj të drejte në mënyrë të plotë dhe të hapur për të gjithë. Shteti jo vetëm që ia njuh të gjithë shtetasve të drejtën për arsimim, por gjithashtu u njuh atyre të drejtën për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ai vetë ka detyrë t'i ofrojë.

Vendi ku ushtrohet e drejta për arsim është shkolla, e cila konsiderohet si vend i të mësuarit në paqe dhe harmoni. Shkollat janë një institucion i respektuar në Shqipëri, i ndjekur dhe vlerësuar nga të gjithë. Megjithatë, ka raste kur ndodhin ngjarje negative në shkolla, duke krijuar një mjedis të dëmshëm për fëmijët, si dhe për mësuesit, prindërit dhe komunitetin.

Duke marrë parasysh mjedisin kompleks dhe zhvillimet në mjediset e shkollës, si dhe efektet që ai ka për fëmijët, Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Departamentin e Punës dhe Politikave Sociale, Universitetin e Tiranës dhe ISOP-i kanë kryer një studim kombëtar “Mbi fenomenin e bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor shqiptar”. Ky studim synon të bëjë një analizë të thelluar të shkallës së përhapjes dhe natyrës së dukurisë së bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri.

Objektivat e studimit janë:

- Të përcaktohet shpeshësia dhe karakteristikat (llojet, shkaqet, vendndodhja; kohëzgjatja, raportimi) e bullizmit në sistemin arsimor;
- Të vlerësohet shkalla e tolerancës ndaj bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis aktorëve të ndryshëm në shkollë;
- Të përcaktohet niveli i qëndrimeve dhe besimeve ekstremiste midis aktorëve të ndryshëm në shkollë.
- Të identifikohen politikat dhe procedurat kundër- bulliste që ekzistojnë në shkollat shqiptare.

Për të marrë të dhëna të sakta dhe rezultate të besueshme, për këtë projekt në shkallë të gjerë shtrirje u miratua një qasje me teknika sasiore, e cila përfshin 2377 nxënës nga klasa e IV deri në klasën e XII, 3560 mësues dhe 970 prindër nga 144 shkolla në 12 rrethe të Shqipërisë. Ky shtrirje dhe shkallë e gjerë reflekton qëllimin e studimit për të arritur një përfaqësim të kënaqshëm në shkallë kombëtare, siç përmbledhet edhe më poshtë:

Pjesëmarrësit	Nxënësit Klasa e IV – XII	Mësuesit	Prindërit	Shkollat	Qarqet
Nr.	2377	3560	970	144	12

Studimi përdor tre pyetësorë të mirënjohur dhe të validuar, duke u fokusuar kryesisht në instrumentin e standardizuar të studimit të quajtur "*Pyetësori i Rishikuar Agresor/Viktimë e Oleusit*", (ROBVQ), e cila u aplikua për të mundësuar krahasime me studime të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Dy pyetësorët e tjerë janë hartuar nga ekipi hulumtues i bazuar në modelin e ROBVQ.

II. GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT

Gjetjet kryesore të studimit kombëtar me temë "*Studimi kombëtar mbi fenomenin e bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor shqiptar*" reflektojnë të dhënat e pyetësorëve të kryer në 144 shkollave nga 12 qarqet e Shqipërisë. Pikat kryesore të përgjigjeve treguan se:

- Afërsisht 19.4 % nxënësve pohuan se janë të përfshirë në fenomenin e bullizmit 2-3 herë në muaj ose më shumë, ku 9.7 % e tyre pohojnë se janë viktimë, 5.2 % janë agresorë dhe 4.3% janë edhe agresorë edhe viktimë.
- Një përqindje e lartë nxënësish, rreth 29 %, pohojnë se kjo gjë i ka ndodhur një ose dy herë në muajt e fundit.

Si e perceptojnë mësuesit dhe prindërit përhapjen e fenomenit?

- Ndërsa në anën tjetër 60 % e mësuesve pohuan se në shkollat e tyre ngjarje të tilla janë të pranishme.
- Për prindërit, fenomeni është gjithashtu i njohur, duke qenë se 23 % e tyre pranuan se fëmija i tyre kishte qenë viktimë e bullizmit.

Djemtë janë më shumë të përfshirë në dukurinë e bullizmit se vajzat

- Në të gjitha kategoritë djemtë janë më shumë të përfshirë në dukurinë e bullizmit krahasuar me vajzat. Por, djemtë pranojnë që janë më shumë agresorë (68%) sesa viktimë (52%) ndërsa vajzat pranojnë që janë më shumë viktimë (48%) sesa agresore (32%).

Kohëzgjatja e bullizmit

- Bullizmi duket të jetë më serioz se një incident i thjeshtë, duke qenë se 73% e nxënësve viktimë të bullizmit raportojnë se kjo dukuri zgjati "*një ose dy javë*", 13%

raportojnë se kjo dukuri zgjati “*pothuajse një muaj*”, ndërsa 6% e nxënësve viktimë raportuan se kjo dukuri zgjati “*disa vjet*”.

Përhapja e bullizmit sipas klasave dhe llojit të shkollës

- Klasa XI-të që i përket edhe moshës 15-16 vjeç është më shumë e përfshirë në dukurinë e bullizmit e ndjekur nga klasa e V-të që i përket moshës 10-11 vjeç.
- Nxënësit e shkollave private pohojnë se janë më shpesh të përfshirë në dukurinë e bullizmit, 26% kundrejt 20 % të nxënësve të shkollave publike.
- Në zonat rurale dukuria e bullizmit është më pak e pranishme duke qenë se 83 % e nxënësve pohojnë se nuk janë të përfshirë në dukurinë e bullizmit kundrejt 80% të nxënësve të zonave urbane.

Ku ndodh më shumë bullizmi?

- Vendi ku ndodhin më shumë fenomene të tilla është në klasë kur mësuesja nuk është e pranishme, 39 % e rasteve, dhe në oborrin e shkollës/ fushën e sportit, 38%. Ndërkohe 13% e nxënësve pohojnë se ky fenomen ka ndodhur në klasë ku mësuesja ka qenë pranishme

Format/ llojet më të përhapura të bullizmit

- Forma më e përhapur e bullizmit është ai psikologjik: “*Nxënësit e tjerë më kanë përgojuar ose kanë përhapur thashetheme të rreme rreth meje dhe janë përpjekur që të tjerët të më marrin inat*” në 45% të rasteve.
- I dyti është bullizmi verbal: “*Unë jam përqeshur, më janë thënë gjëra fyese, ose jam vënë në lojë nga një ose disa nxënës?*” në 37% të rasteve.
- Në vendin e tretë është bullizmi fizik “*Unë jam goditur, shkelmuar, shtyrë ose mbyllur brenda*” në 33 % të rasteve.
- Ndërsa forma më pak e përhapur është bullizmi virtual/ kibernetik me 15 %.

Pse ndodh bullizmi? A e raportojnë nxënësit?

- Arsyeja kryesore që mësuesit mendojnë se nxënësit bien pre e fenomenit të bullizmit është për *shkak të pamjes së jashtme (si mbipesha)*, në 73.4% e rasteve.
- Të dytët janë nxënësit që kanë *vështirësi në të folur* me 67.6% të rasteve dhe të tretët janë nxënësit që janë *fizikisht më të dobët se të tjerët* në 62.2% të rasteve.
- Pjesa më e madhe e nxënësve pohuan se raportonin (73%) kur ata ishin viktimë të këtij fenomeni dhe burimi kryesor i raportimit ishin prindërit dhe më pak ishin shokët/ shoqet; dhe mësuesit ishin në vendin e tretë.

A ka politika? A ka trajnime apo programe ndërgjegjësimi mbi fenomenin?

- Pjesa më e madhe e mësuesve në 56.1% të rasteve pohon se shkollat e tyre kanë një politikë kundërbulliste, ndërsa 27.1% pohuan se nuk e dinë nëse ekziston një politikë e tillë dhe 16.8% pohojnë se nuk e kanë një politikë.
- Por, rreth 86.6% e mësuesve e shohin të nevojshme të kenë një politikë kundërbulliste si thelbësore për një mjedis më të mirë për të gjithë nxënësit.
- Një numër i konsiderueshëm mësuesish pohuan se nuk kishin marrë trajnime për ta zgjidhur efektivisht bullizmin, në 77.2% të rasteve dhe 22.8 % e tyre pohojnë se kanë pasur trajnime të tilla.

A adresohet bullizmi nga stafi shkollor?

- Sipas prindërve, kur ata kishin raportuar në shkollë, që fëmija i tyre kishte qenë viktimë, 51 % e tyre raportuan se shkolla kishte marrë masa dhe këto masa kishin qenë efektive pasi bullizmi nuk ndodhi më.
- Por afërisht gjysma tjetër, 50%, pohojnë se shkolla mori masa por problemi nuk u zgjidh (35%) dhe 10% pohojnë se shkolla nuk mori masa ndërsa 4 % nuk dëshirojnë të përgjigjen.

Si ta parandalojmë bullizmin?

- Duke iu referuar mësuesve dhe prindërve, mënyra më e mirë për të parandaluar fenomenin e bullizmit është një politikë kundërbulliste në shkolla që të bëhet e njohur për të gjithë nxënësit, stafin shkollor dhe prindërit.
- Nevojiten gjithashtu fushata dhe trajnime të vazhdueshme për rritjen e vetëdijes, për t'u mundësuar atyre që preken të njohin praktikën dhe të raportojnë, si dhe të mundësojnë mësuesit që të merren me fenomenin dhe ta adresojnë atë në mënyrë efektive.

Si shfaqet dukuria e ekstremizmit të dhunshëm në shkollën tonë?

- Për sa i përket ekstremizmit të dhunshëm, mësuesit pohuan se ky fenomen akoma nuk përbën një problem në shkolla, vetëm një pjesë shumë vogël e mësuesve pohonin se ka intolerancë fetare/ gjinore dhe etnike midis nxënësve, midis vetë stafit shkollor dhe në marrëdhëniet mësues-nxënës, e cila duhet gjithsesi të adresohet.
- Mësuesit raportuan e 20 % (ose 1 në 5) përdorin terma ekstremiste dhe gjuhë urrejtje. Aksesit online dhe rrjetet sociale kanë tërhequr 19 % të nxënësve të cilët kenë akses ndaj materialeve ekstremiste, ndërsa midis mësuesve, vetëm 1 në 8 mësues raportojnë se përdorin tema ekstremiste ose "gjuhë urrejtje".
- Strategjia që mësuesit pohuan si më efektive për të ndaluar shfaqjen dhe përshkallëzimin e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm në shkollat shqiptare ishte *diskutimi me nxënësit për ekstremizmin e dhunshëm dhe pasojat e tij* me 88.5% të rasteve. Strategjia e dytë më efektive është *të mësuarit e nxënësve me teknika për zgjidhjen e konflikteve duke përfshirë ndërmjetësimin* me 87.7% të rasteve.

III. REKOMANDIME

Rekomandimi kryesor, që del natyrshëm nga gjithë trajtimi ynë i problemit të bullizmit në shkolla, është hartimi i një strategjie dhe zhvillimi i politikave bashkëkohore kundërbulliste në nivel kombëtar, të cilat do të synonin rritjen e sigurisë në shkollë dhe krijimin e një mjedisi mbështetës social. Ekzistojnë tre perspektiva të cilat paraqesin ide të ndryshme se çfarë është bullizmi, pse ndodh dhe si mund të parandalohet ose zvogëlohet ai. Ata janë:

- a) **Perspektiva individuale** - e cila e konsideron bullizmin si një problem individual, psikologjik dhe të sjelljes;
- b) **Perspektiva social-ekologjike** - e cila e konsideron bullizmin si një marrëdhënie ndërpersonale, një problem dinamik i cili shfaqet në statuset e ndryshëm dhe marrëdhënie të pabarabarta pushteti midis individëve dhe grupeve (sociale) në një kontekst të caktuar (ekologjik);

- c) **Perspektiva sistematike** - e cila e konsideron bullizmin si një problem kulturor dhe sistematik, që lidhet me dinamikën e pushtetit që buron nga të gjitha institucionet.¹

Kështu, duke e parë bullizmin nga ky këndvështrim ekologjik duket se ai është një çështje e organizimit të shkollës, një çështje zhvillimi profesional të mësuesve, një çështje burimesh dhe buxheti, një çështje sociale dhe marrëdhëniesh, një çështje që lidhet me familjen e nxënësve dhe një çështje komuniteti.

Adresimi i problemit nga ky këndvështrim i lejon mësuesit, bashkëmoshatarët, prindërit dhe anëtarët e komunitetit të jenë pjesë e zgjidhjes. Kështu, një përfaqje holistike ndaj bullizmit ka prirjen që të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e performancës akademike, në rritjen e notave të nxënësit dhe në përmirësimin e marrëdhënieve, të lidhjeve sociale brenda shkollës.

Shqyrtimi i literaturës sugjeron se ndërhyrjet më premtuese janë ato që marrin një qasje *mbarë shkollore*. edhe pse suksesi i tyre ndryshon nga një vend në tjetrin. Sidoqoftë, kur trajtohen në mënyrë efektive, politikat shkollore janë mjeti më i mirë për të parandaluar dhe trajtuar bullizmin. Një qasje e tillë do të kërkonte zhvillimin e programeve që synojnë:

- a) Krijimin e një klime pozitive dhe etike në shkollë që nxit sjelljet pro-sociale;
- b) Ofrimin e trajnimeve për stafin shkollor, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të identifikojnë dhe të reagojnë në mënyrë të përshtatshme ndaj shenjave të bullizmit;
- c) Krijimi i mjediseve fizike që kufizojnë shfaqjen e bullizmit;
- d) Rritja e vetëdijes në mesin e të rinjve se si funksionojnë mekanizmat e grupit dhe forcimi i aftësive të tyre në zgjidhjen e konflikteve; dhe
- e) Zhvillimi i strukturave anonime të raportimit, që nxënësit të kenë akses kur ndihen të kërcënuar.

1. Rekomandime për strukturat qendrore dhe vendore

1.1. Përgatitja e udhëzuesve /doracakëve për mësuesit dhe drejtuesit, në mënyrë që ata t'i identifikojnë dhe t'i trajtojnë sjelljet bulliste. Këta udhëzues a doracakë duhet të përgatiten nga bashkëpunimi i IZHA-s me Fakultet e Edukimit. Sjelljet bulliste dhe aspektet e ndryshme të saj të bëhen pjesë e programeve mësimore.

1.2. Për të siguruar që përpjekjet për të parandaluar bullizmin të jenë të suksesshme, i gjithë personeli i shkollës duhet të jetë i trajnuar për çështje të tilla, si: ç'është bullizmi, cilat janë politikat dhe rregullat e shkollës dhe se si duhen zbatuar ato. Prandaj në nivel vendor rekomandohet që, në bashkëpunim me DAR-in/ZA-në të bëhen trajnime me drejtues dhe me mësues për njohjen në baza shkencore të dukurisë, për pasojat e tij afatgjata, si dhe për njohjen e mënyrave më efikase për trajtimin e nxënësve.

¹ www.bullyingnoway.gov.au

2. Rekomandime për drejtoritë e shkollave

- 2.1.** Çdo shkollë duhet të rishikojë rregulloret e brendshme të saj, ku të përkufizohet qartë sjellja bulliste dhe e masave për parandalimin e saj.
- 2.2.** Çdo shkollë duhet të hartojë dhe të miratojë një program kundër bullizmit “mbarëshkollor”, ku nxënësit, mësuesit, por veçanërisht viktimat, të dinë sesi të reagojnë kur të ndodhë një dukuri e tillë. Programet efektive duhet të përqendrohen te njohuritë, te ndryshimi i qëndrimeve dhe te mësimi i aftësive përmes modelimit, luajtjes së roleve dhe praktikës. Zakonisht praktika ka treguar se kur një shkollë ka zgjedhur një program parandalimi, ndryshimet do të shfaqen pas tre vjetësh, prandaj duhet që përpjekja të jetë e vazhdueshme, por edhe durimi, gjithashtu.
- 2.3.** Çdo shkollë duhet të kryejë studime periodike mbi përhapjen e bullizmit dhe karakterisitkat me të cilat shfaqet kjo dukuri. Ky lloj studimi e ndihmon personelin e shkollës të zhvillojë një plan individual parandalimi dhe ndërhyrje në bazë të nevojave që shfaq shkolla. Gjithashtu, pasi shkolla të ketë adaptuar një program parandalimi, ajo duhet të kryejë vlerësime periodike, në mënyrë që të kuptojë se sa mirë po funksionon programi dhe se cilat pjesë nuk po funksionojnë dhe kanë nevojë për t’u ndryshuar.
- 2.4.** Çdo shkollë duhet të zhvillojë një kod etike, e cili përshkruan sjelljet pozitive që pritet të kenë anëtarët e komunitetit në shkollë. Ky kod vepron për të gjithë dhe vendos standarde sjelljeje dhe tregon tërësinë e sjelljeve të pritshme pozitive. Sot, në disa shkolla në botë zbatohet një kod të cilin nxënësit e firmosin e përmban pohimet e mëposhtme:
- ↳ Ne nuk do të shkaktojmë bullizëm te nxënësit e tjerë.
 - ↳ Ne do të ndihmojmë nxënësit që janë viktimë.
 - ↳ Ne do të përfshijmë në grupin tonë çdo nxënës që është përjashtuar.
 - ↳ Kur marrim vesh që dikush ka qenë viktimë e bullizmit, ne do t’i tregojmë mësueses, prindit dhe ndonjë të rrituri, por tek të cilët kemi besim.
- 2.5.** Është e domosdoshëm që çdo shkollë të zhvillojë një plan monitorimi të vazhdueshëm të “zonave të rrezikshme” (si: oborri, korridoret, dhomat e zhveshjes, tualetet etj) në shkollë dhe përreth saj. Nxënësit mund të jenë në rrezik të lartë për t’u sulmuar në mjedise ku ka pak ose aspak monitorim nga të rriturit. Një mjedis i sigurtë dhe mbështetës në shkollë mund të ndihmojë në parandalimin e bullizmit.
- 2.6.** Çdo shkollë duhet të krijojë një ekip përgjegjës për parandalimin e bullizmit (një grup i vogël me mësues të përkushtuar, me psikologun dhe me punonjës social të shkollës), të cilët duhet të zhvillojë rregullat dhe sanksionet kundër bullizmit, duhet të zhvillojë sisteme për të përforcuar sjelljet prosociale, si dhe të zhvillojë veprimtari që rrisin ndërgjegjshmërinë e shkollës dhe të komunitetit rreth dukurisë së bullizmit.
- 2.7.** Çdo shkollë duhet të ketë një strategji që të përkrahë dhe nxisë përfshirjen e prindërve në procesin e edukimit, si dhe të ndihmës në zhvillimin e veprimtarive dhe të projekteve kundër bulliste.

2.8. Çdo shkollë duhet të formojë një sistem konfidencial raportimi për nxënësit (viktima dhe vëzhgues), ku ata të raportojnë në mënyrë të sigurt pa frikën e hakmarrjes.

3. Rekomandime për mësuesit

3.1 Mësuesit duhet të zhvillojnë veprimtari në klasë, si dhe diskutime periodike në lidhje me bullizmin dhe dhunën. Këto veprimtari dhe diskutime do ta ndihmojnë mësuesin/mësuesen që të informohet rreth asaj se çfarë po ndodh në klasën e tij/e saj, por do të ndihmojë edhe nxënësit që të ndjehen të sigurt dhe të mbështetur. Diskutimet në klasë zakonisht duhet të jenë të shkurtra dhe të jenë të përcaktuara sipas një kalendari javor ose mujor.

3.2 Mësuesit duhet t'i përfshijnë nxënësit në vendosjen e rregullave kundër bullizmit në klasë dhe në mënyrën se si ata duhet të ndërhyjnë kur janë dëshmitarë të ngjarjeve të tilla. Nxënësit mund të marrin role drejtuese në shkollë për të promovuar një klimë respekti dhe përfshirjeje, të komunikojnë me bashkëmoshatarët rreth parandalimit të bullizmit dhe të ndihmojnë në zhvillimin e rregullave dhe të politikave kundër bullizmit në shkollë.

3.3 Në rastin e shfaqjes së një rasti bullizmi, ndërhyrja nga ana e mësuesit duhet të jetë e menjëhershme. Ajo duhet të fillojë që në minutën e parë që bëhemi të ndërgjegjshëm për të. Të gjithë mësuesit duhet t'u lënë fëmijëve të kuptojnë se ata kujdesen për ta dhe që nuk do të lejojnë asnjë që t'i keqtrajtojë. Duke ndërhyrë menjëherë dhe duke u marrë menjëherë me agresorin, mësuesit mbështesin në këtë mënyrë viktimën dhe vëzhguesit. Mësuesit duhet të përballen me agresorin në mënyrë private. Sfidimi i agresorit në sy të bashkëmoshatarëve mund të forcojë statusin e tyre dhe mund të çojë në një agresivitet edhe më të madh.

3.4 Është e rëndësishme që mësuesit të jenë të vetëdijshëm për praninë e bullizmit dhe të vënë re shenjat që shfaqin fëmijët kur janë viktima të fenomenit (Sullivan (2004); Rigby, 1997; Olweus, 1994). Sa më shpejt mësuesit arrijnë t'i vërejnë këto shenja, të cilat do t'i japim më poshtë, aq më pak pasoja do të ketë kjo sjellje negative të viktimave dhe të agresorit. Shenjat më të zakonshme që shfaq viktima janë si më poshtë:

- Pjesëtarët e klasës fillojnë të qeshin ose të shtyhen lehtësisht me njëri-tjetrin, kur një nxënës i caktuar i klasës ngrihet në mësim apo futet në klasë.
- Nxënësi duket i mërziur, i zemëruar ose i depresuar dhe ky humor i zgjat pa një shkak të caktuar.
- Nxënësi tërhiqet nga veprimtaritë që kryen klasa dhe dëshiron të lihet i vetëm.
- Kur një nxënës bien nga mësimet brenda një kohe të shkurtër. (Duke qenë se bullizmi bën që fëmija të ketë vështirësi në fokusim dhe përqëndrim)
- Papritur nxënësi ka pak shokë ose nuk dëshiron më të qëndrojë me grupin e miqëve.
- Ndryshimet në sjelljen e tij brenda klasës (për shembull, fëmija qëndron i tërhequr ose irritohet lehtësisht).
- Nxënësi shfaqet i tensionuar dhe i kafshon vazhdimisht thonjtë.
- Nxënësit bëjnë diçka që është jashtë karakterit të tyre.

- Nxënësit nuk dëshirojnë ta festojnë ditëlindjen në mjedisin e klasës.

3.5 Mësuesit duhet ta referojnë si agresorin, edhe viktimën te psikologu dhe tek punonjësi social i shkollës dhe të kenë një bashkëpunim të ngushtë me këtë të fundit.

3.6 Mësuesit duhet të zhvillojnë strategji në nivel klase për të shpërblyer nxënësit që shfaqin sjellje pozitive dhe që ndihmojnë viktimën si për: shembull mund të shpërndajnë certifikata mirënjohjeje.

3.7 Mësuesit duhet të caktojnë një takim si për prindërit e viktimës, ashtu edhe të agresorit, si dhe të kërkojnë që problemi të zgjidhet sa më shpejt të jetë e mundur. Agresorët përpiqen që t'i mohojnë veprimet dhe përgjegjësitë e tyre. Por duhet t'i kujtohet se sjellja e tyre nuk do të tolerohet dhe t'i tregohet se çfarë pritet që ata të ndryshojnë. Për agresorët është shumë e rëndësishme riedukimi i sjelljes së tyre. Pasojat të tilla, si heqja e privilegjeve, janë të detyrueshme të merren si masa ndëshkimi. Kur është e mundur, prindërit e agresorit duhet të ftohen që të ndihmojnë në krijimin e një plani veprimi.

3.8 Mësuesit duhet të dëgjojnë me vëmendje çdo ankesë të prindërve, nëse ata raportojnë se fëmija e tyre mund të jetë viktimë e bullizmit, në mënyrë që të hetojnë nëse kjo është e vërtetë dhe shohin nëse duhet të merren hapa të menjëhershëm.

3.9 Një element tjetër shumë i rëndësishëm, por që shpesh nuk merret parasysh nga mësuesi apo nga psikologu/ punonjësi social shkollor, është që, edhe pasi janë marrë të gjitha masat për të ndihmuar viktimën dhe për të ndëshkuar agresorin, sjellja e agresorit dhe siguria e viktimës duhet të monitorohen përgjatë gjithë kohës. Nëse agresori/agresorja nuk e ndryshon sjelljen e tij/e saj, pavarësisht përpjekjeve të personelit të shkollës, fëmija duhet të vendoset ose në një program alternativ, ose duhet të largohet nga klasa ose shkolla.

4. Rekomandime për prindërit

4.1 Prindërit nuk duhet të presin që fëmija i tyre ta zgjidhë vetë situatën. Ata asnjëherë nuk duhet të mos i kushtojnë vëmendje, t'i nënçmojnë ose t'i minimizojnë ankesat e fëmijëve se ata janë ngacmuar, janë fyer apo janë sulmuar fizikisht nga fëmijët e tjerë. Ndaj bullizmit duhen të merren masa të menjëhershme, sepse ai ka pasoja afatgjata të çdo individi të përfshirë në këtë dukuri mbarëshoqërore.

4.2 Prindërit duhet të bisedojnë në lidhje me atë që u ka ndodhur fëmijës së tyre. Ata duhet ta dëgjojnë të tërë tregimin, por pa e ndërprerë atë, të jenë të qetë dhe ta vlerësojnë atë që po thuhet. Ata duhet ta pyesin fëmijën e tyre për atë që ai / ajo do të donte të ndodhte, para se të bënin vetë ndonjë sugjerim.

4.3 Prindërit nuk duhet të ballafaqohen asnjëherë vetë me agresorin e fëmijës së tyre apo me familjarët e tij. Gjëja e parë që duhet të bëjnë gjithmonë është kontaktimi me shkollën, duke zbuluar nëse ajo është në dijeni të një rasti të tillë dhe, nëse po, a janë duke bërë diçka për ta trajtuar situatën. Prindërit duhet të kërkojnë të bëjnë gjithmonë

një takim me mësuesin kujdestar, me psikologun dhe me punonjës social të shkollës.

4.4 Prindërit duhet të jenë në dijeni të shenjave që shfaqin fëmijët e tyre, sepse ato mund të tregojnë se ai mund të jetë viktimë potenciale e bullizmit. Shumë nxënës që nuk parapëlqejnë të raportojnë se janë viktima të bullizmit, prandaj prindërit duhet të jenë vigjilentë që, nëse fëmijët e tyre shfaqin shenjat e mëposhtme, atëherë ka mundësi që ata duhet të kenë qenë viktima të mundshme të bullizmit.

- a. Lëndime fizike;
- b. Disa nga rrobat e fëmijëve mund të mungojnë ose janë të grisura;
- c. Gjërat personale të fëmijëve janë zhdukur;
- d. Humori që shfaqin fëmijët është i tejskajshëm;
- e. Fëmijët fillojnë të mos pranojnë a të kundërshtojnë që të shkojnë në shkollë;
- f. Fëmijët vijnë herët, kur kanë ndonjë takim ose mbledhje me shokët;
- g. Fëmijët u kërkojnë prindërve kërkojnë që t'i shoqërojnë për në shkollë;
- h. Fëmijët kanë shenja psikosomatike të pashpjegueshme, si dhimbje koke apo stomaku;
- i. Fëmijët mund të fillojë të urinojnë në krevat, të flenë pak ose të qajnë gjatë gjumit;
- j. Fëmijët ndalojnë së foluri për shokët ose për veprimtaritë e përditshme në shkollë etj;
- k. Fëmijët përdorin fjalor poshtërues, kur flasin rreth bashkëmoshatarëve të shkollës;
- l. Fëmijët kërkojnë para më shumë se zakonisht ose i vjedhin ato;

1. HYRJE

Ky studim jep dëshmi empirike për:

- ↳ Natyrën dhe shtrirjen e bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në sistemin arsimor shqiptar;
- ↳ Ndërgjegjësimin rreth bullizmit dhe strategjive dhe rrjeteve mbështetëse në dispozicion për të mbështetur nxënësit, shkollën dhe prindërit;
- ↳ Nivelin e qëndrimeve dhe besimeve ekstremiste midis aktorëve të ndryshëm në shkollë.

Rezultatet ofrojnë rekomandime të bazuara në dhëna për të lehtësuar politikë-bërësit dhe praktikuesit të hartojnë dhe zhvillojnë politika, rregulla dhe qasje kundërbulliste, të cilat duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe kuptimplota, për të siguruar që agresorët dhe viktimat nuk përjashtohen nga përvojat normative arsimore dhe zhvillimore.

Gjatë viteve të fundit, bullizmi është bërë një çështje kyçe për shkollat dhe politikat publike, nëse i referohemi shqetësimeve që kanë ngritur mësuesit, prindërit dhe vetë nxënësit. Prandaj, kjo është një çështje që kërkon vëmendjen dhe përpjekjen e shumë aktorëve për t'u identifikuar, adresuar dhe trajtuar siç duhet, në dobi të nxënësve të përfshirë në këtë dukuri.

1.1 Sfondi i studimit

Fenomeni i bullizmit në shkolla është një problem mbarë botëror në rritje që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, mediave, autoriteteve të shkollës dhe prindërve që janë të shqetësuar rreth mirëqenies dhe sigurisë së nxënësve (Moon, 2008). Bullizmi në shkolla ka ketë pasoja negative për klimën e përgjithshme të shkollës dhe për të drejtat e nxënësve për të mësuar në një mjedis të sigurt pa frikë. Megjithatë, ndonse vlerësohet të jetë problemi më i përhapur mbetet edhe më pak i raportuar në shkollë. Por, studiues si Pepler dhe Craig që e kanë parë bullizmin nga një prespektivë zhvillimore pohojnë se kjo nënkategori sjelljeje agresive meriton një vëmendje të madhe sepse fsheh shumë problem që lidhen me dhunën ndërpersonale.

Një numër i madh studimesh (Suckling & Temple, 2002; Olweus, 1993) kanë treguar se kjo sjellje merr forma të ndryshme të mëposhtme:

Bullizëm fizik, i cili është bullizëm që merr formën e abuzimit fizik (p.sh. grushtimi, shkelmimi, goditje të formave të ndryshme, shtytje, pështyrja, vjedhja ose shkatërrimi i sendeve a i pronës, si p.sh. vjedhje e lekëve, vjedhje ose shkatërrim i librave, i veshmbathjeve etj.). Bullizmi fizik është tipik për meshkujt, por nuk përjashtohet as tek femrat, të cilat mund të jenë viktimat e tij, por edhe pjesëmarrëse aktive, pra agresore.

Bullizëm verbal (p.sh.: sharjet, kërcënimi, përhapja e thashetheme dashakeqe, nofkat ofenduese etj.). Qëllimi i tij kryesor është degradimi i viktimës. Në shumë raste bullizmi verbal është veti e vajzave, të cilat e përdorin atë, si dhe teknikat e përjashtimeve sociale, për të sunduar të tjerët dhe për të treguar epërsinë dhe pushtetin e tyre.

Bullizëm social (p.sh., duke lënë një ose disa nxënës jashtë lojërave apo grupit bashkëmoshatar, duke i shpërfillur apo duke mos i ftuar në festat e klasës apo të shkollës, prishja e miqësisë etj.).

Bullizëm seksual (p.sh. sjellje seksuale e padëshiruar fizike ose verbale, që përfshin pohime seksuale eksplicite dashakeqe ose shënime seksualisht diskriminuese dhe kontakte të padëshirueshme fizike që bëhen nga dikush në një mjedisi edukativ që janë fyese dhe të pakëndshme për nxënësin dhe bëjnë që ai të ndjehet i turpëruar ose në siklet, ose ndërhyr në rezultatet e tij akademike etj.).

Bullizëm virtual/ kibernetik, i cili është bullizëm që ndodh nëpërmjet dërgimit të mesazheve të bezdisshme, shqetësuese dhe kërcënuese përmes telefonit apo internetit, nëpërmjet shërbimeve të rrjeteve sociale, nëpërmjet blogjeve e të tjera mjeteve të fushës kibernetike. Ai mund të bëhet edhe nëpërmjet ndërthurjes së njëkohshme të të gjitha mjeteve të sapo përmendura. Agresorët kibernetikë mund ta fshehin veten e tyre, kështu që viktimat e tyre provojnë mbi kurrizin e tyre edhe sulme anonime. Në përmbajtjen e këtij lloji bullizmi mund të futen edhe format e bullizmit emocional të ushtruar nëpërmjet kibernetikës, futen edhe thashethemet, postimi i informacioneve private, përjashtimi i dikujt nga faqja elektronike (on line), kontakti i padëshiruar kibernetik etj. Meqë interneti dhe rrjetet sociale elektronike po rriten, një gjë e tillë çon edhe në rritjen e bullizmit kibernetik, i cili mund të jetë po aq shkatërrues sa edhe bullizmi tradicional.

Gjithashtu, po sipas këtyre studimeve është vënë re se në këto veprimtari agresore janë të përfshirë drejtpërdrejt tri grupet e mëposhtme të individëve:

1. Në grupin e parë futen **agresorët**, të cilët janë edhe autorët e kësaj sjelljeje agresive. Oleusi (1991) ka argumentuar se karakteristikat kryesore të agresorëve janë impulsiviteti, agresiviteti, fuqia fizike dhe sjellja kontrolluese mbi të tjerët. Ata duket se kanë një perceptim pozitiv për dhunën dhe përdorin strategji kryesisht agresive për të administruar konfliktet e tyre personale, sepse nuk kanë aftësi zgjedhjeje për diçka ndryshe nga mënyra e zakonshme a tradicionale për zgjidhjen paqësore të konflikteve (Hoover, 1993; Wolke, 2004).
2. Në grupin e dytë futen **viktimat**, të cilët janë nxënësit që bien pre e bullizmit. Viktimat kanë prirje që të shfaqin nivele të larta të ankthit dhe të depresionit (Hodges & Perry, 1999). Ata zakonisht kanë vetëbesim të ulët dhe aftësi të dobëta sociale (Egan & Perry, 1998), nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimtaritë e shkollës (Kochenderfer & Ladd, 1997) dhe shfaqin shenja psikosomatike (Boulton & Smith 1994), kanë vështirësi për të besuar të tjerët, shfaqin agresion, kanë mungesë sigurie, rrinë të izoluar etj. Të gjitha shfaqjet e mësipërme mund të zgjasin edhe me vite të tëra.
3. Në grupin e tretë futen **agresor-viktimat**, të cilët janë fëmijët e përfshirë në sjelljet agresive së të dyja roleve, pra, ata sillen edhe si agresorë, edhe si viktimë. Ata përjetojnë pasojat dhe problemet më të mëdha në mesin e të gjithë fëmijëve të përfshirë në bullizëm, duke treguar vështirësi për përballimin e emocioneve negative apo të rrethanave problematike e të vështira, duke i kthyer problemet nga vetja. Për shembull, një vajzë që është viktimë e bullizmit fajëson veten dhe largohet nga veprimtaritë sociale, pra, vetizolohet. Por këta fëmijë shfaqin edhe sjellje problematike dhe negative, të cilat nuk i drejtohen vetes, por të tjerëve, gjë që e shfaqin nëpërmjet largimit nga shkolla, nëpërmjet sjelljeve agresive me të tjerët, nëpërmjet dëmtimit të sendeve personale të të tjerëve etj (Nansel, 2001; Juvenon, 2003; Veenstra, 2005; Arseneault, 2008; Georgiou & Stavrinides, 2013).

Termi bullizëm nuk njihet publikisht, por ai u bë i njohur nga një studiues i famshëm me emrin Dan O'Leary, një profesor i psikologjisë, i cili ishte i pari që kreu në vitin 1970 një studim intensiv mbi bullizmin që ndodhte ndërmjet nxënësve suedezë, duke përdorur metodat e tij të kërkimit (Koo, 2007). Ai zbuloi se rreth 17.6% e nxënësve skandinavë ishin përfshirë në këtë sjellje me pasoja serioze, të cilën ai e quajti bullizëm (Koo et.al., 2007).

Hulumtime të shumta janë kryer në shumë vende për të kuptuar frekuencën e bullizmit. Rezultatet tregojnë se një numër i konsiderueshëm nxënësish përjetojnë fenomenet në shumë vende, si: Norvegjia, Suedia, Danimarka, Finlanda, Gjermania, Spanja, Italia, Anglia, Skocia, Irlanda, Australia, Japonia, Kanadaja, Afrika e Jugut dhe SHBA. Është vlerësuar se 246 milionë fëmijë dhe adoleshentë përjetojnë dhunë në shkollë dhe ngacmim në një formë çdo vit. (UNESCO, 2017)

Në një studim të kryer nga Organizata Botërore e Shëndetësisë² në 43 vende, u zbulua se mesatarisht, 8% -13% e nxënësve të moshës 11-15 vjeç ishin viktimë të bullizmit. Dallimet gjinore janë parë në rreth një të tretën e shteteve dhe rajoneve. Në përgjithësi, djemtë kanë qenë më shumë viktimë, por gjetjet tregojnë se moshë është në element që lidhet me nivelet e viktimizimit për djemtë dhe vajzat. Bullizmi arrin kulmin në moshën 13 vjeç për vajzat dhe 11 vjeç për djemtë. Shkallën më të ulët të përhapjes së bullizmit e ka Armenia ku 1% e vajzave dhe 4% e djemve të nxënësve të moshës 13 vjeç ishin viktimë të bullizmit dhe Suedia, me 4% djem dhe 6% vajza. Ndërsa shkalla më e lartë u gjet në Lituani, ku 30% e djemve dhe 29% e vajzave raportuan se ishin viktimë të bullizmit. Në vende të tilla si Greqia, përqindja e fëmijëve të moshës 13 vjeç që pranojnë të jenë viktimë të bullizmit ishte 6% për vajzat dhe 7% për djemtë, në Kroaci 8% për vajzat dhe 11% për djemtë 13 vjeç. (HBSC, 2016)

Numri i studimeve të kryera në Shqipëri është i vogël, me tre studime kërkimore të disponueshme deri më sot, përkatësisht në vitet 2006, 2013 dhe 2015. Ku dy nga këto studime janë të fokusuara tek dhuna në shkollë, por jo veçanërisht në sjelljet bulliste. Gjithsesi, mungon një vlerësim i plotë i dukurisë së bullizmit në nivel kombëtar.

Në studimet ekzistuese, si studimi i vitit 2006 mbi dhunën ndaj fëmijëve në Shqipëri, i autorizuar nga UNICEF³, zbuloi se 48% e fëmijëve të intervistuar pranojnë se janë dhunuar fizikisht në shkollë nga shokët e tyre të shkollës. Nga 13.3% e fëmijëve që janë ngacmuar seksualisht në shkollë, 49.4% raportuan se agresori ishte një bashkëmoshatar, ndërsa të tjerët raportuan ngacmime seksuale jashtë mjedisit shkollor. Efektet psikologjike të dhunës komprometojnë mirëqenien emocionale të nxënësve, zhvillimin normal dhe modelet e dhunës. Më konkretisht, 13.4% e nxënësve raportojnë se kanë pasur mendime vetëvrasëse deri në katër herë. Një e treta e nxënësve raportojnë të përballen me pasiguri në shkollë për shkak të kërcënimit të dhunës nga nxënësit e tjerë.

Një tjetër studim me një kampion prej 1435 nxënësish, i realizuar nga Save the Children, në bashkëpunim me Fondacionin e Zgjidhjes së konflikteve dhe mosmarrëveshjeve (2013) zbuluan se 28% e nxënësve ishin pjesë e konflikteve serioze në shkollë dhe 42 % e tyre nuk ndjeheshin të sigurt në klasë.

² Healthy Behaviours in School Aged-Children 2013/14

³Tamo, A., Karaj Th. (2006) Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, Tirana, Albania
https://www.unicef.org/albania/sq/Dhuna_ndaj_femijeve_ne_Shqiperi.pdf

Në vitin 2015, një studim i kryer nga E. Ismaili, pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale, përdori një mostër prej 853 nxënësish (nga klasa VI deri në IX) dhe 11 mësues, në 11 shkolla 9-vjeçare në qytetin të Tiranës. Studimi zbuloi se 42.3% e nxënësve janë të përfshirë në dukurinë e bullizmit. Prej tyre, 12.9% ishin vetëm agresorë; 21.7% ishin vetëm viktimë dhe 7.7% ishin agresorë dhe viktimë. Forma më e përhapur e bullizmit ishte ai verbal, me 19, 3% të nxënësve që bien viktimë e këtij lloji bullizmi, dhe 12.7% janë viktimë të bullizmit psikologjik. Ky studim gjithashtu tregon se 64.1% e incidenteve bulliste ndodhin në klasë jo në prani të mësuesit/es dhe 29.5% e incidenteve bulliste shfaqen në oborrin e shkollës/ fushën e sportit.

Sipas të njëjtit studim, mësuesit pohojnë se edhe pse pranojnë se bullizmi është i pranishëm në Tiranë, shkollat nuk janë në të njëjtin nivel të mirëkuptimit. Për ta është më e vështirë të njihet fenomeni, i cili i bën mësuesit dhe drejtuesit e shkollës të konsiderojnë incidentet e ngacmimeve si raste të izoluara, prandaj nuk merren masa efektive për të reduktuar ose parandaluar ndodhitë e mëtejshme. Një numër i vogël mësime ndodhën pranuan të kenë marrë trajnim për të trajtuar një sjellje të tillë agresive dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre pranojnë të jenë të pa trajnuar dhe të pasigurt se si të reagojnë kur hasin incidente të tilla midis nxënësve. (Ismaili, 2015)

Studimet e paraqitura më lart tregojnë se sistemi i edukimit në Shqipëri po përballet sot me sfida të mëdha, kur i referohemi sigurisë në shkollë. Ndaj mund të themi se ky nuk është një mjedis i përshtatshëm ku synohet që nxënësit shkojnë për t'u arsimuar.

Dhuna dhe bullizmi në shkolla pengon të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve, duke përfshirë të drejtën e tyre për arsim dhe shëndetësi. Ka dëshmi të qarta se dhuna në shkollë dhe bullizmi kanë një ndikim negativ në performancën akademike, shëndetin fizik dhe mendor dhe mirëqenien emocionale të viktimave.

Efektet afatshkurtra dhe afatgjata të bullizmit, si për viktimat dhe agresorët, janë të mirë dokumentuara. Përfshirja në bullizëm ndikon në shëndetin fizik të të rinjve, duke rezultuar në simptoma somatike të tilla si dhimbje koke, stomaku dhe shpine (Due, Holstein, Lynch, Diderichsen, Gabhain, Scheidt, 2005), shqetësime psikologjike si: depresion, nervozizëm, vetmi dhe vetëvrasje për viktimat e këtij fenomeni (Haynie, Nansel, Eitel, Crump, Saylor, Yu, 2001) dhe në pasoja afatgjata ku përfshihen problemet me agresivitetin, dhunën, problemet me alkoolin dhe përdorimin e substancave (Kaltiala-Heino, Rimpelae, Rantanen, 2000). Të rinjtë e përfshirë në bullizëm raportojnë më shumë përvoja negative me shkollën, të cilat reflektohen në marrëdhëniet e dobëta me shokët dhe mësuesit.

Përveç kësaj, shumë studime në mbarë botën i kanë treguar qartë se efektet negative të bullizmit nuk shfaqen vetëm për nxënësin që është viktimë e tij, por edhe për agresorin. Studimet e profesor Olweusit na tregojnë se bullizmi ka pasoja afatgjata për agresorët. Kërkimet e tij treguan se 60% e djemve që kishin qenë agresorë nga klasa VI deri në klasën IX ishin dënuar për të paktën një krim në moshë të rritur krahasuar me 23% të burrave që nuk kishin qenë të tillë. Për më shumë, 35% deri në 40% e ish-agresorëve kishin tri ose më shumë dënime në moshën 24-vjeçare krahasuar me 10% të burrave që nuk kishin qenë agresorë.⁴

Pasojat e bullizmit në shkolla ndikojnë edhe tek nxënësit që janë vëzhgues të kësaj sjelljeje. Bullizmi, duke krijuar një atmosferë ankthi, frike dhe pasigurie që nuk përputhet me

⁴ Ericson, N. (2001). Addressing the Problem of Juvenile Bullying. Washington, DC: Office of Juvenile

të mësuarit, ka një ndikim negativ në mjedisin e gjerë të shkollës. Në një studim të bërë në vitin 2009 nga 4 studiues (Rivers, Noters, Poteat, Ashurst) në Britani, doli se bullizmi i pengon fëmijët që ta perceptojnë shkollën si një mjedis të sigurt, kurse shumë nxënës që janë shikues të kësaj dukurie përjetojnë ankth dhe kanë frikë se mos do të jenë ata viktimat e radhës. Shkollat shpesh aplikojnë metoda të pasigurta sikurse janë dëbimi i agresorit ose dërgimi i tij në një shkollë tjetër, duke e transferuar problemin diku tjetër, duke dështuar kështu që të merren me çështjet siç duhet.

Roli kryesor i shkollës është që të sigurojë një arsimim të përshtatshëm për të gjithë nxënësit. Një mjedis arsimor i qëndrueshëm dhe i sigurt është një kërkesë thelbësore për të arritur këtë qëllim. Sidoqoftë, nëse nuk trajtohet si duhet, bullizmi dëmton dhe dobëson shkollat dhe cilësinë e arsimit. Hulumtimet, sikurse u përmend, tregojnë se bullizmi mund të ketë efekte afatshkurtra dhe afatgjata në mirëqenien fizike dhe mendore të nxënësve, në angazhimin e shkollës, në vetëbesim dhe në aftësinë për të ndjekur ambiciet dhe interesat.

Bullizmi me bazë në shkollë mund të adresohet pozitivisht dhe në mënyrë të sigurt nëpërmjet një sërë masash dhe strategjish, nëpërmjet të cilave të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës janë të aftë të veprojnë në mënyrë efektive në trajtimin e kësaj sjelljeje. Ndërsa dihet mirë se faktorët familjarë dhe ato shoqërorë luajnë një rol thelbësor si në shkaktimin ashtu edhe në parandalimin e bullizmit, ndërkohë që edhe roli i shkollës në punën parandaluese është gjithashtu vendimtar dhe nuk duhet të nënvlerësohet.

Iniciativat e bazuara në shkollë ose mund të përforcojnë ndërhyrjet pozitive ose të ndihmojnë të luftojnë përpjekjet e pasuksesshme të prindërve për të ndryshuar sjelljet e papranueshme. Prindërit dhe nxënësit kanë një rol dhe përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme për të ndihmuar shkollën, për të parandaluar dhe trajtuar sjelljen e bullizmit në shkollë dhe për t'u luftuar çdo ndikim negativ brenda shkollës që kanë sjelljet bulliste të ndodhura diku tjetër.

Hulumtimet ndërkombëtare tregojnë qartë rëndësinë vendimtare të ekzistencës dhe zbatimit të një politike të shkollës që përcakton qasjen e shkollës në parandalimin dhe trajtimin e bullizmit. Një politikë kundër-bulliste, kur të zhvillohet dhe zbatohet në të gjithë komunitetin e shkollës, mund të jetë gur themeli në luftimin e sjelljeve të tilla.⁵

1.2 Përkufizimi i bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Bullizmi është një fenomen me ndikim të gjerë që prek jetën e nxënësve dhe atyre që i rrethojnë ata. Olweus e përkufizon bullizmin si më poshtë: "*Një person është viktimë e bullizmit kur ai ose ajo është i ekspozuar, në mënyrë të përsëritur dhe për një kohë të gjatë, ndaj veprimeve negative të një ose më shumë personash dhe ai ose ajo ka vështirësi ta mbrojë veten*"

Këshilli i Evropës (KE) e përkufizon bullizmin si: "*...sjellje agresive, e padëshiruar, në mesin e fëmijëve të moshës shkollore që përfshin një çekuilibër të vërtetë apo të*

⁵ Department of Education and Skills. (2013). "Anti bullying policy for primary and post primary school". Retrieved from: <http://www.solaschriost.ie/files/resource-Anti-Bullying-Procedures-for-Primary-and-Post-Primary-Schools-DWEC-Princ.doc>

perceptuar të pushtetit. Sjellja përsëritet, ose ka potencial për t'u përsëritur, me kalimin e kohës. Si fëmijët që janë viktimë dhe ato që janë agresorë mund të kenë probleme serioze dhe afatgjata ."

Dy përkufizimet e mësipërme mbi bullizmin përfshijnë tre karakteristika kryesore, përkatësisht:

- ↳ **Qëllimi**- Qëllimi i agresorit është që të dëmtojë dikë.
- ↳ **Përsëritja**-Agresori shpesh dhunon të njëjtën viktimë herë pas here dhe ngjarja e bullizmit ndodh më shpesh se 2 -3 herë në muaj.
- ↳ **Fuqia e paekuilibruar** - Një agresor zgjedh viktimë që ai apo ajo e percepton si më vulnerabël.

Rigby (2008) pohon që bullizmi është "*abuzimi sistematik i pushtetit në marrëdhëniet ndërpersonale*". Me fjalë të tjera, bullizmi ndodh kur një person është zgjedhur vazhdimisht nga një individ ose grup individësh me më shumë pushtet, qoftë në aspektin e forcës fizike apo të statusit shoqëror.

Përkufizimet e sipërpërmendur e bëjnë të qartë se dhuna është pjesë e bullizmit. Nga ana tjetër, gjithashtu duhet të pranohet se edhe pse bullizmi është një formë e dhunës, ajo ka shkaqe thelbësisht të ndryshme nga format e tjera të dhunës. Prandaj, parandalimi i bullizmit kërkon qasje të ndryshme trajtimi dhe parandalimi. Ekziston një vijë e hollë ndarëse midis bullizmit dhe dhunës dhe hulumtimet tregojnë se ka një rritje të numrin të nxënësve të cilët gjithnjë e më shumë përdorin dhunën gjatë kohës së bullizmit.

Bullizmi shpesh konsiderohet si një formë e dhunës fizike ose psikologjike, me shkaqe të ndryshme në krahasim me llojet e tjera të dhunës. Prandaj, është e nevojshme të kuptohet se çfarë është dhuna dhe si lidhet me bullizmin në mënyrë që të konceptohet akti i bullizmit. Tabela 1 ofron një pasqyrë të dallimeve ndërmjet dhunës dhe bullizmit

Tabela 1. Dallimet midis konflikteve normale midis bashkëmoshatarëve kundrejt incidenteve bulliste

Sjellje agresive	Bullizmi
Fuqi e barabartë-shokë	Fuqi e pabarabartë-jo shokë
Ndodh rastësisht	Veprime negative të përsëritura
Aksidental	I qëllimshëm
Reagime emocionale të ngjashme për të dyja palët	Reagime emocionale të fuqishme nga ana e viktimës
Agresori nuk është në kërkim të statusit apo të tërheqjes së vëmendjes	Në kërkim të fuqisë dhe të kontrollit
Agresori nuk përpiqet të marrë diçka	Kërkon të fitojë të mira materiale ose pushtet
Keqardhje-marrje përgjegjësish	Jo keqardhje—fajësim i viktimës

1.3 Përshtatja e instrumentit kërkimor, rrjedhimet kulturore dhe lingvistike/ gjuhësore

Megjithëse bullizmi në shkollë po bëhet një problem mbarëbotëror dhe një numër domethënës studimesh kryhen çdo vit, akoma ekziston një çështje që nuk po adresohet: si duhet të përkthehet dhe përcaktohet termi bullizëm?

Termi anglez "bully" e ka zanafillën që në shekullin XVI dhe vjen nga fjala "boele", që në holandisht dhe gjermanisht do të thotë "i dashur" (ose "sweetheart" në anglisht), prandaj përdorimi zanafillor ishte një term me kuptim pozitiv dhe zbatohet për të dyja seksat.

Në vitet 1600, ky term fitoi kuptimin që mban sot. "Bully" filloi të nënkuptonte një njeri "çapkën", "imponues", ose "gjaknxehët". Vetëm në shekullin XVII ky term fitoi kuptimin që mbart sot. Është një term i formuar nga një fjalë ose frazë e përshtatshme për biseda dhe situata informale në gjuhën angleze dhe në përgjithësi nuk ka kuptim të qartë në fjalët leksikore të gjuhëve të tjera.

Për shembull, në Francë, bullizmi i referohet "faits de violence" (veprimeve të dhunshme), dhe përfshin të gjitha format e dhunës në shkollë, si dhe të sjelljeve përçarëse që ndërhyjnë në veprimtaritë shkollore (Fabre-Cornali, 1999). Kjo formë e perceptimit të përkufizimit të këtij koncepti duket se shfaqet edhe në Poloni (Janowski, 1999), edhe në Gjermani (Lösel & Bliesener, 1999), ku përkthimi i drejtpërdrejtë i fjalës bullizëm nuk është i mundur dhe diskutimet përgjithësisht shfaqen brenda kufijve të kornizës së dhunës në shkollë.

Në Spanjë, Ortega dhe Mora-Merçan (Ortega & Mora-Merchan, 1999) jo vetëm që hasën vështirësi në përkthimin e termit bullizëm, por raportuan probleme në përkufizimin e termit brenda mjedisit të tyre kulturor, sepse koncepti ngacmim/ dhunë thjesht nuk ekzistonte brenda shkollës, kështu që ata u përballën me mungesën e përgjithshme të të kuptuarit social dhe me indiferencën. Kurse në Japoni fjala "jime", për shembull, ka një theks të madh në manipulimin social. Në të kundërt, fjalët italisht "prepotenca" (prepotenca) dhe "violenca" (dhuna) e vënë theksin më shumë te sulmet fizike.

Smithi, Kauji, Olafsoni dhe Lajfuge (Smith, Coëie, Ólafsson, & Liefoghe, 2002) e kanë studiuar këtë problem të përputhshmërisë së termit bullizëm në 14 vende të ndryshme dhe në 13 gjuhë. Rezultatet treguan një shumëllojshmëri të jashtëzakonshme, prandaj ata menduan se vlerësimet e shpeshtësisë së bullizmit në disa vende (si p.sh. në Itali) mund të fryhen për shkak të një përkthimi më gjithëpërfshirës të këtij termi. Kështu, pra duket se ka një mospërputhshmëri thelbësore në perceptimin e përkufizimit si koncept të termit bullizëm në kultura të ndryshme, e cila ngre çështjen, nëse krahasimi i të dhënave dhe i shkallës së shpeshtësisë në vende të ndryshme ka ndonjë përfundim kuptimplotë.

Sipas një raporti të lëshuar nga UNICEF (2005) për vendet e Ballkanit, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, në fjalorin e këtyre vendeve nuk ka një term të veçantë për të përshkruar dukurinë e bullizmit ("bullying"). Prandaj edhe mospasja e një termi të tillë të veçantë për këtë problem e bën atë të vështirë për t'u diskutuar dhe ekzaminuar.

Përgjithësisht, në komunitetin shqipfolës, kryesisht në Kosovë, për të përshkruar termin anglisht “bullying”, është parapëlqyer të përdoret togfjalëshi “ngacmim bashkëmoshatar”. Por ne mendojmë se ky term nuk i përfshin të gjitha karakteristikat dhe dukuritë e bullizmit. Edhe sipas studiuesve të tjerë të kësaj fushe, është hedhur ideja që të gjitha vendet që nuk janë anglisht folëse të përdorin termin “bullying” për ta njëjtësuar dhe në një farë mënyrë edhe për të bërë analiza krahasuese midis vendeve të ndryshme, gjë që në këto çaste është shumë i vështirë të kryhet.

Përgjithësisht, përpjekjet e studimeve të fundit ndërkombëtare janë orvatur që ta drejtojnë problemin e përkufizimit të “bullizmit” përmes përshtatjes dhe përkthimit të pyetësorit të Oleusit (Olweus), duke ruajtur fjalën bazë “bully” por duke i shtuar prapashtesës angleze -ing një prapashtesë që i përshtatet gjuhës së vendit ku po përkthehet. Mirëpo ky proces kërkon që gjatë administrimit të pyetësorit subjekteve në studim t’u shpjegohet shumë qartë se çfarë kuptohet me termin bullizëm (Tomas de Almeida, 2012). Edhe në këtë studim u përkrah kjo qasje. Termit “bullying” në anglisht do t’i përshtatet në shqip fjala “bullizëm”, duke i shtuar prapashtesën “-izëm”.

1.4 Ekstremizmi i Dhunshëm

Në këtë studim, termi "*ekstremizëm i dhunshëm*" përdoret sipas përkufizimit të dhënë nga UNESCO (2016)⁶:

"Ekstremizmi i dhunshëm i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të arritur pikëpamje radikale ideologjike, fetare apo politike. Pikëpamjet ekstremiste mund të ekspozohen përgjatë një sërë çështjesh, duke përfshirë politikën, religjionin dhe marrëdhëniet gjinore. Asnjë shoqëri, bashkësi fetare apo botëkuptim nuk është imun ndaj një ekstremizmi kaq të dhunshëm"

Ekstremizmi i dhunshëm manifestohet duke mohuar pikëpamjet e ndryshme, duke mbivlerësuar ekskluzivitetin e të menduarit personal, duke refuzuar ndryshimin, duke mohuar diversitetin dhe duke imponuar mendime personale, të gjitha përmes përdorimit të dhunës. Individët me pikëpamje ekstremiste e përdorin dhunën për të arritur qëllime politike, fetare apo shoqërore. Këto veprime të dhunshme mund të kryhen nga çdo individ ose grup me një varg besimesh dhe ideologjish⁷. Ekstremizmi i dhunshëm (VE) prodhon efekte negative për grupet individuale dhe shoqërore⁸. Shumë hulumtues dhe palë të interesuara bien dakord që përgjigja më e mirë institucionale ndaj VE është parandalimi dhe jo kundërshtimi i dhunshëm që përfshin dënimin ligjor.

Besimet ekstremiste, të ndërtuara mbi motivet radikale dhe ideologjike, ushqejnë qëndrime negative dhe sjellje të dhunshme. Obligueshmëria dhe mungesa e mundësive të përshtatshme për arsim shpesh i bëjnë njerëzit më të prekshëm ndaj indoktrinimit

⁶ The CoE project implementation team refers to the UNESCO definition on violent extremism, referring the document “A teachers’ guide on the prevention of violent extremism (PVE)” Published in 2016 by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, 7, place de Fontenoy, 75352 Paris 07 SP, France. Source: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

⁷ International Network for Education in Emergencies, Preventing Violent Extremism, web: <http://www.ineesite.org/en/preventing-violent-extremism>

⁸ Shembuj të VE: Neo-Nazis, Ku Klux Klan, eco-terrorism, Islamic State in Iraq and the Levant (ISIL), Boko Haram.

ideologjik dhe radikalizimit.⁹ Nxënësit, veçanërisht ata që janë në shkollën e mesme, janë objektiva ideale për rekrutimin e ekstremistëve të dhunshëm që kërkojnë mbështetje për ideologjitë e tyre radikale, rrjetet e Luftëtarëve të Huaj (FF), ose kryerjen e akteve të dhunës me target brenda kufijve tanë. Shkollat e mesme duhet të mbeten vigjilente në edukimin e nxënësve të tyre për katalizatorët që nxisin ekstremizmin e dhunshëm dhe pasojat e mundshme të përqafimit të besimeve ekstremiste.

Duke iu referuar Fjalorit të Gjuhës Angleze të Oksfordit (Oxford English Dictionary), fjala “ekstremist” përkufizohet si: Një individ me pikëpamje ekstreme politike ose fetare, veçanërisht dikush i cili mbështet veprime të paligjshme, të dhunshme apo ekstreme”. Ndërsa një kuptim i fjalës “radikal” është “përfaqësimi apo mbështetja e një seksioni ekstrem të një partie”. Në këtë kontekst, termi “radikal” mund të përdoret si sinonim për “ekstremist” dhe antonim i “moderuar”

Studimet dhe hulumtimet në terren tregojnë se ajo që i bashkon ekstremistët është izolimi dhe marginalizimi i tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Interneti dhe mediat sociale konsiderohen si burimet kryesore për ekstremizmin e dhunshëm dhe për vënien e ekstremistëve në kontakt me individë të përjashtuar nga shoqëria. Interneti siguron akses në burime të pafundme të propagandës së dhunshme që frymëzojnë të tjerët për veprim, duke ngitur lart stilet e jetesës ekstremiste ose duke përjetësuar përhapjen e urrejtjes dhe intolerancës. Ndërsa që individët konsumojnë propagandë të dhunshme, mund të rezonojnë me ta ose të përforcojnë idetë e tyre të perceptuara. Kjo nga ana e saj forcon bindjet e pikëpamjeve radikale, ose gatishmërinë për të përdorur dhunën në mbështetje të një ideologjie.¹⁰

Studimet mbi ekstremizmin e dhunshëm tregojnë se Shqipëria nuk po përballet me një kërcënim të dukshëm të ekstremizmit të dhunshëm për shkak të nivelit të lartë të tolerancës fetare¹¹ dhe gatishmërisë së popullatës për stabilitet shoqëror.¹² Ekstremizmi i dhunshëm gjerësisht perceptohet nga publiku si pjesëmarrja e disa Luftëtarëve të Huaj (FF) ISL nga Shqipëria në luftën e Sirisë. Megjithatë, prania e shqiptarëve FF¹³ në Siri dhe Irak solli në sipërfaqe ekstremizmin e dhunshëm dhe tërhoqi vëmendjen brenda dhe jashtë vendit. Shqipëria synon të jetë anëtare e Bashkimit Evropian dhe tashmë është anëtare e OKB-së, Këshillit të Evropës dhe NATO-s. Pjesëmarrja e numrit të vogël, por ende ekzistues të shqiptarëve në luftën siriane, ka një ndikim negativ në perceptimin e të huajve për shqiptarët si ekstremistë radikalë fetarë dhe të dhunshëm.

Studimet kanë treguar se arsytet shoqërore dhe ekonomike janë faktorët dominues që lehtësojnë zhvillim e islamit radikal në rajone të caktuara të Shqipërisë. "Luftëtarët e huaj" shqiptarë vijnë nga rajone të pazhvilluara si Pogradec, Elbasan, Bulqizë, Cerrik,

⁹ Omer Taspınar, “Fighting Radicalism, Not ‘Terrorism’: Root Causes Of An International Actor Redefined,” *SAIS Review* XXIX, no. 2 (2009), pp. 75–86.

¹⁰ FBI (2016). Preventing violent extremism in schools”. Unclassified document. Retrieved from: <https://info.publicintelligence.net/FBI-PreventingExtremismSchools.pdf>

¹¹ Albanian Institute for International Studies (2015) Assessment of risks on national security/ the capacity of state and society to react: Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania; Author: Enri Hide; AISS: Tirana, <http://www.aiis-albania.org/sites/default/files/Violent%20Extremism%20and%20%20Religious%20Radicalization%20in%20Albania.pdf>

¹² IDM (2015) Religious Radicalization and Violent Extremism in Albania, Authors: Vrumo, Gj., Lamllari, B. and A.Papa; <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>

¹³ 152 Shqiptarë kanë luftuar në Siri dhe / ose Irak në 2012-2015, nga këta 40 janë kthyer dhe 12 janë vvarë në aksion. Kjo panoramë nuk përfaqëson gratë dhe fëmijët që shoqërojnë Luftëtarët e Huaj në luftë. Burimi: Shtuni, Adrian (2015) Ethnic Albanian Foreign Fighters in Iraq and Syria, Combating Terrorism Venter at West Point, CTS SENTINEL April 2015, Vol.8, Issue 4, pg. 11-14; <https://www.ctc.usma.edu/posts/ethnic-albanian-foreign-fighters-in-iraq-and-syria>

Kukës dhe Dibër. Këta individë vijnë nga zonat më të varfra rurale, të cilat janë gjithashtu më të pazhvilluarat dhe më të izoluarat. Një numër i ngjashëm njerëzish vijnë nga rrethinat e pazhvilluara të qyteteve të mëdha si: Tirana, Durrësi apo Vlora.¹⁴ Këto rajone karakterizohen nga niveli i ulët dhe një cilësi e dobët arsimit, nga institucione të dobëta dhe nga një mungesë e mundësive sociale dhe ekonomike për të rinjtë.¹⁵ Mungesa e mundësive për arsim dhe analfabetizmi në zonat e thella luan një rol vendimtar në manipulimin fetar dhe ideologjik. Numri i shqiptarëve të përfshirë si xhihadistë konsiderohet të jetë rreth 140-150 individë¹⁶.

Shumica e FF besohet të jenë radhitur në krahun e radikalizimit nga propaganda ekstremiste e rekrutuesve radikalë që paraqesin veten si "OJF bamirëse" që u krijuan në të gjithë vendin në vitet 90, kur familjet dhe komunitetet e varfra ku ishin të pranishme këto organizata ju kërkua të përqafojnë pikëpamjet e tyre radikale në këmbim të ndihmës ekonomike.¹⁷

Në përgjithësi, procesi i radikalizimit, veçanërisht në mesin e të rinjve, ka shumë të ngjarë të jetë ndikuar nga një numër arsyesh që lidhen me prejdardhjen socio-ekonomike, kulturore, politike dhe institucionale. Arsye të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: diskriminimin dhe përjashtimin real ose të perceptuar të shoqërisë, privimin, dinamikën e grupit dhe ndjenjën e aventurës, perceptimet e një sistemi ndërkombëtar armiqësor ndaj islamit, perceptimet e kërcënimeve më të gjera kulturore, korrupsionin endemik dhe mosndëshkimin për elitat, shkeljet e të drejtave nga autoritetet publike, mohimin e të drejtave politike dhe qytetare, si dhe mangësitë e mundshme potenciale të vendit, të tilla si: mbyllja e syrit ndaj ndërtimit të institucioneve fetare pa miratimin e shtetit dhe jashtë liderit fetar, si dhe mungesës së përgatitjes adekuate dhe ndikimi të liderave fetar¹⁸.

Radikalizimi zhvillohet në mjedise të ndryshme sociale, duke përfshirë edhe institucionet arsimore. Megjithatë nuk janë regjistruar raste të FF që nga viti 2014, fenomen i radikalizimit është ende i pranishëm në Shqipëri. Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm kërkon përpjekje të bazuara në kontekst, fuqizimin e sistemit arsimor dhe zgjerimin e edukimit qytetar me kulturën e tolerancës.

Sondazhi rajonal i kryer nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në korrik 2016 "Iniciativa për Parandalimin / CVE në Evropën Juglindore" ofron një pasqyrë dhe rekomandime për CVE në Shqipëri, duke vënë në dukje se disa nga faktorët që kontribuojnë në radikalizim¹⁹ janë: përjashtimi social, marginalizimi dhe një nevojë për përkatësi.

Bullizmi mund të nxisë me të vërtetë përjashtimin social dhe marginalizimin, dhe si i tillë, mund të krijojë një terren të mundshëm për ekstremizmin e dhunshëm. Hulumtimi

¹⁴ Albanian Institute for International Studies, Assessment of risks on national security/ the capacity of state and society to react: Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania, AIIS, Tirana 2015, Author: Enri Hide

¹⁵ Vurmo, Gj. and Lamallari, B. (2015) Religious Radicalism and Violent Extremism in Albania, Tirana: Institute for Democracy and Mediation. Available online at <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-ëeb-final.pdf>

¹⁶ Shtuni, Adrian (2015) Ethnic Albanian Foreign Fighters in Iraq and Syria, Combating Terrorism Center, published in April 30, 2015, <https://ëëë.ctc.usma.edu/posts/ethnic-albanian-foreign-fighters-in-iraq-and-syria>

¹⁷ Lamallari, Besfort (2016) Dealing ëith Returning Foreign Fighters, available at: file:///C:/Users/HP-pc/Doënloads/train_2016_dealing_ëith_returning_foreign_fighters_besfort_lamallari.pdf

¹⁸ Vurmo, Gj. and Lamallari, B. (2015) Religious Radicalism and Violent Extremism in Albania, Tirana: Institute for Democracy and Mediation. Available online at <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-ëeb-final.pdf>

¹⁹ Regional Cooperation Council (2016) Initiatives to Prevent/Counter Violent Extremism in South East Europe: A Survey of Regional Issues, Initiatives and Opportunities; Authored by: Valery Perry, RCC: Sarajevo; pg: 22-26, available at: [file:///C:/Users/FUJITSU/Doënloads/RCC-CVE-Case-Study%20\(3\)%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/FUJITSU/Doënloads/RCC-CVE-Case-Study%20(3)%20(1).pdf)

rekomandon marrjen e masave në nivel sistemi shkollor, si mekanizmi më i mirë për të parandaluar dhe kundërshtuar zhvillimin e pikëpamjeve ekstremiste.

1.5 Kuadri ligjor mbi fenomenin e bullizmit

Qëllimi i këtij seksioni është të analizojë kuadrin ligjor aktual të Shqipërisë në lidhje me bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Ai paraqet gjetjet mbi kuadrin ligjor, politikat, ligjet, strategjitë dhe aktet normative që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Një sistem që funksionon efektivisht me politika kundër bulliste kërkon një kornizë të qëndrueshme ligjore që përshkruan mënyrën se si janë përkufizuar dhe kuptuar çështjet. Një kornizë e tillë përcakton strukturat dhe mekanizmat dhe përcakton strategjitë, veprimet, procedurat dhe standardet.

Që në vitin 1990, Shqipëria ka ratifikuar një numër instrumentesh të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë ato për të drejtat e fëmijëve. Këto janë Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Çnjerëzore, Mizore dhe Poshtëruese; Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërshtetëror; dhe Protokollin Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve etj.

Aktualisht, nuk ka ligj të unifikuar për të luftuar bullizmin në shkollat shqiptare. Nuk ekziston asnjë akt ligjor për të trajtuar bullizmin, për të ofruar udhëzime për mekanizmat e zbatimit, për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nga bullizmi në çdo mjedis, ose për të trajtuar viktimat dhe agresorët.

Shkollat në Shqipëri nuk kanë strategji kundërbulliste ose politika të tilla. Rrjedhimisht, stafet e shkollave (mësuesi, drejtori dhe anëtarët e tjerë) nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi këtë fenomen dhe nuk kanë aftësitë e nevojshme për të ditur si të ndërhyjnë nëse bullizmi ndodh në shkollat e tyre. Kjo është një pasojë e drejtpërdrejtë e politikave dhe trajnimeve që mungojnë, të cilat do të përcaktojnë në veçanti rolin e mësuesve dhe të aktorëve të tjerë rreth fenomenit të bullizmit.

Në Shqipëri, termi "bullizëm" ka fituar njohje ligjore vetëm kohët e fundit, me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve²⁰, që e definon bullizmin si "dhunë mes fëmijëve". Neni 18 thotë: "MASH dhe DAR marrin masa për ngritjen e mekanizmave efikasë për të parandaluar, adresuar brenda shkollës dhe për të raportuar tek autoritetet përgjegjëse rastet e dhunës, duke përfshirë dhunën mes fëmijëve në shkollë (bulizem)" (paragrafi 3 pika g). Për këtë arsye, ligji e përcakton si një lloj dhune: "*dhuna që ndodh në mes fëmijëve në shkollë*".

Prandaj është e qartë se këtij përkufizim i mungon gjithëpërfshirja, pasi bullizmi është një formë e sjelljes agresive dhe mund të shkelë një numër të të drejtave të fëmijëve, jo vetëm një nga këto të drejta.

²⁰ Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Ligji Nr. 18/2017 date 23.2.2017, 2017, Nr. 43, pg.2815, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/09/ligj-nr.-182c-dt.-23.2.2017.pdf>

Legjislacioni vendos bazohet në standardet ligjore ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, BE dhe KE. Infrastruktura legjislative udhëhiqet nga Kushtetuta e Shqipërisë. Të drejtat e njeriut përmenden dhe mbrohen në mënyrë specifike në Kushtetutë, ku thuhet se *"të drejtat dhe liritë e njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme"* (neni 15/1). Prandaj, është e qartë se mbrojtja e të drejtave të njeriut është e garantuar dhe ligjërisht e imunituar nga shkelja në çdo mjedis apo shërbimi publik, duke përfshirë arsimin. Institucionet arsimore janë ligjërisht të detyruara të respektojnë të drejtat e nxënësve dhe të promovojnë aktualizimin e praktikave të tilla (neni 15/2)²¹. Kushtetuta garanton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit për të gjithë (neni 18). Nxënësit nuk mund të diskriminohen për arsye të tilla si gjinia, raca, feja, përkatësia etnike, gjuha, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimi, statusi shoqëror ose prindërimi. Nga perspektiva ligjore, fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kundër dhunës së mundshme (neni 54).

Sipas studimeve të kryera deri tani del se pjesa më e madhe e sjelljeve agresive ndodhin për shkak të paragjytimeve dhe të stereotipave që kanë nxënësit për klasat e ndryshme sociale, për racën, për fenë, për gjininë, për orientimin seksual, për pamjen e jashtme, për sjelljen, për gjuhën e trupit, për personalitetin, për nderimin, për forcën, për madhësinë fizike ose për aftësinë mendore.

Kështu, Shqipëria ka dy Institucione Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI) që garantojnë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, respektivisht: Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.²²

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi përbën institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (CPD).²³ Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. (neni 1).

Sipas ligjit, të gjithë janë të mbrojtur nga diskriminimi. Ndalohet diskriminimi në shkollë, qoftë nga nxënësit ndaj vetes apo nga mësuesit. CPD ka kryer një hulumtim brenda sistemit shkollor për nivelin e diskriminimit në shkollë dhe ka përgatitur një raport të veçantë mbi diskriminimin e nxënësve në shkollat e 6 rajoneve.²⁴

Sipas këtij raporti 17% e nxënësve dhe 6% e mësuesve kanë raportuar raste të diskriminimit në shkollë, ku orientimi seksual dhe identiteti gjinor (i perceptuar) ishin shkaku kryesor i diskriminimit. Bazuar në këtë studim, në vitin 2013, CPD rekomandoi MASH për të marrë masa për reduktimin e bullizmit në shkollat dhe për të futur edukimin mbi të drejtat e njeriut në programin shkollor. Për këtë qëllim, CPD nënshkroi një

²¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15/2: "Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.", <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2015/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>

²² NHRI zgjidhet nga Parlamenti dhe jep raporte vjetore dhe specifike për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimin. Ata kryejnë hetime në dy mënyra: nëpërmjet ankesave të viktimave ose përmes hetimeve, iniciativës së vet.

²³ Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr 10221, date 4.2.2010, Gazetë Zyrtare (Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi), <http://kmd.al/skedaret/1442237534-1308053956-Ligji%20per%20mbrojtjen%20nga%20diskriminimi.pdf>

²⁴ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2014b). "Diskriminimi në arsim" në këndvështrimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

memorandum bashkëpunimi me MASH për të përpunuar materiale informative për të drejtat e njeriut dhe antidiskriminimin për shkollat dhe rekomandoi një sërë masash për shkollat dhe drejtorët se si luftojnë diskriminimin dhe homofobinë.²⁵

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC)²⁶ është dokumenti më i rëndësishëm ligjor mbi të drejtat e fëmijës. Dispozitat e Konventës kërkojnë vendosjen e kushteve ligjore, institucionale, sociale dhe ekonomike për të garantuar gëzimin dhe ushtrimin e plotë e të drejtave të fëmijëve.²⁷

UNCRC përfshin një numër artikujsh që përfshijnë të drejtën e fëmijëve për arsim. Konventa kërkon që shtetet anëtare t'u sigurojnë fëmijëve një arsimim të përshtatshëm dhe të arritshëm në nivelin më të lartë (neni 28) dhe të sigurojë që programet shkollore të promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë dhe për identitetin kulturor dhe kombëtar të fëmijës (neni 29).

Parimi gjithëpërfshirës i nenit 12 (1) të UNCRC-së ofron një bazë tjetër kyçe për zhvillimin e arsimit në sistemet shkollore. Ajo pohon: "Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij." Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,²⁸ Karta Sociale Evropiane²⁹ dhe standardet e tjera ligjore evropiane janë baza e legjislacionit shqiptar për të drejtat e fëmijëve dhe përgjigjen institucionale për mbrojtjen e fëmijëve³⁰.

Shqipëria ka bërë përpertime të dukshme në vitin 2010 në drejtim të zhvillimit të bazës ligjore për ndalimin e të gjitha formave të dhunës, veçanërisht ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset, duke përfshirë edhe mjediset e shkollës. Neni 3 (c) i Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve përcakton "Dhuna psikologjike" përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën

²⁵ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Raport Vjetor 2015, Marrë nga: http://kmd.al/skedaret/1458135488-Raport%20Vjetor%202015_KMD.pdf

²⁶ UNCRC, <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>

²⁷ Shqipëria ratifikoi Konventën në vitin 1992, duke u angazhuar për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri dhe për të siguruar që dispozitat dhe parimet e KDF-së së OKB-së janë plotësisht të pasqyruara në ligjin e saj të brendshëm dhe që efekti i tyre ligjor të sigurohet në nivel kombëtar..

²⁸ ECHR, http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf, Albania ratified ECHR on 02/10/1996, https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/signatures?p_auth=uOk7LS05

²⁹ Shqipëria ratifikoi Kartën Sociale të Rishikuar në vitin 2002

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016805ac1a3>

³⁰ Këshilli i Evropës promovon dhe mbron të drejtat e fëmijëve në Evropë bazuar në KDF të KB. Standardet dhe mjetet kryesore ligjore të Këshillit të Evropës për ndërtimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve përfshijnë Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (Konventa Lanzarote), Konventën mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Konventën mbi parandalimin dhe luftimin Dhunës kundër dhunës në familje dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat e sipërpërmendura. Një mjet për mbështetje efektive për sistemet kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve është Këshilli i Evropës CM / Rekomandimi (2009) 10 për strategjitë kombëtare të integruara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Mjetet e tjera relevante të Këshillit të Evropës që mbështesin shtetet në ndërtimin e sistemeve kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve janë CM / Rekomandimi (2005) 5 mbi të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale, Rekomandimi (2006) 19 mbi politikën për mbështetjen e prindërimit pozitiv, CM / Rekomandimi) 12 për të drejtat e fëmijëve dhe shërbimet sociale miqësore për familjet dhe fëmijët, si dhe Udhëzimet për kujdesin shëndetësor miqësor për fëmijët (2012) dhe Udhëzimet për drejtësinë e fëmijëve (2010).

Neni 3 (ç) definon " ç) "Dhunë fizike" është çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, përfshirë edhe ndëshkimin trupor të tij, të cilat nuk janë aksidentale.

Përsa i përket abuzimit seksual, në nenin 24, ligji thotë se fëmija duhet të mbrohet nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual duke iu garantuar mbrojtja nga: (a) aktivitete seksuale të paligjshme; (B) prostitucioni ose praktika të tjera të paligjshme seksuale; (C) pamjen ose përfshirjen në materiale pornografike; Dhe (d) shitja e fëmijëve.

Neni 21 i të njëjtit ligj parashikon që fëmija të mbrohet nga çdo formë e: a) dhunës fizike dhe psikologjike; b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtëruës e denigrues; c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes; ç) keqtrajtimit dhe braktisjes; d) mospërfilljes dhe neglizhimit; dh) shfrytëzimit dhe abuzimit; e) dhunës seksuale. Përveç kësaj, neni 26 i Ligjit thotë: " Mbrojtja e fëmijës nga tortura, dënimi, trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtëruës"

Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", ndryshuar ligjin nr. 56/2015, garanton dhe mbron të drejtat dhe liritë e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi, si dhe siguron mbrojtje në rastet e dhunës dhe abuzimit. Në nenin 6 të këtij ligji, pikat 2 dhe 3 theksojnë: " Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti. 3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2015-2020 paraqet një hap të rëndësishëm përpara në lidhje me të drejtat e fëmijëve, duke nënvizuar nevojën për të koordinuar sistematikisht dhe harmonizuar politikat ndërsektoriale. Objektivat dhe masat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përqendrohen në mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik dhe synojnë jo vetëm mbrojtjen e fëmijëve, por edhe parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e formave të ndryshme të shfrytëzimit dhe abuzimit të fëmijëve.³¹

Instrumente të tjera themelore ligjore siç janë Kodi Penal, Kodi i Familjes, dhe një numër i ligjeve dhe vendimeve specifike që gjithashtu përmbajnë dispozita që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikojnë në respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga format e ndryshme të abuzimit.

Rëndësia e barazisë në fenomenin e bullizmit ka të bëjë me arsyet pse nxënësit janë sulmuar. Ai varion nga gjatësia, pesha, mosha, raca, gjinia, orientimi seksual, rrethanat socio-ekonomike, aftësia e kufizuar dhe nganjëherë vetëm perceptimi se një fëmijë është i pafuqishëm ose dobët akademikisht.

Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*: ka për qëllim të garantojë të drejtën për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislationin shqiptarë.

³¹ OBSH (2016). Analiza e situatës së parandalimit të keqtrajtimit të fëmijëve–progresi në të ardhmen"

Për të përfunduar këtë pjesë mbi kuadrin ligjor mbi fenomenin e bullizmit, mund të thuhet se e drejta për arsim është një e drejtë themelore e rëndësishme e njeriut, pasi ajo promovon ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të tjera themelore. Arsimi është një e drejtë e plotë dhe e përbërë që kërkon një qasje prioritare.

Shteti është i detyruar të respektojë, mbrojë dhe promovojë të drejtën për arsimin bazë. Në minimum, kjo do të thotë se shteti duhet të sigurojë lehtësira për gëzimin e të drejtave të fëmijëve dhe për të zhdukur elementet që shkelin gëzimin e plotë të së drejtës për arsim.

Në mënyrë ideale, fëmijët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga kjo e drejtë pa u penguar për ta bërë këtë.

Bullizmi në kontekstin e arsimit ka pasoja të rënda që ndikojnë negativisht tek të gjithë ata që përfshihen. Shkallëzimi i dhunës në shkollë është shkatërrues dhe kundërproduktiv ndaj edukimit të duhur.³²

1.6 Kuadri ligjor në lidhje me ekstremizmin

Mekanizmat ligjorë të hartuara për të luftuar terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm gjenden në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 28/2 të kodit: "*Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste*". Kapitulli VII i Kodit Penal përmban 17 artikuj të tjerë që përcaktojnë llojet e dhunës terroriste, krijimin dhe financimin e organizatave terroriste, rekrutimin dhe trajnimin e individëve me qëllim kryerjen e akteve të terrorizmit.

Neni 230 i Kodit Penal është ndryshuar për të përfshirë krimet me qëllime terroriste me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare duke përfshirë kështu: i) rrëmbimin e individëve; ii) dëmtime serioze ndaj pronës publike, infrastrukturës, sistemeve të transportit; rrëmbimin e avionëve, të anijeve, të mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse iii) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin apo tregtimin e lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë e kështu me radhë.

Neni 230 / a parashikohet të pengojë financimin e terrorizmit, duke dënuar një sjellje të tillë me 15 vjet burgim, ndërsa neni 230 vendos sanksione për individët që fshehin fondet e përdorura për financimin e aktiviteteve terroriste. Në vitin 2007 janë miratuar shumë ndryshime në Kodin Penal, në mënyrë specifike në lidhje me nenin 231 të Kodit, me qëllim që të inkorporohen në të drejtën kombëtare detyrimet e ndërmarra nga Shqipëria në lidhje me ratifikimin e Konventës Evropiane për parandalimin e terrorizmit duke dënuar " Rekrutimin e individëve me qëllim të kryerjes së akteve terroriste ose financimit të veprimtarive terroriste ", madje edhe në rastet kur këto akte drejtohen në një shtet tjetër, një institucion ose organizatë ndërkombëtare.

³² A. Laas; T. Boezaart (2014). " Legislative framework regardin bullying in South African Schools". Retrieved from :<http://dx.doi.org/10.4314/pej.v17i6.12>

Nga ana tjetër, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nuk zgjeron akte të veçanta procedurale që do të zbatohen në hetimin e aktiviteteve terroriste, edhe pse ekziston një ligj i veçantë që rregullon sekuestrimin e pronës në këto raste.³³ Mungesa e legjislacionit në këtë drejtim nuk minon luftën kundër terrorizmit, pasi Shqipëria ka miratuar Rezolutat 1267 dhe 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i cili merret me çështje të tilla. Më 10/10/2013, parlamenti miratoi ligjin nr.157 "Për masat kundër financimit të aktiviteteve terroriste".

Në vitet e fundit, qeveria ka berë ndryshime në nenin 265 / a, b, c të Kodit Penal. Këto nene përcaktojnë masat e sigurisë që zbatohen për individët që marrin pjesë në veprime luftarake në një shtet të huaj (neni 256 / a); Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj (neni 256 / b); Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj (neni 265 / c). Këto nene plotësojnë një kornizë tashmë të gjerë ligjore që rregullon aktivitetet terroriste, ekstremizmin e dhunshëm dhe financimin e aktiviteteve terroriste në Shqipëri.

Këshilli i Evropës (KE) ka ndërmarrë disa hapa drejt politikave arsimore në nivel politik dhe praktik në mënyrë që të vendosë dhe të mbajë një numër standardesh minimale për të gjitha shtetet anëtare. **Në nivel politik** veprimet përfshijnë: luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm - Plani i Veprimit (2015-2017)³⁴, Konferenca e Përhershme e Ministrave të Arsimit dhe Këshilli Drejtues i KE për Politikën dhe Praktikën Arsimore. Standardet arsimore janë përcaktuar në Kartën e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut. CM / Rec (2010) 7 dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM / Rec (2012) 13 për sigurimin e arsimit cilësor. Në nivel praktik ka programe të shumta siç janë mbështetja afatgjatë e Shqipërisë në sektorin e arsimit; Programet e përbashkëta të BE / KE: Të Drejtat e Njeriut dhe Demokracia në Veprim dhe Mbështetja Rajonale për Arsimin Gjithëpërfshirës.

Dokumenti që trajton çështjen e ekstremizmit të dhunshëm (VE) dhe radikalizmin që çon në terrorizëm thekson vendosmërinë e KE për të dhënë një kontribut të fuqishëm në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, duke mbështetur në mënyrë të vendosur veprimin e Këshillit të Evropës për respektimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë, të cilat përbëjnë tre fushat e veprimtarisë së Këshillit të Evropës.

Plani i Veprimit i KE 2015-2017 ka dy objektiva:

1. Përforcimi i kuadrit ligjor kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
2. Të parandalojë dhe të luftojë radikalizimin e dhunshëm përmes masave konkrete në sektorin publik, veçanërisht në shkolla dhe burgje, dhe në internet

Për të parandaluar dhe luftuar radikalizimin nëpërmjet masave konkrete në sektorin publik, veçanërisht në shkolla, Plani thekson se:

³³ Ligji 10 192, date 14/11/2009

"Ligj për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurisë"

³⁴ CoE Plan of Action 2015-2017 The fight against violent extremism and radicalisation leading to terrorism; *Committee of Ministers*, CM Documents, 19 May 2015, 125th Session of the Committee of Ministers, (Brussels, 19 May 2015); https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805c3576

"Nevojiten veprime për të parandaluar radikalizimin e dhunshëm dhe për të rritur kapacitetin e shoqërive tona për të perjashtuar të gjitha format e ekstremizmit. Edukimi formal dhe informal, aktivitetet rinore dhe trajnimi i aktorëve kryesorë (duke përfshirë median, fusha politike dhe sektorët socialë) kanë një rol vendimtar në këtë drejtim. Shkollat kërkojnë masa të përshtatura, kryesisht në nivel lokal. Duhet të zhvillohen mjete për të ndihmuar ata që mund të luajnë një rol vendimtar në luftën kundër radikalizimit në terren - si mësuesit dhe shkëmbimi i praktikave të mira, si në aspektin e përmbajtjes së programeve, ashtu edhe në trajnimin dhe udhëzimet që ofrohen për stafin. Mënyra më e mirë për të zhvilluar një kuptim të "kulturës demokratike" është përmes edukimit"³⁵.

Qëllimi është të mbështesin, përmes iniciativave konkrete, punën e edukatorëve, të cilët janë kyç në ndërtimin dhe në konsolidimin e shoqërive më gjithëpërfshirëse. Projektet në këtë drejtim do të përfshijnë iniciativa për të luftuar stereotipin dhe diskriminimin, për të mbështetur strategjitë e përfshirjes në nivel lokal, për të ndërtuar besimin tek qytetarët në dallimet shoqërore dhe kulturore dhe për të mbështetur komunikimin dhe aftësitë ndërkulturore. Do të bëhen përpjekje për të kundërshtuar mesazhet shkatërruese të ekstremistëve me narrativë kundër. Kjo do të përfshijë ngritjen e profilit dhe dhënien e një platforme liderave fetarë dhe akademikëve që flasin me autoritet rreth asaj se si aktivitetet e organizatave terroriste janë në konflikt me fenë. Përveç kësaj, nxënësit dhe udhëheqësit e komunitetit do të inkurajohen të theksojnë se si grupet terroriste si ISIL, i njohur edhe si Daesh, po dëmtojnë njerëzit e besimit musliman dhe shkaktojnë dëme në shoqërinë më të gjerë. Dëshmitë e viktimave të terrorizmit do të merren parasysh në këtë kontekst.

Një dokument i rëndësishëm i politikës arsimore të Këshillit të Evropës³⁶ është Rekomandimi CM / Rec (2010) 7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Kartën e Këshillit të Evropës mbi Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin³⁷ për të Drejtat e Njeriut.³⁸ Arsimi dhe trajnimi luajnë një rol qendror në avancimin e misionit të KE për të promovuar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut janë të ndërlidhura ngushtë dhe mbështesin reciprokisht njëra-tjetrën. Ato ndryshojnë në fokus dhe fushë më shumë sesa në qëllime dhe praktika. Edukimi për qytetarinë demokratike përqendrohet kryesisht në të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike dhe pjesëmarrjen aktive, në lidhje me sferat qytetare, politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë, ndërsa edukimi për të drejtat e njeriut ka të bëjë me spektrin më të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo aspekt të jetës së njerëzve.

³⁵ Këshilli i Evropës po zhvillon aktualisht kompetencat kyçe për të pasur një qytetari demokratike që të përdoret në kurrikulat shkollore në të gjithë Evropën.

³⁶ Recommendation **CM/Rec(2010)7** of the Committee of Ministers to member states on the Council of Europe Charter on Education for Democratic Citizenship and Human Rights Education, *Adopted by the Committee of Ministers on 11 May 2010 at the 120th Session*, https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cf01f

³⁷ "Edukimi për qytetarinë demokratike" nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informacionin, praktikën dhe aktivitetet të cilat synojnë pajisjen e nxënësve me njohuri, aftësi dhe kuptim dhe zhvillimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre, për t'i fuqizuar ata për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e tyre demokratike dhe përgjegjësitë në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e demokracisë dhe sundimit të ligjit.

³⁸ "Edukimi për të drejtat e njeriut" nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informacionin, praktikën dhe aktivitetet që synojnë pajisjen e nxënësve me njohuri, aftësi dhe kuptim dhe zhvillim të qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre, për të fuqizuar nxënësit për të kontribuar në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Sipas dokumentit të politikave, objektivat dhe parimet e mëposhtme duhet të udhëzojnë shtetet anëtare në hartimin e politikave, legjislacionit dhe praktikës së tyre.

- a. Çdo personi brenda territorit të shtetit duhet t'i sigurohet mundësia për edukim për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut.
- b. Të nxënit në fushën e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Të nxënit e efektshëm në këtë fushë kërkon përfshirjen e një numri të madh vendimmarrësish, si: politikbërës, specialistë arsimit, nxënës, prindër, institucione dhe, autoritete arsimore, punonjës civilë, organizata jo qeveritare, organizata rinore, media dhe publiku i gjerë.
- c. Përbërës thelbësor i të gjithë edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është zhvillimi i kohezionit shoqëror, i dialogut ndërkulturor dhe vlerësimi i diversitetit dhe i barazisë, përfshi këtu edhe barazinë gjinore. Për këtë qëllim, është e rëndësishme të zhvillohen njohuri, aftësi vetjake dhe shoqërore që do të pakësojnë konfliktet, do të rrisin vlerësimin dhe mirëkuptimin e ndryshimeve ndërmjet grupeve etnike dhe fetare, do të ndërtojnë respektin e ndërsjellë për dinjitetin njerëzor dhe vlerat e përbashkëta, do të nxisin dialogun dhe mospërdorimin e dhunës në zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve.
- d. Një ndër synimet themelore të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është jo thjesht të pajisë nxënësit me njohuri dhe aftësi, por edhe t'i fuqizojë ata me gatishmërinë për të ndërmarrë veprime për mbrojtjen dhe për zhvillimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.
- e. Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i specialistëve të arsimit dhe i udhëheqësve të rinisë, si dhe i vetë trajnerëve, në bazë të parimeve dhe praktikave të edukimit për qytetari demokratike, mbeten pjesë jetësore për sigurimin e qëndrueshmërisë së një arsimit të efektshëm në këtë fushë dhe, për këtë arsye, duhet të planifikohen dhe të mbështeten me burimet e duhura.

Përgjigja kryesore institucionale ndaj VE është Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër VE³⁹. Para miratimit të Strategjisë për CVE, Shqipëria ka marrë pjesë në disa ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare kundër VE. Shqipëria ishte një nga sponsorët e Rezolutës 2178 të OKB-së (2014) "*Dënimi i ekstremizmit të dhunshëm, duke nënvizuar nevojën për të parandaluar udhëtimin dhe mbështetjen për luftëtarët e huaj terroristë*" të miratuar nga Këshilli i Sigurimit në shtator 2014.

Më parë në vitin 2014, parlamenti shqiptar miratoi ndryshime në Kodin Penal, gjë që e bëri të paligjshme (1) të marrë pjesë; (2) të organizojë pjesëmarrjen e; ose (3) thirrje për pjesëmarrje në veprim ushtarak në një vend të huaj.

Qeveria e Shqipërisë, pas Samitit të Uashingtonit (shkurt 2015), organizoi Takimin Rajonal të Ballkanit në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (Tiranë, Maj 2015), ndërsa ka marrë pjesë aktive dhe vazhdon ta bëjë këtë në iniciativa të ndryshme të udhëhequra nga BE për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Në tetor të vitit 2015, Qeveria Shqiptare miratoi KDM nr. 825 (datë 7.10.2015) i cili përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve

³⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, date 18.11.2015, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit, Qendra e Botimeve Zyrtare, fq. 13247, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf

private parashkollore, fillore dhe të mesme që përfshijnë subjekte fetare ose të cilat ofrojnë arsimim në një gjuhë të huaj⁴⁰.

Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm synon të ruajë vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, të mbrojë të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë, si dhe të mbrojë shoqërinë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm⁴¹.

Strategjia ka katër objektiva që konvergojnë në kuadër të qëllimit të saj gjithëpërfshirës për të zhvilluar kapacitetet e faktorëve të ndryshëm të përfshirë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri për të adresuar në mënyrë efektive kushtet që çojnë në radikalizim, si: (1) Do të forcojnë bashkërendimin, bashkëpunimin midis aktorëve; (2) nxitin hulumtimin lokal për të kuptuar më mirë kushtet, faktorët dhe stimujt që nxitin radikalizmin drejt dhunës; (3) Ndërtimi i elasticitetit të komunitetit; dhe (4) Të ulë ndikimi e propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit në internet.

Strategjia Kombëtare Shqiptare propozon 10 masa, të organizuara sipas tri fushave të përparësisë, për zhvillimin e kapaciteteve, politikave dhe mekanizmave për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Këto fusha kryesore janë: - Shtrirja në komunitet dhe angazhimi i tij; - Kundërvënia ndaj propagandës ekstremiste, duke përkrahur vlerat demokratike; - Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së.

⁴⁰Ky akt zëvendëson VKM-në e mëparshme nr. 248 të datës 28.05.1999.

⁴¹ Ministria e Mbrojtjes njoftoi në shtator 2016 krijimin e Qendre së Ekselencës të NATO-s mbi fenomenin e FtFs. Strategjia Kombëtare CVE sugjeron krijimin e një rrjeti bashkëpunimi rajonal për CVE.

2. METODOLOGJIA

2.1 Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore

Qëllimi kryesor i këtij studimi buron nga nevoja për të kryer një studim mbi dukurinë e bullizmit dhe ekstremizimit të dhunshëm në kontekstin shqiptar.

Katër objectivat kryesorë të studimit janë:

1. Të përcaktohet shpeshtësia dhe karakteristikat (llojet, shkaqet, vendndodhja; kohëzgjatja, raportimi) e bullizmit në sistemin arsimor;
2. Të vlerësohet shkalla e tolerancës ndaj bullizmit dhe ekstremizimit të dhunshëm midis aktorëve të ndryshëm në shkollë;
3. Të përcaktohet niveli i qëndrimeve dhe besimeve ekstremiste midis aktorëve të ndryshëm në shkollë;
4. Të identifikohen politikat dhe procedurat kundërbulliste që ekzistojnë në shkollat shqiptare.

Pyetjet kërkimore të studimit

- ↳ Sa përqind e studentëve kanë qenë viktime të bullizmit?
- ↳ Cilat janë llojet e bullizmit në të cilat nxënësit kanë qenë më shpesh viktime?
- ↳ Në sa mënyra janë bulluar shumica e nxënësve? Sa zgjati bullizmi?
- ↳ A raportojnë nxënësit? Nëse po, kujt i tregojnë?
- ↳ Cilat janë qëndrimet, besimet dhe të kuptuarit e mësuesve në lidhje me bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm?
- ↳ Çfarë lloje strategjish apo ndërhyrjesh zbatohen nga shkolla, kur ata përballen me një incident bullist nga nxënësit në klasë?
- ↳ Cilat metoda ose teknika sugjerojnë mësuesit si më efektive për të parandaluar bullizmin dhe ekstremizmin?
- ↳ Cilat janë qëndrimet besimet dhe të kuptuarit e prindërve, në lidhje me fenomenin e bullizmit?
- ↳ Si perceptohen nga prindërit politikat ose programet e shkollës për të parandaluar bullizmin?
- ↳ Cilat janë sugjerimet e prindërve në lidhje me rolin e shkollës në zbutjen e fenomenit të bullizmit?
- ↳ Cilat janë instrumentet që përdorin shkollat për të luftuar bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në shkolla?

2.2 Metoda kërkimore

Për të kryer objektivat e përmendur më sipër, studimi është në thelb i tipit deskriptiv/përshkrues. Ai mbledh të dhënat nga një kampion përfaqësues prej 6907 pjesëmarrësish nga të cilët **2377 nxënës; 3560 mësuesit dhe 970 prindërisht**. Të dhënat sasiore janë mbledhur përmes tre pyetësorëve

1. Pyetësi i standardizuar i Olweus i të validuar me 40 pyetje të mbyllura për nxënësit;
2. Një pyetësi me pyetje të mbyllura, që mat qëndrimet dhe besimet e mësuesve ndaj dukurisë së bullizmit dhe ekstremizimit të dhunshëm
3. Një pyetësi me pyetje të mbyllura me prindërit që mat qëndrimet dhe besimet e tyre ndaj dukurisë së bullizmit.

2.3 Madhësia e kampionit

Duke marrë parasysh faktin se ky studim bazohet në një qasje sasimore me qëllim përgjithësimin e gjetjeve, është përdorur një kampion i stratifikuar me shumë faza. Kriteret e përzgjedhjes së kampionit u bazuan në kriteret e mëposhtme:

- ↳ Zona gjeografike
- ↳ Zona Urbane/ Rurale
- ↳ Lloji i shkollës, private/ publike
- ↳ Madhësia e shkollës
- ↳ Niveli i shkollës: 9-vjeçare, e mesme e përgjithshme dhe profesionale.

Faza e parë e kampionimit ishte përzgjedhja në shkallë 7% e shkollave të Republikës së Shqipërisë sipas ndarjes në 12 rajone dhe kriterëve të përmendura më sipër.

Tabela 1.1. Shpërndarja e numrit të shkollave sipas rajoneve

Nr	Qyteti	Numri i shkollave
1.	Berat	7
2.	Dibër	8
3.	Durrës	16
4.	Elbasan	14
5.	Fier	16
6.	Gjirokastrë	3

Nr	Qyteti	Numri i shkollave
7.	Korçë	10
8.	Kukës	5
9.	Lezhë	7
10.	Shkodër	12
11.	Tiranë	37
12.	Vlorë	9

Faza e dytë ishte përzgjedhja në mënyrë rastësore e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në çdo shkollë ku u përcaktua që do zhvillohej studimi sipas fazës së parë. Popullata e nxënësve në Shqipëri konsiston në 503,451 nxënës, ku 362,408 ndjekin arsim bazë (arsimi fillor dhe i mesëm i ulët) dhe 140,043 ndjekin gjimnazin/ arsimin e mesëm të lartë (kohë e plotë) nga ku 22,801 ndjekin arsimin profesional.⁴²

Me synimin që marzhi i gabimit statistikor të kampionit të mos ishte më i madh se $\pm 4\%$ (intervalin e besimit), me nivel besueshmërie 95% ($p=0.05$) duhej që për këtë popullatë të kishim një kampion të barabartë me 1,205 nxënës. Megjithatë, për të rritur besueshmërinë e të dhënave mbi fenomenin e bullizmit, studiuesit në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtar arritën në përfundimin se ishte e nevojshme që të dyfishohej numri i nxënësve⁴³, duke rezultuar në fund në një kampion prej 2,410 nxënës, prej të cilëve 2,377 iu përgjigjën pyetësorit.

Sa i përket kampionit të mësuesve dhe prindërve, të gjithë mësimdhënësit nga 144 shkollat janë përfshirë në hulumtim, duke rezultuar në një mostër prej 3,560 të anketuarish, ndërsa prindërit përfaqësojnë gjysmën e numrit të nxënësve, me 1100 të përfshirë në studim, prej të cilëve 970 prindër iu përgjigjën pyetësorit .

⁴²Për më shumë informacion shih: Vjetarin Statistikor të Arsimit 2014-2015 publikuar online nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

⁴³Duke qenë se fenomeni është i ri dhe mund të mbartë problem me kuptueshmërinë e termit.

Më pas studiuësit, pasi kishte përcaktuar klasat ku do të shpërndahej pyetësori dhe nxënësit që do të ishin pjesë e studimit, i kërkuan bashkëpunim mësueses/it kujdestar/e të çdo klase dhe drejtorisë së shkollës për shpërndarjen e një dokumenti të quajtur “Miratim i lejes prindërore”, dhe iu kërkua që të kujdesej për kthimin e tij.

Në secilën nga shkollat e përzgjedhura u mor në mënyrë rastësore vetëm një klasë. Klasat ku do të shpërndahej pyetësori u zgjodhën sipas shkronjave të alfabetit ose numrit.

Madhësia e kampioni, kriteret që janë marrë për përzgjedhjen e tij (që e bëjnë përfaqësues, duke qenë se është e larmishme) dhe mënyra e përzgjedhjes së tij e rritin besimin se gjetjet në këtë disertacion mund të përgjithësohen për të gjithë arsimin e mesëm të ulët publik të qytetit të Tiranës.

2.4 Instrumenti i studimit

Për realizmin e këtij studimi u përdorën tre pyetësorë, ndër ta pyetësori bazë ishte instrumenti kryesor i studimit/ pyetësori i standardizuar dhe i krijuar nga Dan Olweus (Dan Olweus). Ky pyetësor quhet “Pyetësori i Rishikuar i Agresor/ Viktimë e Oleusit” (shkurt PAVO ose anglisht ROBVQ) (Olweus, 1996). PAVO -ja është një ndër komponentët e Programit të Parandalimit të Bullizmit i Oleusit. Ai është pyetësor i standardizuar, i validuar (i bazuar e që e jep rezultatin e dëshiruar në pyetje me alternativa), që është krijuar për të matur një sërë aspektesh të problemeve të bullizmit brenda mjedisit shkollor.

PAVO-ja është e ndarë në dy pjesë:

1. Pjesa e parë (nga pyetja e 4-të deri në pyetjen e 24-të) ka të bëjë me veprimet bulliste që ushtrohen ndaj nxënësit, që po e plotëson pyetësorin,
2. Pjesa e dytë (nga pyetja e 24-të deri në pyetjen e 40-të) ka të bëjë me rastet kur nxënësi, që po e plotëson pyetësorin ushtron bullizëm tek nxënësit e tjerë.

Gjithsej pyetësori përmban 40 pyetje për matjen e problemeve agresor-viktimë, si: shfaqja ndaj formave të ndryshme të bullizmit (fizike, verbale, emocionale, raciale ose forma të bullizmit seksual), në cilat vende ndodh më shumë bullizmi, qëndrimet në përkrahje të agresorit dhe në përkrahje të viktimës dhe shkallën që mjedisi social (si mësuesit, prindërit apo bashkëmoshatarët) është i informuar dhe reagon/kundërvepron ndaj kësaj dukurie (Olweus, 1997).

Që në fillim të hartimit të këtij pyetësori, ai u mendua që të plotësohej në mënyrë anonime, prandaj edhe në këtë studim është ruajtur anonimati i nxënësve. Pyetësori fillon duke na dhënë një përkufizim të hollësishëm të bullizmit, në mënyrë që nxënësit të kenë një kuptim më të qartë se si duhet t’i interpretojnë pyetjet, në mënyrë që të japin përgjigje sa më frytdhënëse.

Sipas pyetësorit PAVO, një individ është viktimë e bullizmit kur: a) *ai ose ajo është shënjestër e sjelljeve agresive të nxënësve të tjerë (për shembull, kur të tjerët thonë gjëra fyese për të, b) kur nxënësit e tjerë e shpërfillin në mënyrë sistematike, kur e lëndojnë fizikisht, kur i shpërndajnë thashetheme dashakeqe ose kur i shkaktojnë dhimbje, c) kur ka një pabarazi në fuqi dhe në pushtet* ndërmjet individëve të përfshirë, si dhe kur këto sjellje zakonisht ndodhin më shumë se një herë. Pra, që një sjellje agresore të quhet bullizëm, duhet që të plotësohen të tria këto kushte njëherësh.

Pyetëtori përdor kryesisht shkallën Likert me 5 mundësi zgjedhjeje: “1-kurrë, 2-një herë ose dy herë, 3-dy deri në tri herë në muaj, 4-rreth 1 herë në javë, 5-disa herë gjatë javës”. Këto mundësi zgjedhjeje janë krijuar për të shmangur paqartësinë që mund të përmbajnë përgjigje të tilla, si shpesh dhe shumë shpesh (Olweus, 2007).

Në përputhje me rekomandimet e krijuesit të pyetëtorit mbi vlerësimin e shpeshtësisë së shfaqjes së dukurisë së bullizmit, pesë përgjigjet duhen dikotomizuar³³, në mënyrë që mundësia 1 e zgjedhjes dhe mundësia 2 e zgjedhjes të jenë 0 (jo agresor, jo viktimë), kurse alternativat nga mundësia 3 e zgjedhjes deri në mundësinë 5 të zgjedhjes, të marrin vlerën 1 (agresor-viktimë).³⁴

Instrumenti i dytë dhe i tretë u hartuan nga studiuesit e studimit në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë bazuar në përmbajtjen e PAVO-s. Këto instrumente u modifikuan për të trajtuar perceptimet dhe besimet e mësuesve dhe prindërve lidhur me problemet e bullizmit. Për pyetëtorin e mësuesve u zhvillua një sesion i veçantë që synonte të trajtonte sjelljet ekstremiste.

Pyetjet u krijuan për të identifikuar dy elemente kryesore nga përgjigjet e dhëna nga mësuesit dhe prindërit: 1) Prevalenca dhe karakteristikat e bullizmit në shkollë; 2) Mbledhjen e informacionit rreth politikave dhe rregulloreve aktuale të shkollës lidhur me bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

2.5 Përkthimi i pyetësorëve në kontekstin shqiptar

Procesi i përkthimit të instrumenteve kërkimore nga një gjuhë tjetër duhet të përqendrohet në arritjen e përshtatjes nga pikëpamja e konceptit dhe jo vetëm nga pikëpamja gjuhësore. Për ta arritur këtë, është zbatuar metoda e përkthimit me dy drejtime. Në hapin e parë, dy profesionistë dhe njohës të shkëlqyer të gjuhës angleze dhe asaj shqipe (njëri me profesion përkthyes dhe tjetri përkthyes, por dhe me një diplomë të dytë në punë sociale e që punon në fushën e mbrojtjes së fëmijëve) e kanë përkthyer pyetëtorin në gjuhën shqipe nga varianti origjinal anglisht. Më pas është kryer një takim, në të cilin të dy përkthyesit i rishikuan variantet e përkthimit dhe e harmonizuan përkthimin në një të vetëm.

Në vazhdim, ky variant në gjuhën shqipe është përkthyer sërish në anglisht nga një përkthyes që nuk kishte marrë pjesë në procesin e parë të përkthimit. Më pas është parë se sa i ngjashëm është përkthimi/varianti i ri i pyetëtorit në shqip me atë origjinal. Nga gjithë ky proces pati mospajttime e mospërputhje mendimesh midis përkthyesve, sidomos për ruajtjen ose jo të termit në anglisht “bullying” apo të përkthimit të tij, duke i përshtatur fjalën “ngacmim”. Por, në anglisht kjo fjalë përkthehet “harassment” dhe ndryshon nga fjala “bullying”. Prandaj u vendos mbajtja e termit “bullizëm”.

Pas fazës së përkthimit të pyetësorëve u krye procesi pilotimit të tyre. Ky test synoi që të sqaroheshin çështjet e mëposhtme:

1. Kuptueshmëria e pyetjeve.
2. Përcaktimi i kohës që i duhej nxënësve për ta plotësuar pyetëtorin.

Testi pilot u krye me 40 nxënës , 40 mësues dhe 20 prindër të tre shkollave në Tiranë që nuk ishin përzgjedhur si kampion për studimin. Kjo fazë rezultoi shumë frytdhënëse, sepse u bënë dhe u dhanë mendime dhe komente të arsyeshme nga nxënësit dhe mësuesit, më pas, studiuesit i pasqyruan në pyetësor.

2.6 Testimi në terren i instrumentit të Olweus mbi konsistencën e brendshme dhe të besueshmërisë test-ritest

Besueshmëria e një pyetësori të përkthyer mund të vihet në provë duke parë konsistencën e brendshme dhe besueshmërinë e test-ritestit.

Konsistenca/ qëndrueshmëria e brendshme

Duke qenë se qëndrueshmëria e brendshme e instrumentit na jep një vlerësim për faktin nëse termat e përdorur i matin vërtet konceptet e synuara, koeficienti alfa (α) i Kronbahut (Cronbach's alpha) ⁴⁴ është nga metodat më të suksesshme për matjen e kësaj qëndrueshmërie. Ky koeficient mat besueshmërinë e brendshme dhe tregon se sa të lidhur janë elementët e një grupi që e kemi zgjedhur si kampion. Një vlerë e lartë e alfës, zakonisht përdoret si një provë që elementët e matur janë pjesë përbërëse e një konstrukti të vetëm. Alfa e Kronbahut është një funksion i numrit të elementëve, i mesatares së kovariancës së brendshme dhe i mesatares së variancës⁴⁵.

Një ndikim të drejtpërdrejtë në këtë koeficient ka koovarianca⁴⁶ midis elementëve. Sa më e madhe të jetë koovarianca, duke mbajtur të pandryshueshëm numrin e elementëve, aq më e madhe është alfa. Si rregull, alfa e Kronbahut mbi 0.70 quhet si një koeficient i pranueshëm besueshmërie. Megjithatë, në raste të veçanta janë pranuar vlera mbi 0.6 ose mbi 0.5. Nëse i referohemi pyetësorit të këtij studimi, alfa e Kronbahut doli e barabartë me 0.71, në rastin e pyetjeve në lidhje me të qenët viktimë, he 0.75, në rastin e pyetjeve në lidhje me të qenët agresor.

Besueshmëria e test-ritestit

Besueshmëria e test-ritestit (stability reliability) përshkruan shkallën në të cilën rezultatet janë të qëndrueshme në kohë. Duke u bazuar në Rezultatet e Udhëzimeve për Vlerësimin dhe Shprehjen e Pasigurisë së NIST-së, për të pasur besim në rezultatet e test-ritestit duhet të plotësohen disa kushte, si më poshtë:

- E njëjta procedurë matjeje.
- I njëjti vëzhgues.
- I njëjti instrument matës, por i përdorur në të njëjtat kushte.
- E njëjta vendndodhje.
- Përsëritja në një periudhë të shkurtër kohe.

Pra, nëse ne e zhvillojmë pyetësorin pas një ose dy javësh, korrelacioni midis rezultateve që do të merrnim do të ishte i lartë, atëherë besueshmëria e test-ritestit do të ishte e lartë.

⁴⁴ Alfa e Kronbahut (Cronbach's alpha)-në statistikë është një koeficient i matjes së besueshmërisë apo i konsistencës së brendshme të subjekteve që i nënshtrohen një testi ose një pyetësori.

⁴⁵ Variancë-një mjet statistikor që përdoret për matjen e shpërndarjes së një serie elementesh të një grupi e që është matematikisht i barabartë me katrorin e shmangies standarde, pra me σ^2 .

⁴⁶ Kovarianca-fjalë me burim nga latinishtja (co=bashkë dhe variant=ndryshim, pra, kjo fjalë ka kuptimin e bashkëndryshimit të njëkohshëm), e cila përdoret në statistikën matematikore dhe përfaqëson prirjen që kanë dy ndryshore rastësore për të ndryshuar në lidhje me njëra-tjetrën, pra, nëse ndryshon njëra, do të ndryshojë edhe tjetra.

Ky test është mjaft frytdhënës edhe kur duam të matim tipare apo gjendje që ndryshojnë pak me kalimin e kohës. Duke supozuar se fakti i të qenët viktimë apo agresor ndryshon pak në kampionin tonë brenda intervalit të përcaktuar kohor, ky test do të japë vlera mjaft të besueshme. Testi-ritesti u vlerësua duke pyetur 40 individë të një shkolle që nuk ishte në kampionin tonë, në një hark kohor shtatëditor. Koeficienti i besueshmërisë së raportuar këtu nuk është bazuar në kampionin që është përdorur në kërkim, me qëllim shmangien e ndërhyrjes në vlerësimin e besueshmërisë.

Korrelacioni i shkallës së përgjithshme të pjesëmarrjes rezultoi me koeficient të Pirsonit (Pearson) $r=0.78$ në rastin e të qenët viktimë dhe $r=0.77$ në rastin e të qenët agresor. Shohim që koeficienti i Pirsonit është afër vlerës 1, gjë që tregon një lidhje të fortë midis vlerave gjatë matjes së parë dhe të dytë.

2.7 Administrimi i pyetësorëve

Një nga pikat kryesore të procesit ishte trajnimi i intervistuesve. Trajnimi profesional u dha për të siguruar standarde dhe cilësi të lartë të anketës, pasi saktësia e përgjigjeve varet shumë nga qartësia dhe aftësia e intervistuesve për të futur konceptin e ngacmimit tek nxënësit, mësuesit dhe prindërit dhe si të lehtësojë procesin e përgjigjes pa ndikuar përgjigjet. Intervistuesit ndoqën trajnimin për tu bërë në gjendje të:

- Kuptojnë konceptin e ngacmimit dhe kompleksitetin e pyetësorëve
- Si t'i zgjedhim rastësisht të anketuarit sipas rastit sipas metodologjisë së projektuar

Intervistuesit u organizuan në katër grupe, të përbërë nga gjashtë individë secili, me një mbikëqyrës që ishte përgjegjës për tri rajone të Shqipërisë. Intervistuesit u përzgjedhën në mesin e studentëve të programeve tona master, duke marrë pjesë në punën në terren. Intervistuesit janë kryesisht studentë nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe kanë pasur përvojë të mëparshme me anketa. Për më tepër, këto lloje të aktiviteteve janë gjithashtu pjesë e kurrikulës së tyre në shkollë. Për rajonet më të mëdha si Tirana, Durrësi dhe Korça, punonjësit socialë dhe psikologët u shfrytëzuan për të mbikëqyruar procesin e pyetësorëve në shkollat ku janë të bazuara.

Intervistuesit u udhëzuan të vendosnin pyetësorin e mbledhur në zarfa pas përfundimit të procesit të plotësimit në secilën shkollë, për të mbyllur zarfin dhe për ta dorëzuar atë tek mbikëqyrësi në fund të së njëjtës dite. Më pas, të gjitha zarfat u depozituan në zyrën e ISOP-it në Tiranë, ku ekipi i projektit filloi procesin e futjes së të dhënave të fazës, duke përdorur një aplikim për futjen e të dhënave dhe krijimin e një baze përkatëse të të dhënave.

Procesi i plotësimit të pyetësorit zgjati rreth 45 minuta (afërsisht një orë mësimi). Kjo periudhë përfshiu prezantimin e intervistuesit, dhënien e udhëzimeve, plotësimin e pyetësorit dhe folloë-up/ndjekjen e veprime të mëtejshme. Më poshtë jepen disa nga elementet që u shpjeguan gjatë dhënies së udhëzimeve:

- ↳ Nxënësve iu shpjegua qëllimi i studimit dhe u pyetën nëse dëshironin të merrnin pjesë në plotësimin e pyetësorit.
- ↳ U sqarua se pyetësori ishte i paemër dhe çdo gjë do të mbetej konfidenciale/sekrete dhe në mirëbesim.

- ↳ U sqarua se pyetësoi do të shpërndahej në mënyrë rastësore tek një numër i përcaktuar nxënësish dhe jo çdo nxënës do të kishte mundësi ta plotësonte instrumentin, në mënyrë që të shmangeshin pakënaqësitë.
- ↳ U sqarua se çdo nxënës ishte i lirë të mos pranonte plotësimin e pyetësoit, pavarësisht se më parë kishte pranuar të kundërtën.
- ↳ Për plotësimin e pyetësoit, prindërve, përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, iu kërkua miratimi për pjesëmarrjen e fëmijës së tyre në studim.
- ↳ Çfarë duhet të kuptonin nxënësit me dukurinë e bullizmit.
- ↳ Si duhej plotësuar instrumenti, duke e treguar a dhënë me shembuj për pyetje të veçanta e që kërkonin sqarime më të hollësishme.
- ↳ U sqarua periudha kohore që nxënësit duhet të kishin si referim kur plotësonin pyetësoin.
- ↳ U sqarua se pyetësoi nuk ishte një provim, prandaj nuk bëhej fjalë që do të kishte ndonjë vlerësim nëse kishte përgjigje të sakta apo të gabuara. Të gjitha përgjigjet do të merreshin të mirëqena.

Për nxënësit e klasave të IV dhe të V-ta intervistuesit e trajnuar ia lexuan pyetjet nxënësve dhe siguroheshin që pasi të gjithë ta kishin plotësuar pyetjen të kalonin në pyetjen vijuese. Duke qenë të kujdesshëm për ruajtjen e privatësisë.

Gjatë plotësimit të pyetësoit nga nxënësit, intervistuesi, i ka mbikëqyrur gjithë kohën nxënësit që të mos shpërquroheshin me njëri-tjetrin dhe ka qenë i pranishëm për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kishin, por edhe për t'u siguruar që çdo nxënës, që mund të shfaqte probleme emocionale gjatë plotësimit të pyetësoit, të referohej në burime të mëtejshme ndihme.

E njëjta gjë ndodhi edhe për pyetësoin e mësuesve, intervistuesit pasi i shpjegonin konceptin dhe qëllimet e studimit qëndronin gjatë kohës së plotsimit nëse do kishte pyetje të paqarta.

Ndërsa një pjesë e prindërve e plotësuan pyetësoin në shkollë pasi ata ishin lajmëruar paraprakisht nga drejtoria për realizimin e studimit dhe pjesës tjetër iu dha nga vetë fëmija i tyre ta plotësonte në kushtet e shtëpisë.

Pyetësoret u administruan gjatë periudhës kohore shkurt 2017-mars 2017.

2.8 Analiza e të dhënave sasiore

Të dhënat e mbledhura nga pyetësoi u hodhën në një program të quajtur CPro (CENSUS47 dhe Survey Processing System-Censusi dhe sistemi i vëzhgimit të përpunimit). Ky program mund të përdoret për hedhjen, botimin, llogaritjen dhe përhapjen e të dhënave të censusit apo të studimeve të tjera. Baza e të dhënave e krijuar në programin CPro u eksportua për të bërë analizat e mëtejshme në versionin e 21-të të programit SPSS (StatisticalPackage for the Social Science-Paketa statistikore për shkencat sociale).

Analiza deskriptive/përshkruese fillestare e dy ndryshoreve të përgjithshme që merren nga pyetjet 4: “Sa shpesh kanë qenë viktimë e bullizmit në muajt e fundit?”; dhe pyetjes 24: “Sa shpesh keni shkaktuar bullizëm tek nxënësit e tjerë në muajt e fundit?”, siguron informacion për nxënësit që kanë qenë viktimë, ata që kanë qenë agresorë dhe ata që kanë qenë edhe viktimë, edhe agresorë.

Nxënësit iu përgjigjën këtyre dy pyetjeve sipas pesë kategorive të mëposhtme:

(I). Nuk kam qenë viktimë e bullizmit në muajt e fundit.

Ose në muajt e fundit kjo më ka ndodhur:

(II). Vetëm një ose dy herë.

(III). Dy ose tri herë në muaj.

(IV). Rreth një herë në javë.

(V). Disa herë gjatë javës.

Në studimet e mëparshme, si në atë të kryer nga Solbergu dhe Oleusi (Solberg & Olweus, 2014), ashtu dhe në atë të kryer nga Ahmed dhe Brejthuejti (Ahmed & Braithwaite, 2004), përgjigjet (III) deri në (V) ka dalë se janë pikëprerje ku ka një ndryshim të dukshëm ndërmjet “nxënësve të përfshirë” dhe atyre “të papërfshirë” në bullizëm. Kjo pikëprerje përshtatet edhe me përkufizimin e Oleusit për bullizmin “që një sjellje të quhet bulliste, duhet të përsëritet për një periudhë të caktuar kohe”. Kjo prerje efektivisht i dikotominon përgjigjet e dy pyetjeve të përgjithshme, ku nxënësit që janë viktimat të bullizmit ose që kanë shkaktuar bullizëm, pra, ata që i janë përgjigjur kategorisë (III) (“dy ose tri herë në muaj”), kategorisë (IV) (rreth një herë në javë) dhe kategorisë (V) (disa herë gjatë javës), klasifikohen si viktimat ose agresorë. E njëjta logjikë u përdor për pjesën më të madhe të pyetjeve të pyetësorit.

Pyetësori i përdorur në këtë studim përbëhet nga dy pyetje kyçe, të cilat e ndajnë atë (pyetësorin) në dy pjesë. Këto janë: pyetja 4, e formuluar kështu: “*Sa shpesh keni qenë viktimë e bullizmit në shkollë muajt e fundit?*”, dhe pyetja 24, e formuluar kështu: “*Sa shpesh keni shkaktuar bullizëm tek një ose disa nxënës në shkollë në muajt e fundit?*”. Nxënësit iu përgjigjën këtyre pyetje, por pasi iu shpjegua me hollësi dhe u siguruan nga studiuesit se ata që do ta plotësonin pyetësorin duhet ta kishin kuptuar mjaft mirë termin në fjalë, pra, bullizmin.

Pyetësori është i ndarë sipas pesë kategorive, por, për ta bërë më të qartë, studiuesit (sipas rekomandimeve të autorit të pyetësorit) i kanë ndërthurur përgjigjet e kategorive duke i ndarë ato në dy kategori të përgjithshme. Nëse nxënësit përgjigjën në pyetjen 4 se kanë qenë në muajt e fundit viktimat të bullizmit “*dy ose tri herë në muaj*”, “*rreth një herë në javë*” ose “*disa herë gjatë javës*”, ata klasifikohen si viktimat të bullizmit. Nëse ata zgjedhin të njëjtat përgjigje për pyetjen 24, klasifikohen si agresorë të bullizmit. Kurse nxënësit që zgjedhën dy kategoritë e para për të dyja pyetjet “*Kjo nuk më ka ndodhur në muajt e fundit*” apo “*Kjo më ka ndodhur vetëm një ose dy herë*”, klasifikohen si jovicimta dhe joagresorë, ose ndryshe, jo të përfshirë në bullizëm.

Ndërthurja e kategorive në dy grupe nënkupton dikotomizimin e alternativave të përgjigjeve, prandaj gjatë analizës së të dhënave është përdorur termi “i/e dikotomizuar” për të pasqyruar këtë ndarje.


Kjo ndarje është bërë sepse, sipas vetë krijuesit të pyetësorit, profesor Oleusit, duke gjetur përqindjen e nxënësve që janë viktimat dhe të atyre që janë agresorë, nuk mund të arrish në një vlerësim të saktë për “shpeshësinë tërësore/a të plotë” të problemeve të bullizmit në shkollë. Arsyeja është sepse ka një përqindje të caktuar nxënësish që janë edhe agresorë, edhe viktimat. Këta nxënës në literaturë gjenden shpesh me termin “agresorë-viktima” ose “viktimat provokuese /a që provokojnë”, kështu që gjatë analizës

së të dhënave për të bërë një vlerësim të saktë të problemit të bullizmit në shkollat pjesëmarrëse në studim, studiuesit, në shumicën e pyetjeve, e kanë ndarë në vetë kategorinë “agresorë - viktimë” dhe, më pas, ka shtuar kategorinë “vetëm viktimë” (nxënës që kanë qenë viktimë, por nuk kanë ngacmuar nxënës të tjerë) dhe “vetëm agresorë” (nxënës që kanë qenë agresorë, por nuk kanë qenë viktimë). Gjithashtu ka edhe një kategori me termin “jo i përfshirë” apo vëzhgues, ku futen ata nxënës që nuk kanë qenë as viktimë dhe as agresorë (shiko figurën).

Ndarja e nxënësve në këtë mënyrë është e rëndësishme për analizën e të dhënave, sepse secila kategori ka karakteristika të veçanta (Jimerson, 2009). Për shembull, nxënësit që janë viktimë të bullizmit në krahasim me jo viktimat kanë pak vetëbesim, kanë prirje të rrinë vetëm, shfaqin shenja ankthi dhe depresioni (Oléus, 1993; Klomek (2007); Cook, 2010; Reijntjes, 2010). Nga ana tjetër, agresorët shfaqin sjellje vandaliste, braktisin shkollën dhe përdorin alkool, cigare apo dhe marijuanë (Richter, 2000; Haynie, 1994; Radliff, 2012). Fëmijët dhe të rinjtë që janë të përfshirë në dukurinë e bullizmit si viktimë apo si agresorë, kanë probabilitet më të lartë të kenë probleme “të brendshme” (për shembull: depresion, ankth etj.) dhe të jashtme (për shembull, sjellje antisociale) (Cook et al., 2010). Është e rëndësishme të theksojmë se termat viktimë, agresorë, apo agresor-viktimë nuk do të përdoren për të identifikuar individë të veçantë, por këta terma do të përdoren vetëm për qëllime kërkimore.

Grafiku 1 Ndarja e nxënësve sipas kategorive

Grafiku 1 Ndarja e nxënësve sipas kategorive




3. ANALIZA E TË DHËNAVE TË STUDIMIT

3.1 Përceptimi i nxënësve dhe qëndrimet e tyre mbi fenomenin e bullizmit


SESIONI I: Të dhënat sociodemografike të kampionit të nxënësve

Shumica e nxënësve i përkasin shkollave 9-vjeçare në 74% të rasteve, të ndjekur nga shkolla e mesme me 23%, dhe 4% e nxënësve të intervistuar i përkasin shkollave profesionale. Pjesa më e madhe e kampionit i takon shkollave publike me 93% kundrejt 7% të atyre që shkojnë në shkolla private.

Grafiku 2. Shpërndarja e nxënësve sipas nivelit të shkollës




Grafiku 3. Shpërndarja e nxënësve sipas llojit të shkollës



Siç mund të shihet nga Grafiku 4, ekziston një shpërndarje pothuajse e barabartë e kampionit sipas klasës pa ndonjë ndryshim domethënës. Shumica e kampionit zë klasën e VIII me 15% të rasteve, e pasuar nga klasa VI me 13% të rasteve ndërsa klasat e IV dhe IX janë të barabarta me nga 10% secila. Vajzat zënë një përqindje më të lartë në studim me 1,295 (54.5%) kundrejt 1082 (45.5%) djem.

Grafiku 4. Shpërndarja e nxënësve që ushtrojnë bullizëm sipas klasës dhe gjinisë



SESIONI II: Shkalla e përhapjes së fenomenit të bullizmit sipas karakteristikave me të cilat ai shfaqet

Prevalenca e bullizmit

Pjesëmarrësit u pyetën nëse ata kishin vuajtur ose pësuar një nga format e bullizmit në shkollë. Nga gjetjet rezultoi (Tabela 2) se 81% e nxënësve pohuan se nuk ishin të përfshirë në fenomenin e bullizmit në muajt e fundit, ndërsa rreth 19% e tyre pranuan se ishin të përfshirë në fenomenin e bullizmit 2 -3 herë në muaj ose më shumë. Nga 81% e nxënësve të cilët konfirmuan se ata nuk ishin të përfshirë në fenomenin e bullizmit, rreth 29% e tyre thanë se kjo gjë i ka ndodhur 1 ose 2 herë, por nëse i referohemi krijuesit të pyetësorit Dan Olweus, ata nuk përfshihen në kategorinë e viktimave; rreth 50 % nuk janë të përfshirë dhe rreth 2% e nxënësve nuk i janë përgjigjur pyetjes.


Ekziston një lidhje e fortë midis përfshirjes gjinore dhe bullizmit, pasi shohim se djemtë janë më të përfshirë në fenomenin e bullizmit se vajzat.

Tabela 2. Nxënësit të cilët janë të përfshirë në bullizëm (total).

Përhapja e incidenteve të bullizmit	Vajzat	%	Djemt	%	Totali	%
Jo të përfshirë	717	55%	481	44%	1198	50%
Pa përgjigje	17	1%	19	2%	36	2%
Vetëm një ose dy herë	370	29%	317	29%	687	29%
Jo të përfshirë sipas pyetësorit të Olweus	1104	85%	817	76%	1921	81%
2 -3 here në muaj ose më shumë	191	15%	265	24%	456	19%
Totali	1295	100%	1082	100%	2377	100%


Ekziston një korrelacion i fortë mes moshës (klasës) dhe viktimizimit për të dyja gjinitë. Në klasën e IV deri në klasën e X, djemtë kanë një prevalencë më të lartë të viktimizimit sesa vajzat (shih Grafikonin 5). Por, në klasën e XII vajzat kanë një prevalencë më të lartë të viktimizimit sesa djemtë dhe në klasat e XII, shkalla e viktimizimit sipas gjinisë është afërsisht me një përqind diferencë.

Grafiku 5. Nxënësit që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë, sipas gjinisë




Ekziston një korrelacion i fortë midis moshës (gradës) dhe nivelit të sjellje agresive për të dyja gjinitë. Djemtë vazhdimisht sulmojnë nxënësit e tjerë më shumë se vajzat, sidomos nga klasa VII deri në X. (Shih figurën 6). Nga ana tjetër, përqindja e vajzave që raportojnë se janë agresore është më e qëndrueshme në të gjitha klasat përveç klasës së njëmbëdhjetë.

Grafiku 6. Nxënësit që kanë ushtruar bullizëm ndaj një nxënësi tjetër 2-3 herë në muaj ose më shumë, sipas gjinisë



Niveli i bullizmit për nxënësit që janë edhe agresorë edhe viktima qëndron relativisht konstant për të dyja gjinitë. Mesatarisht, 17.3% e djemve janë si viktima të bullizmit ashtu edhe agresorë dhe ky numër qëndron relativisht konstant në të gjitha klasat dhe pëson ulje me rritjen e moshës. Përqindja e vajzave që pohojnë se kanë ushtruar bullizëm ndaj të tjerëve por që gjithashtu kanë qenë viktima është më i ulët, në 9.6 %, dhe rritet paksa me klasën IX-XII-të.

Grafiku 7. Nxënësit të cilët janë agresorë gjithashtu edhe viktimë të bullizmit (të dyja ndodhin 2-3 herë në muaj ose më shumë)




Siç u përmend më herët, për të marrë një vlerësim të plotë të përqindjes së nxënësve të përfshirë në bullizmin, është e dobishme që nxënësit të klasifikohen në një nga katër kategoritë:

- Kanë pësuar bullizëm (vetëm-viktimë) (sulmohet dy ose tre herë në muaj ose më shumë, por nuk ushtron bullizëm ndaj të tjerëve);
- Kanë ushtruar bullizëm vetëm ndaj të tjerëve (agresorë) (kanë ushtruar bullizëm dy - tre herë në muaj ose më shumë, por nuk kanë pësuar bullizëm);
- Kanë ushtruar ashtu si dhe kanë pësuar bullizëm (agresorë-viktimë) (Ushtron bullizëm dy ose tre herë në muaj ose më shumë dhe pëson bullizëm nga të tjerët 2-3 herë në muaj ose më shumë);
- Të pa përfshihet - spektatorë.

Kështu, rreth 19.2 % e të gjithë nxënësve janë të përfshirë në bullizëm (shih figurën 8), ku 9.7% e tyre janë viktimë, 5.2% janë të agresorë dhe 4.3% i përkasin kategorisë më vulnerabël, viktimë dhe agresorë në të njëjtën kohë


Grafiku 8. Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë



Gjinia dhe klasa janë dy variabla shumë të rëndësishme që duhet të merren parasysh kur analizojmë fenomenin e bullizmit. Në të gjitha kategoritë djemtë janë më të përfshirë në fenomenin e bullizmit sesa vajzat. Por djemtë pranojnë se janë më shumë agresorë (68.3% e djemve të përfshirë në fenomenin e bullizmit) sesa viktimë (52.7%), ndërsa (deri në një shkallë të vogël) vajzat kanë më shumë gjasa të jenë viktimë, (48.3%) sesa agresore


(31.7%). Gjithashtu për kategorinë e agresorëve, djemtë janë shumë më të përfshirë se vajzat me një diferencë relativisht të lartë prej 20%.

Grafiku 9. Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë dhe gjinisë



Ndërsa për sa i përket faktit se në cilën klasë/ grup moshë është më shumë i përhapur fenomeni i bullizmit sikurse shihet qartë në grafikun e mëposhtëm, klasa XI-të që i përket edhe moshës 15-16 vjeç është më shumë e përfshirë në dukurinë e bullizmit e ndjekur nga klasa e V-të që i përket moshës 10-11 vjeç. Klasat ku shfaqet më pak dukuria e bullizmit janë klasa e IV-të dhe klasa e XII-të pra ekstremitet (klasa më e ulët dhe e lartë e marrë në studim). Sikurse e shohim në të gjitha klasat, viktimat janë në një numër më të lartë se agresorët, por kjo ulet në klasën e XI ku kemi një përqindje pothuajse të barabartë agresorësh dhe viktimash me një diferencë prej 1 %, ndërsa ka një diferencë të ndjeshme në klasën e V-të ku viktimat (14.6) janë ndjeshëm në përqindje më të lartë se agresorët(4.7).


Grafiku 10. Nxënësit e përfshirë në bullizëm sipas kategorisë dhe klasës



Shpeshtësia e bullizmit sipas llojit të shkollës dhe zonës gjeografike


Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur shkalla e përhapjes së bullizmit sipas llojit të shkollave publike ose private. Sikurse e shohim, nxënësit e shkollave private pohojnë se janë më shpesh të përfshirë në dukurinë e bullizmit: 26% kundrejt 20 % të nxënësve të shkollave publike.

Grafiku 11. Prevalenca e bullizmit sipas llojit të shkollës



Në grafikun e mëposhtëm shohim shpeshtësinë e dukurisë së bullizmit sipas ndarjes shkollë urbane apo rurale. Sikurse shihet në zonat rurale dukuria e bullizmit është më pak e pranishme duke qenë se 17% e nxënësve pohojnë se janë të përfshirë në dukurinë e bullizmit kundrejt 20% të nxënësve të zonave urbane.

Grafiku 12. Prevalenca e bullizmit sipas rajonit



Format e bullizmit

Forma e bullizmit sipas ndarjes gjinore


Analizat statistikore ndërkombëtare në lidhje me format e ndryshme të bullizmit kanë treguar se, në përgjithësi, ata kanë tendencë të vajojnë në një shkallë të konsiderueshme. Nxënësit që kanë raportuar se kanë pësuar bullizëm në një mënyrë të veçantë, shpesh janë viktimë edhe të formave të tjera të bullizmit.

Gjithashtu duhet vënë në dukje se të njëjtat forma të bullizmit nuk mund të konsiderohen veçmas sepse ato pothuajse gjithmonë ndodhin së bashku. Për shembull, një nxënës i cili është sulmuar në mënyrë të përsëritur për shkak të prejardhjes së tij racore, ka të ngjarë që

të raportojë si bullizmin verbal ashtu dhe atë racor. Në mënyrë të ngjashme, nxënësit shpesh raportojnë si bullizëm fizik edhe bullizmin që përfshin marrjen e parave ose dëmtimin e sendeve personale ose kërcënimin (Olweus 2007)

Në kampionin tonë forma më e përhapur e bullizmit është ai psikologjik: "Nxënësit e tjerë më kanë përgojuar ose kanë përhapur thashetheme të rreme rreth meje dhe janë përpjekur që të tjerët të më marrin inat" e cila ka ndodhur njëlloj si për djemtë ashtu edhe për vajzat me 45% të rasteve e ndjekur nga bullizmi verbal: "Unë jam përqeshur, më janë thënë gjëra fyese, ose jam vënë në lojë nga një ose disa nxënës?" në 37% të rasteve, e cila i ka ndodhur më shumë djemve. Dhe në vendin e tretë është bullizmi fizik "Unë jam goditur, shkelmuar, shtyrë ose mbyllur brenda" në 33% të rasteve, ku djemtë janë ndjeshëm më të përfshirë në këtë lloj bullizmi sesa vajzat. Sikurse e shohin bullizmi virtual/ kibernetik zë vendin e fundit. Siç duket nga grafiku për shumicën e llojeve të bullizmit nuk është se ka diferenca të ndjeshme gjinore. Por bullizmi social është më i përhapur midis djemve me 24% kundrejt 15% të vajzave dhe bullizmi seksual në 24% të djemve dhe 13% të vajzave.

Grafiku 13. Format e bullizmit sipas nxënësve të cilët raportuan se kishin pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë




Në grafikët e mëposhtëm 14 dhe 15 jepet një analizë më e thelluar e ndryshimeve të mundshme gjinore duke marrë në analizë kush kanë qenë viktimat dhe nga kush. Kjo analizë na sqaron më tej se çfarë forme bullizmi është përdorur nga secila gjini.


Rezultatet në grafikët më poshtë tregojnë se bullizmi psikologjik, verbal dhe fizik është mbizotërues si tek djemtë edhe tek vajzat. Por, kur vajzat sulmojnë vajzat ato tentojnë të përdorin forma më anonime sikurse është bullizmi jo i drejtpërdrejtë, ku vajzat pohojnë se e përdorin më shumë se djemtë bullizmin virtual. Ndërsa djemtë pohojnë se janë më shumë pre e bullizmit seksual sesa vajzat.

Për djemtë bullizmi në internet renditet si forma e fundit e raportuar e bullizmit. Ndërsa djemtë gjithashtu ushtrojnë bullizëm ndaj djemëve të tjerë me mjete seksuale dhe komente racore.

Grafiku 14. Format e bullizmit midis vajzave të cilat raportuan se kishin pësuar bullizëm pësuar 2-3 herë në muaj ose më shumë



Grafiku 15. Format e bullizmit midis djemve të cilët raportuan se kishin bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë




Format e bullizmit sipas nivelit të shkollës

Në Grafikon 16 jepet llojet e bullizmit që janë më të pranishme sipas tipit të shkollës 9-vjeçare, e mesme dhe profesionale. Sikurse e shohin bullizmi fizik është shumë më i pranishëm në shkollat profesionale me rreth 61% të rasteve krahasuar me 41 % të shkollave të mesme dhe 48% të shkollave 9-vjeçare.


Në shkollat profesionale, prezenca e djemve është më e lartë se e vajzave, gjë e cila tregon se bullizmi me anë të mjeteve fizike është një karakteristikë e veçantë e djemve dhe është më i pranishëm në klasat e ulëta. Gjithashtu me një diferencë domethënëse bullizmi virtual është më i pranishëm në shkollë të mesme në 60% të rasteve krahasuar me 48% të shkollat 9-vjeçare dhe 44% profesionale. Gjithashtu edhe bullizmi racor është më i përhapur në shkollat profesionale me 39% , e ndjekur nga ato 9-vjeçare dhe më pak në shkollat e mesme me 22 %.

Grafiku 16. Format e bullizmit sipas nivelit të shkollës (2-3 herë në muaj ose më shumë)



Sikurse e shohim nga grafiku i mëposhtëm forma më e përhapur e bullizmit në shkollat private në përqindje të barabartë është bullizmi verbal dhe psikologjik. Me diferencë të ndjeshme bullizmi social (21%), fizik (36%) dhe seksual (20%) janë më të përhapur tek shkollat publike. Madje nëse bullizmi fizik është i treti më i pranishëm nga nxënësit e shkollave publike, ky lloj bullizmi në shkollat private është më pak i pranishëm.


Grafiku 17. Format e bullizmit sipas llojit të shkollës (2-3 herë në muaj ose më shumë)



Në sa forma nxënësit kanë qenë pre e bullizmit?

Sikurse e shohim nga grafiku i mëposhtëm pjesa më e madhe e nxënësve (54.4%) pohojnë se kanë qenë viktima vetëm të një lloji bullizmi, ndërsa pjesa tjetër rreth 46.6 % pohojnë se kanë përjetuar më shumë se një lloj bullizmi. Vajzat pohojnë më shumë se djemtë se kanë qenë viktima të një lloj bullizmi. Bullizmi më i përhapur tek ata që kanë pohuar se përjetojnë vetëm një lloj bullizmi është ai psikologjik (29%) i ndjekur nga ai verbal (19%) dhe fizik (17%).


Grafiku 18. Nxënësit viktimë të bullizmit ndaj një formë të vetme bullizmi sipas gjinisë (2-3 herë në muaj)



Sa kohë zgjati bullizmi?

Nga grafiku del se 73% të nxënësve viktimë të bullizmit raportojnë se kjo dukuri zgjati “një ose dy javë”, 13% raportojnë se kjo dukuri zgjati “pothuajse një muaj”, ndërsa 6% e nxënësve viktimë raportuan se kjo dukuri zgjati “disa vjet”. Nëse ka shumë nxënës në shkollë që janë viktimë për një kohë të gjatë, kjo tregon se duhet të nisë dhe të forcohet menjëherë përpjekjet për të parandaluar bullizmin. Por nga studimet është parë, se nxënësit, që raportojnë se janë viktimë të bullizmit për rreth një vit ose më shumë nuk shpëtojnë nga kjo sjellje edhe pas përpjekjeve të suksesshme që shkolla bën për ta luftuar bullizmin.


Grafiku 19. Kohëzgjatja e bullizmit e raportuar nga nxënësit të cilët kishin pësuar bullizëm 1-2 herë ose më shumë



Viti/ moshë, gjinia dhe numri i agresorëve që kanë sulmuar viktimat e bullizmit

Sikurse e shohim nga grafiku djemtë raportojnë se kanë qenë viktimë të bullizmit kryesisht nga djemtë me një përqindje të konsiderueshme prej 71.1%. Midis vajzave viktime të bullizmit afërsisht gjysma (44%) raportojnë se janë sulmuar nga djem duke na vërtetuar edhe një herë që djemtë janë më agresor në këtë dukuri, 35.5% janë sulmuar vetëm nga vajza dhe 20.7% janë sulmuar edhe nga djem edhe nga vajza me një diferencë të ndjeshme nga djemtë.

Grafiku 20. Gjinia e nxënësve të cilët kanë pësuar bullizëm dy tre herë në muaj ose më shumë dhe e atyre që ushtrojnë bullizëm ndaj tyre



Sikurse e shohim nga tabela pjesa më e madhe e nxënësve janë sulmuar nga nxënësit në klasën e tyre në 55% të rasteve, ndjekur nga nxënësit nga klasa të ndryshme por nga i njëjti vit në 20% të rasteve dhe 18% e nxënësve janë sulmuar nga nxënës në klasa më të larta. Diferencat gjinore nuk janë domethënëse ndaj nuk po i marrim në analizë.

Ndërsa për sa i përket numrit të nxënësve që kanë sulmuar viktimat pjesa më e madhe e viktimave rreth 52% pohojnë se janë sulmuar vetëm nga një nxënës e ndjekur me 36 % nga një grup prej dy tre nxënësish. Ky i fundit është edhe fenomeni më problematik sepse zakonisht agresorët që sulmojnë në grup tentojnë të formojnë ato që në shkolla quhen grupe gangstere që përfshihen në veprimtari kriminale dhe që tentojnë të mbajnë armë me vete në shkollë duke rrezikuar jetën e nxënësve të tjerë.

Tabela 3. Klasa dhe numri i nxënësve të cilët ushtrojnë bullizëm (2-3 herë ose më shumë)

Në cilën klasë ndodhet nxënësi i cili ushtron bullizëm ndaj teje ?	SEKSI				Totali	
	Vajzë		Djalë			
	NR	%	NR	%	NR	%
Në klasën time	134	61	112	50	264	55
Në një klasë tjetër por në të njëjtin vit.	43	20	44	20	87	20
Në vitet më të larta	30	14	48	21	78	18
Në vitet më të ulëta	6	3	10	4	16	4
Edhe në vite më të ulëta edhe në ato të larta	7	3	11	5	18	4
Total	220	100	225	100	445	100
Nga sa nxënës ke pësuar bullizëm ?	SEKSI				Totali	
	Vajzë		Djalë			
	NR	%	NR	%	NR	%
Kryesisht nga një nxënës	128	52	108	51	236	52

Nga një grup prej dy ose tre nxënësish	95	39	68	32	163	36
Nga një grup prej katër deri në nëntë nxënësish	10	4	18	9	28	6
Nga një grup prej më shumë se dhjetë nxënësish	4	2	8	4	12	3
Nga nxënës ose grupe të ndryshme nxënësish	7	3	8	4	15	3
Total	244	100	210	100	454	100

Ku ndodh bullizmi


Grafiku 21 paraqet rezultatet për vendet ku ka ndodhur bullizmi. Ky informacion mund të jetë i dobishëm në rishikimin dhe përmirësimin e sistemit mbikëqyrës të shkollës dhe në caktimin e mënyrave më të mira për menaxhimin e lëvizjes së nxënësve nëpër shkolla, si dhe nga shkolla. Në këtë aspekt, në përpjekjet kundër dhunës, mund të ndikojë pozitivisht rregullimi i sistemit mbikëqyrës, siç është prania e të rriturve që janë të pranishëm gjatë periudhave të pushimeve dhe që përfshijnë shoferin e autobusëve në shkollat private dhe stafin tjetër jo mësimdhënës. Për të zbuluar se ku ndodhin më shpesh veprimtaritë bulliste, nxënësit u pyetën për vendet ku ata kanë qenë pre e këtyre veprimtarive. Duke qenë se nxënësit mund të bëhen pre e bullizmit në vende të ndryshme, ata u udhëzuan që të shënojnë më shumë se një përgjigje.

Rezultatet janë të bazuara në llogaritjen e përqindjes së nëngrupit të nxënësve që janë përgjigjur një- dy vende ose më shumë. Pjesa dërrmuese, 40% e nxënësve, u shprehën se ata kishin qenë viktima të bullizmit “*në klasë, kur mësuesja nuk ishte e pranishme*”. Zona e dytë më e nxehtë ku shfaqet kjo dukuri ishte “*në oborr/ fushën e sportit*” me një shifër prej 39% . Ashtu siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme, vendi i tretë më i përhapur i kësaj dukurie ishte “*në korridore/ shkallë*” me 19% të rasteve.


Nga studimi u pa se djemtë kanë një diferencë më të madhe (71%) për të raportuar se kanë qenë më shpesh viktima të bullizmit “*në tualete*”, në krahasim me 29% të vajzave. Gjithashtu , djemtë janë më të prirë se vajzat që të raportojnë se janë viktima “*në oborrin e shkollës*” dhe “*në korridore, shkallë*” ndërsa sikurse e shohim me një diferencë të madhe në % vajzat janë më shumë viktima të bullizmit në mense, në klasë edhe kur mësuesja është e pranishme ose jo dhe diku tjetër në shkollë. Ku pjesa më e madhe kanë raportuar tek alternativa tjetër “ *në byrektoren apo dyqanin brenda shkollës; mbrapa shkollës; kafen afër shkollës*”

Siç e shohim në disa shkolla, nuk është e pazakontë që një pjesë e mirë e bullizmit po ndodh në klasat me mësuesin e pranishëm. Në këtë rast, kjo sigurisht që duhet të jetë një çështje shqetësuese për stafin e mësuesve.

Grafiku 21. Vendet ku ndodh bullizmi, të raportuara sipas nxënësve (nga nxënësit të cilët kanë pësuar bullizëm 1-2 herë ose më shumë)



Grafiku 22. Vendet ku ndodh bullizmi, të raportuara sipas gjinisë (për nxënësit të cilët pësojnë bullizëm 1-2 herë ose më shumë)





A i kanë thënë ndokujt nxënësit, të cilët kanë qenë viktime të bullizmit?

Për të reduktuar me sukses bullizmin në shkollë, duhet që çdo shkollë të bëhet shkollë raportuese, që do të thotë se, si nxënësit viktime edhe ata të cilët nuk pësojnë bullizëm duhet të ndihen të fuqizuar për të raportuar dhe diskutuar incidentet e mundshme të bullizmit me mësuesit dhe të rriturit në shtëpi.

Siç e shohim nga Grafiku 23, pjesa më e madhe e nxënësve (pra 73% e tyre) që janë shprehur se kanë qenë pre e veprimtarive bulliste pohojnë se i kanë treguar dikujt për këtë dukuri, ndërsa 27% e nxënësve nuk kanë parapëlqyer që t'i tregojnë dikujt. Duket se ka një lidhje mjaft të rëndësishme ndërmjet gjinisë së nxënësve dhe faktit nëse ata i kanë treguar dikujt apo jo që kanë qenë viktime të bullizmit, ku vajzat kanë një prirje më të madhe se djemtë për t'i treguar dikujt.


Grafiku 23. Raportimi i bullizmit sipas gjinisë së nxënësve (që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë) dhe vendi ku kanë raportuar



Ndërsa për sa i përket faktit se ku kanë raportuar viktimat e bullizmit, pjesa më e madhe pohojnë se kanë raportuar tek prindërit, kujdestarët, e ndjekur me përqindje të barabartë nga shokët/ shoqet dhe mësuesi kujdestar. Ndërsa tek alternativa tjetër që zë edhe përqindjen më të vogël nxënësit cituan punonjës social dhe psikologun.

Në grafikun e mëposhtëm është bërë një analizë e raportimit sipas klasave. Sikurse e shohim klasat që raportojnë më shumë janë klasa e VIII-të (16%) dhe klasa e VI-të (15%) dhe klasa e IX –të (13.4%). Ndërsa klasat që raportojnë më pak është klasa e XII (15.3%). Tërheq vëmendjen klasa e V, nxënësit e së cilës, megjithëse janë më të përfshirë në dukurinë e bullizmit, sikurse e shohim nuk raportojnë në krahasim me klasat e tjera.

Grafiku 24. Ku kanë më shumë besim nxënësit, sipas klasës (që kanë pësuar bullizëm 2-3 herë në muaj ose më shumë)



SESIONI III. Ndjenjat e nxënësve në lidhje me viktimën dhe agresorin dhe qëndrimet e tyre lidhur me veprimtaritë bulliste

Përfshirja e mundshme e nxënësve në bullizëm në të ardhmen

Kur të 2377 nxënësit e kampionit të marrë në studim pyeten nëse ata do të bëhen pjesë e dukurisë së bullizmit kur do të kenë një nxënës që nuk do e pëlqejnë, pjesa dërrmuese prej 39% pohojnë se nuk do përfshihen, e ndarë si më poshtë vijon:

1. Me “absolutisht jo” janë 22% e numrit të përgjithshëm të nxënësve të kampionit të marrë në studim.
2. Me “jo” janë 11% e numrit të përgjithshëm të nxënësve të kampionit të marrë në studim.
3. Me “Jo, nuk mendoj se do të ndodhë” janë 5%
4. Mendojnë se do të përfshihen i është përgjigjur 9% e numrit të përgjithshëm të nxënësve.
5. Mbajnë qëndrim asnjanes (neutral) rreth 7 % e tyre .

Për sa i përket diferencave gjinore sikurse shohim në tabelën 4, se djemtë në 18% të rasteve, pohojnë më shumë se vajzat (12%), se do përfshihen në dukurinë e bullizmit nëse do kishin një bashkëmoshatar që nuk do e pëlqenin me 18% krahasuar me 12 % të vajzave.

Tabela 4. Përfshirja e nxënësve në fenomenin e bullizmit në të ardhmen

Mendoni se do merrni pjesë në bullizëm ndaj një nxënësi që ju nuk e pëlqeni ?	Seksi				Totali	
	Vajzë		Djalë			
	N	%	N	%	N	%
Po	64	5%	121	11%	185	4%
Po.ndoshta	94	7%	75	7%	169	4%
Shuma e grupit	158	12%	196	18%	354	9%
Nuk e di (neutral)	150	12%	155	14%	305	7%

Jo, nuk mendoj	115	9%	103	10%	218	5%
Jo	221	17%	245	23%	466	11%
Sigurisht që jo	609	47%	324	30%	933	22%
Shuma e grupit	945	73%	672	62%	1617	39%
Pa përgjigje	42	3%	59	6%	101	2%
Totali	1295	100%	1082	100%	2377	100%

Empatia kundrejt viktimave

Numri i përgjithshëm i nxënësve që raportuan se në rastet kur janë ndodhur para një ngjarje bulliste, atyre u ka ardhur keq dhe kanë dashur ta ndihmojnë personin viktimë të kësaj dukurie, duke shprehur në këtë mënyrë edhe një qëndrim pro- viktimë, është 79% e numrit të përgjithshëm të kampionit të marrë në studim, ndërsa 17% e nxënësve janë përkrahës të agresorit. Sikurse e shohim vajzat janë më empatike se djemtë dhe pohojnë më shumë se do të ndihmonin në 71% të rasteve kundrejt 55% të rasteve të djemve.

Është e rëndësishme të kuptohet se dallimet ndërmjet ndjenjës së empatisë dhe veprimit ose ndërhyrjes që mund të bëjnë nxënësit rrjedh nga fakti se ata kanë frikë se mund të ishin vetë viktima të këtij fenomeni.

Tabela 5 Empatia e nxënësve me viktimat e bullizmit


Kur sheh një nxënës të moshës tënde që pëson bullizëm në shkollë, çfarë ndjen apo mendon?	Seksi				Totali	
	Vajzë		Djalë			
	N	%	N	%	n	%
Kjo është ajo që ai ose ajo meriton	124	10%	144	13%	268	11%
Nuk ndjej shumë	47	4%	83	8%	130	5%
Pro-agresorit	171	13%	227	21%	398	17%
Më vjen pak keq për të	155	12%	211	20%	366	15%
Më vjen keq për të dhe dua ta ndihmoj	924	71%	593	55%	1517	64%
Pro-viktimës	1079	83%	804	74%	1883	79%
Pa Përgjigje	45	4%	51	5%	96	4%
Totali	1295	100%	1082	100%	2377	100%

Frika e nxënësve se mos bëhen viktima të bullizmit

Në grafikun e mëposhtëm jepet përqindja dhe numri i nxënësve që janë në një shkallë të caktuar të frikësuar se mos bëhen viktime të bullizmit nga nxënës të tjerë. Rezultatet e kësaj tabele mund të shihen si tregues i një aspekti të rëndësishëm sikurse është klima ose kultura e shkollës.

Sikurse e shohim edhe nga rezultatet e grafikut në fjalë, pjesa dërrmuese e 60% të nxënësve të marrë në studim, shprehen se nuk kanë kurrë frikë se mos bëhen viktime të bullizmit dhe rrallëherë kanë frikë (15%) dhe vetëm 21 % e nxënësve kanë frikë ndonjëherë dhe më shumë herë se mos bëhen viktime të bullizmit.

Grafiku 25. Nxënësit të cilët kanë frikë se mund të pësojnë bullizëm në shkollë



Reagimi i bashkëmoshtarëve

Në tabelën 6 janë paraqitur rezultatet e reagimeve të nxënësve ndaj rasteve të bullizmit. Për sa i përket reagimit që mbajnë nxënësit kur kanë qenë dëshmitarë të veprimtarive bulliste, vajzat raportojnë një shifër në përqindje më të lartë sesa djemtë në ndihmën që do të jepnin në një mënyrë a në një tjetër nxënësit/nxënëses që po pëson bullizëm. Konkretisht, 33.4% e nxënësve pohojnë se do ta ndihmonin nxënësin/nxënësen që po pëson bullizëm ku vajzat pohojnë më shumë se djemtë që do ndihmonin me një diferencë prej 10% midis tyre.

Nga tabela del gjithashtu se 41 % e nxënësve të gjithë kampionit raportojnë se asnjëherë nuk e kanë vënë re që një nxënës i moshës së tyre po pëson bullizëm. Nga kjo del se, me sa duket, kemi një përqindje të lartë të nxënësve që ose nuk e kuptojnë kur një shok i tyre po pëson bullizëm, ose nuk kanë dëshiruar të pohojnë se kjo ndodh në shkollën e tyre, thjesht për të ruajtur imazhin e saj.

Ndërsa 13 % e nxënësve pohojnë se nuk bëjnë asgjë, por mendojnë se duhet të ndihmojnë nxënësin që po pëson bullizëm dhe 3% e tyre vetëm shikojnë dhe janë spektatorë pasivë të këtij fenomeni. Ndërsa 2% e nxënësve marrin pjesë në bullizëm, ata janë spektatorë në mbështetje të agresorit, ku vendin më të madh e zënë djemtë.

Tabela 6. Përgjigjet ndaj incidenteve të bullizmit të bashkëmoshatarëve: ndërmarrja e veprimeve për të ndihmuar

Si reagoni ju zakonisht kur shihni ose kuptoni se një nxënës I moshës tënde po pëson bullizëm nga nxënës të tjerë ?			
Si reagoni ju zakonisht kur shihni ose kuptoni se një nxënës I moshës tënde po pëson bullizëm nga nxënës të tjerë ?	Seksi		Totali
	Vajza	Djali	
Nuk kam vënë re asnjëherë se një nxënës I moshës sime po pëson bullizëm	37%	45%	41%
Nuk marr pjesë në bullizëm	2%	3%	2%
Nuk bëj asgjë,por mendos se bullizmi është I pranueshëm	1%	3%	2%
Thjesht shikoj c`po nodh	3%	5%	3%
Nuk bëj asgjë por mendoj se duhet të ndihmoj nxënësin I cili po pëson bullizëm	14%	10%	13%
Përpiqem që në një mënyrë apo tjetër të ndihmoj nxënësin që po pëson bullizëm	39%	28%	34%
Pa përgjigje	4%	5%	5%
Totali	100%	100%	100%


SESIONI I IV: Si reagojnë të tjerët?

Përgjigjet e këtij seti pyetjesh sigurojnë një informacion të cmuar rreth përpjekjeve të shkollës për t`iu kundërpërgjigjur bullizmit.

Ndërrhyrja e bashkëmoshatarëve

Në grafikun e mëposhtëm vërehet se vetëm 18,5% e nxënësve pohojnë se bashkëmoshatarët janë përpjekur 'pothuajse gjithmonë' dhe "shpesh" të ndalojnë bullizmin në shkollë. Ndërsa 62.5% e nxënësve raportuan se bashkëmoshatarët, "pothuajse asnjëherë" (28.2%), "rrallëherë" 15.9% dhe 'ndonjëherë' 18.4% janë përpjekur të ndalojnë bullizmin në shkollën e tyre. Ndërsa 9% e nxënësve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.


Grafiku 26. Ndërhyrja në bullizëm: nxënësit të cilët kanë thënë se nxënësit e tjerë në shkollën e tyre përpiqen të ndalojnë një incident bullist në shkollë.



Përpjekjet e mësuesve për t'iu kundërpërgjigjur bullizmit

Prezantimi i të dhënave në Grafikon 27 jep një vlerësim mbi perceptimin që kanë nxënësve mbi përpjekjet e mësuesve për të luftuar bullizmin në shkollë. Kështu, shumica e nxënësve (43.4%) kanë perceptimin se mësuesit gjithmonë dhe shpesh përpiqen të ndalojnë një nxënës që pëson bullizëm në shkollë. Ndonëse 45.5% e nxënësve kanë perceptimin se mësuesit “kurrë”, “rrallëherë” dhe “ndonjëherë” kanë tentuar të ndalojnë fenomenin e bullizmit, dhe 11.2% e nxënësve nuk preferonin t’i përgjigjen kësaj pyetje. Rezultatet tregojnë se nxënësit perceptojnë se mësuesit të rriturit në shkolla ndërhyjnë më shumë sesa bashkëmoshatarët.

Grafiku 27. Ndërhyrja: Nxënësit të cilët raportuan se mësuesit apo të rriturit e tjerë në shkollë janë përpjekur të ndalojnë një incident bullist në shkollë.




Marrëdhënia shtëpi-shkollë

Rezultatet e treguara në grafikët e mëposhtëm na ofrojnë informacion rreth raporteve familje-shkollë, marrëdhënieve të prindërve me aktorët kryesorë të shkollës, në veçanti, pritshmëritë e shkollës për tu marrë me shqetësimet e prindërve që dyshojnë ose që fëmija i tyre u është ankuar se ka qenë viktimë e bullizmit. Për pyetjen nëse ka kontaktuar ndonjë person madhor i familjes më shkollën për të ndaluar bullizmin duket se perceptimi i nxënësve në 36% të rasteve është se familja nuk ka kontaktuar me shkollën, ndërsa 39% pohojnë se familja e tyre ka kontaktuar një herë (15%) ose disa herë me shkollën (24%) për faktin se ai/ajo ishte objekt sulmi nga nxënësit e tjerë. Ndërsa 25% e nxënësve nuk kanë preferuar ti përgjigjen kësaj pyetje.

Ndërsa për sa i përket kontaktit të familjes së agresorit me shkollën, sikurse e shohim, pjesa më e madhe e tyre nuk kontaktojnë me shkollën dhe një pjesë e madhe e nxënësve nuk kanë preferuar ti përgjigjen kësaj pyetje. Ndërsa 37% e prindërve të agresorit kanë kontaktuar një herë (21%) ose disa herë me shkollën (16%) .


Sikurse e shohim familja e viktimës e vazhdon kontaktin me shkollën më gjatë sesa familja e agresorit. Kryesisht familja e agresorit kontakton vetëm një herë me shkollën dhe në këto raste kur kërkohet nga kjo e fundit.

Grafiku 28. Ndërhyrja: Nxënësit të cilët kanë thënë se prindërit janë përpjekur për të ndaluar një incident bullist në shkollë (nga prespektiva e viktimës dhe agresorit)



Ndërsa kur agresori pyetet nëse mësuesi kujdestar apo ndonjë mësues tjetër ka kontaktuar me të rreth faktit që po ushtron bullizëm tek një ose disa nxënës të tjerë, pjesa më e madhe e nxënësve nuk dëshirojnë të përgjigjen, në 33% të rasteve, e ndjekur nga nxënësit që pohojnë se 'ata nuk kanë folur me mua për këtë çështje' me 28% dhe vetëm 40% e agresorëve pohojnë se 'mësuesit kanë kontaktuar me ta një herë' (20%) ose 'disa herë' (20%) rreth faktit që po ushtrojnë bullizëm.

Grafiku 29. Ndërrhyrja në bullizëm: Agresorët që raportuan se të rriturit në shkollat e tyre përpiqen të flasin me ta për sjelljen e tyre



3.2 Besimet, qëndrimet dhe sjellja e mësuesve ndaj bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Prania e dhunës ndikon negativisht në klimën e shkollës, pasqyrohet në rritjen e shkallës së frikës, depresionit, të çrregullimeve psiko-somatike dhe keqësimit të shëndetit fizik të nxënësve. Këta faktorë, nga ana tjetër, ndikojnë në vëmendjen, në përqendrimin e nxënësve dhe, në fund, në rezultatet shkollore të tyre (Bauman & Del Rio, 2005).



Mësuesit kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën e nxënësve dhe mund të luajnë një rol kryesor në njohjen dhe në reagimin ndaj ngjarjeve bulliste (Dake, Telljohann, & Funk, 2003; Smith & Sharp, 1994). Mësuesit gjithashtu luajnë një rol kyç në identifikimin e shenjave të bullizmit dhe në thyerjen e kulturës së heshtjes të viktimave të bullizmit dhe të vëzhguesit (Smith & Shu, 2000). Një metaanalizë e trembëdhjetë studimeve arriti në përfundimin se një përbërës i rëndësishëm në arritjen e rezultateve të suksesshme në uljen e bullizmit në shkollë është i lidhur me shkallën e angazhimit të mësuesit për t'i dhënë fund dhunës (Pepler, Smith, & Rigby, 2004).

Qëllimi i këtij sesi është eksplorimi i qëndrimeve të mësuesve ndaj dukurisë së bullizmit dhe ekstremizmit. Ky objektivi i studimit është mbështetur në dy aspekte si e shohin mësuesit këto dy dukuri dhe si reagojnë shkollat ndaj tyre.

SESIONI I: Të dhënat socio-demografike të kampionit të mësuesve


Sikurse e shohim nga grafikët e mëposhtëm pjesa më e madhe e mësuesve në 81% të rasteve përkasin gjinisë femërore dhe vetëm 19% e tyre i përkasin gjinisë mashkullore. Për sa i përket shpërndarjes së mësuesve sipas nivelit të shkollës, 40% e mësuesve të marrë në studim japin mësim në arsimin e ulët të lartë që i takon klasave V-IX ; 20 % i përkasin shkollës së mesme, 25% i përkasin arsimit fillor (klasa I –V) dhe 5 % e kampionit të mësuesve i përkasin shkollave profesionale.

Ndërsa për sa i përket eksperiencës në punë pjesa më e madhe e kampionit të marrë në studim, 26% e tyre, kishin rreth 7 deri në 14 vjet që ishin mësuesimdhënës, me përqindje të barabartë prej rreth 19% ishin mësuesit/et që kishin 2 vite në mësuesimdhënie dhe 15-20 vite. Dhe vetëm 5% e mësuesve kishin më pak se një vit në profesionin e mësuesimdhënës.




Pjesa më e madhe e mësuesve, 95% të kampionit tonë, punojnë në sektorin publik dhe 5% në atë privat. Ndërsa për sa i përket pozicionit në punë, pjesa dërrmuese -48% e kampionit, janë mësues kujdestarë, ndjekur me 46% mësues lënde, ndërsa me përqindje të barabartë, pjesa tjetër e kampionit mban pozicionin e drejtorit të shkollës (prej 3%) dhe punonjësit social/ psikologut shkollor (prej 3%).

Grafiku 32. Mësuesit sipas pozicionit në punë



Grafiku 33. Mësuesit sipas sektorit




SESSIONI II: : Shkalla e përhapjes së bullizmit dhe karakteristikat me te cilat shfaqet ai

Shkalla e përhapjes së bullizmit sipas mësuesve

Për sa i përket perceptimit që kanë mësuesit në lidhje me praninë e bullizmit në shkollën e tyre pjesa dërrmuese e mësuesve mendojnë në rreth 59% të rasteve se ekziston fenomeni i bullizmit në shkollën e tyre; 22% pohojnë se nuk ekziston dhe 20 % e mësuesve kanë pohuar se nuk janë në dijeni të kësaj sjellje agresive.


Grafiku 34. Prevalenca e bullizmit sipas perspektivës së mësuesit



Format e bullizmit më të përhapur sipas perceptimit të mësuesve


Sikurse shihet nga grafiku i mëposhtëm rreth 78% e mësuesve pohojnë se bullizmi verbal është forma më e përhapur e bullizmit në shkollën e tyre, e ndjekur nga bullizmi psikologjik në 61 % të rasteve dhe pothuajse gjysma e mësuesve (51%) pohojnë se bullizmi virtual është bullizmi më i përhapur. Ndërsa format e bullizmit racor dhe seksual janë më pak të përhapurit, sipas mësuesve.

Grafiku 35. Format e bullizmit sipas perspektivës së mësuesve.




Sikurse e shohim nga Grafiku 35 mësuesit mendojnë se bullizmi virtual është shumë i pranishëm midis nxënësve duke qenë se e rendisin të tretin më të përdorur. Dhe pyetjes se 'si ata mendojnë se manifestohet ai', pjesa më e madhe 72% mendojnë se nxënësit shkruajnë fjalë të papërshtatshme dhe lënduese online, 55% mendojnë se nxënësit dërgojnë mesazhe të papërshtatshme dhe lënduese dhe 35 % mendojnë se nxënësit shkarkojnë/shpërndajnë imazhe të papërshtatshme online. Të gjitha këto sjellje mësuesit mendojnë se ndodhin përmes telefonave celularë dhe rrjeteve sociale në rreth 70% të rasteve.

Grafiku 36. Bullizmi virtual sipas mësuesve



Lidhur me pyetjen se kush është më i përfshirë në fenomenin e bullizmit në aspektin gjinor, ne shohim nga Grafiku 37 se sipas mësuesve, këto sjellje agresive pothuajse ushtrohen njëllëj si nga vajzat dhe me një përqindje shumë pak më të lartë nga djemtë. Kjo do të thotë se djemtë dhe vajzat janë pothuajse të përfshirë njëllëj në dukurinë e bullizmit


Grafiku 37. Sjelljet bulliste sipas gjinisë



Ku ndodh bullizmi?

Për sa i përket vendit ku shfaqen më shumë sjellje të tilla mësuesit pohojnë në 72% të rasteve se këto sjellje ndodhin në *oborrin e shkollës/ fushën e sportit*, ndjekur me 57% të rasteve, *kur nxënësit ndodhen brenda në klasë kur mësuesja nuk është e pranishme*, dhe në 46% të rasteve pohojnë se këto sjellje ndodhin jashtë ambientit të shkollës kur nxënësi është *rrugës për ose nga shkolla*. Ndërsa 14% e mësuesve pohojnë se këto sjellje ndodhin *në klasë në prani të mësuesit/es*.


Grafiku 38. Vendet ku ndodh bullizmi sipas mësuesve



Motivet e viktimizimit

Nga përqindjet në Grafikon 39 shohim se sipas perceptimit të mësuesve ata pohuan se ka *“shumë të ngjarë”* dhe *“ndonjëherë të ngjarë”* që nxënësit të bëhen viktimë për shkak të pamjes së jashtme në 73% të rasteve. Motivi i dytë më i përhapur sipas mësuesve janë nxënësit që kanë vështirësi në të folur në 68% të rasteve ndërsa motivi i tretë më i përhapur është për shkak të pabarazisë së nxënësve në fuqinë fizike. Motivet më pak të përhapura që nxënësit të bëhen viktimë sipas mësuesve janë nxënësit që janë të shkëlqyer në sporte, nxënësit e pakicave kombëtare dhe për shkak të orientimit seksual (homoseksual, biseksual, lesbike).

Grafiku 39. Motivet nxitëse të bullizmit




A u kanë treguar nxënësit që pësojnë bullizëm mësuesve të tyre ?

Pyetja e mëposhtme synon të tregojë se sa raste raportimi janë bërë në shkollë në vitin e fundit. Sikurse e shohim, pjesa më e madhe e mësuesve pohojnë se ka pasur më pak se 10 raste bullizmi të raportuar në vitin e fundit shkollor, 27% nuk janë përgjigjur pyetjes duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë rast raportimi, 6% pohojnë se ka pasur 11 deri në 20 raste raportimi dhe 3% e mësuesve thonë se ka pasur më shumë se 20 raste.

Grafiku 40. Numri i incidenteve bulliste në shkolla


Sa raste bullizmi janë raportuar në shkollë në vitin e fundit shkollor?



SESIONI III - Strategjitë për të parandaluar bullizmin

Pyetjes nëse ka një politikë kundër bulliste në shkollën e tyre, pjesa më e madhe e mësuesve (56%) pohojnë se ata kanë politika kundër bulliste në shkollën e tyre, 17% pohojnë se nuk kanë dhe 27% e mësuesve nuk e dinë këtë fakt..

Grafiku 41. Ekzistenca e një politike anti-bulliste




Trajnimi i mësuesve për të mësuar strategji për të luftuar bullizmin është thelbësor që ata të luftojnë në mënyrë sa më efektive bullizmin dhe të merren me dinamikën e tij komplekse. Mësuesit jo të trajnuar nuk provojnë vetëm një ndjenjë zhgënjimi, dëshpërimi, pësjtjellimi dhe lodhjeje për paaftësinë e tyre për të perceptuar dhe për të ndihmuar në të tillë situata, por disa mbajnë edhe një barrë të fajit që braktisin viktimat e kësaj lloj dhune. Shumë përpiqen të ndërhyjnë, por mungesa e besimit në aftësinë e tyre për të rregulluar problemin, kjo e shoqëruar edhe me natyrën e ndërlikuar të sjelljeve bulliste, bën që shumë mësues të ngurojnë për të dhënë ndihmën dhe për të ndërhyrë (Howard, 2001).


Por kur i pyesim mësuesit nëse kanë marrë trajnime në lidhje me njohjen dhe trajtimin e fenomenit të bullizmit sikurse e shohim nga grafiku pjesa dërrmuese, 77% e tyre pohojnë se nuk kanë marrë trajnime të tilla dhe vetëm 23% pohojnë se kanë marrë trajnime të tilla.

Ndërkohë rreth 83% pohojnë se kanë nevojë të marrin trajnime në lidhje me njohjen dhe trajtimin e këtij fenomeni, 10 % e mësuesve janë të pasigurt dhe 7% e tyre nuk janë dakord se ka nevojë për trajnime. Por nëse i referohemi grafikut shohim se pjesa më e madhe e mësuesve, rreth 87% e tyre pohojnë se kanë një nevojë shumë të madhe për udhëzime/ politika kombëtare për të luftuar fenomenin e bullizmit dhe vetëm 9% e mësuesve nuk janë shumë dakord me nevojën për politika të tilla.

Grafiku 42. Trajnimi i mësuesve



Grafiku 43. Niveli i besimit të mësueseve për ekzistencën e një udhëzuesi kundërbullizëm në nivel kombëtar



Sa i përket ndërhyrjeve dhe masave parandaluese të ndërmarra nga shkollat, shohim se shumica e shkollave shpesh ndërhyjnë në nivel shkolle dhe marrin masa të tilla si mbikëqyrja efektive e nxënësve jashtë klasës, me 39% të rasteve; ndërsa në nivel klase, shumica e shkollave kanë zhvilluar dhe vendosur rregulla në klasë (75%); në nivel individual, shumica e mësuesve konfirmojnë se ofrojnë këshillim individual për agresorin në 59% të rasteve; dhe në nivel komunitar masat e marra nga shkollat në 23% të rasteve janë dhënia e informacionit për prindërit mbi fenomenin e bullizmit.

Duke analizuar se cilët janë ndërhyrjet më të shpeshta në shkolla, shumica e tyre përmendën ndërhyrje kryesisht në klasë dhe nivel individual si më poshtë:


1. Zhvillimi dhe vendosja e rregullave në klasë (75%);
2. Këshillime individuale për nxënësit që pësuan bullizëm (69%);
3. Këshillime individuale për nxënësit që ishin viktimë (61%);
4. Diskutime të rregullta në klasë rreth bullizmit (59%).

Tabela 7. Ndërhyrja në shkolla sipas nivelit për të luftuar fenomenin e bullizmit

Nivel shkolle	%
Supervizim efektiv të nxënësve jashtë klasës	39
Trajnim i stafit në lidhje me bullizmin	18
Riorganizimi i hapësirave fizike (p.sh klasave dhe vendeve të pushimit) për të ulur shfaqjen e bullizmit	33
Nivel klase	
Diskutime të rregullta për çështje që rrethojnë bullizmin	59
Përdorimi i materialeve kurrikulare kundërbulliste (p.sh video, libra)	24
Ushtrime në klasë si rol play, apo detyra me shkrim	31
Zhvillimi dhe vendosja e rregullave në klasë	75
Përfshirja e nxënësve në ekipe kundërbulliste	23
Veprimtari të udhëhequra nga nxënësit (p.sh prezantime, aktivitete)	39
Nivel individual	
Këshillim individual për nxënësit që kanë qenë viktime	61
Këshillim individual për nxënësit që kanë qenë agresorë	69
Këshillim në grup për nxënësit që kanë qenë agresorë	53
Këshillim në grup për nxënësit që kanë qenë viktime	47
Nivel komuniteti (prindërit)	
Sigurim informacioni për prindërit (p.sh gazetë, literaturë)	23
Organizimi i seminareve dhe prezantimeve me prindërit, etj	15
Pjesëmarrja e prindërve në programet kundërbulliste	14

Ndërsa për sa i përket pyetjes se *‘çfarë masash ka marrë shkolla kur janë përballur me një incident bullist’* sikurse e shohim rreth 63 % e mësuesve pohojnë se e kanë referuar rastin tek drejtorja e shkollës, gjysma e mësuesve, 50%, pohojnë se e kanë referuar rastin tek punonjësi social dhe psikologu shkollor, në 11% të rasteve nuk janë lejuar të marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore dhe, si masa më pak e përdorur në 3 % të rasteve, mësuesit pohojnë se nxënësit janë përjashtuar nga shkolla.

Grafiku 44. Ndërhyrja në shkollë: çfarë kishin bërë shkollat kur kishte ndodhur një incident bullist në shkollat e tyre?




SESIONI IV: Ekstremizmi Dhunshëm

Duke iu referuar dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm dhe pranisë së tij në shkollat shqiptare, studimi ka pasur për qëllim të maste qëndrimet e mësuesve në lidhje me intolerancën dhe shpeshhtësinë e ndodhjes së këtyre sjelljeve.


Pyetjes *‘nëse mësuesit janë ose jo dakord’* me disa nga pohimet e mëposhtme që paraqiten në grafik shohim se pjesa më e madhe e mësuesve nuk e tolerojnë dhunën dhe mendojnë se dialogu dhe toleranca janë e vetmja mënyrë për të zgjidhur konfliktet. Kështu 94% kanë pohuar se janë shumë dakord dhe dakord që dialogu dhe negociimi janë mënyra më e mirë për të zgjidhur konfliktet, ndërsa 91 % pohojnë se dhuna nuk duhet justifikuar kurrë, rreth 43 % pohojnë se janë dakord që mësuesit duhet ta shprehin lirisht besimin e tyre fetar, por ajo që duket shqetësuese është se 7% e mësuesve kanë pohuar se janë dakord që dhuna ndonjëherë duhet justifikuar kur bëhet për të mirë të fëmijës..

Grafiku 45. Besimet e mësuesve rreth dhunës dhe intolerancës



Ndërsa pyetjes nëse ‘ka ndodhur ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme në shkollën e tyre’, rreth 22% e mësuesve pohojnë se në shkollën e tyre nxënësit përdorin tema urrejtje ose ekstremiste, dhe 19% e tyre pohojnë se nxënësit kanë bërë mbishkrime me simbole, me shkrim apo vepra arti, që promovojnë mesazhet ose imazhe ekstremiste dhe 18% e nxënësve kanë akses në materiale ekstremiste online, duke përfshirë faqet e rrjeteve sociale. Ndërsa vetëm 12% e mësuesve pohojnë se kolegët e tyre përdorin terma urrejtje dhe ekstremiste.

Grafiku 46. Prevalenca e sjelljeve ekstremiste/intolerante në shkolla




Gjithashtu nga këndvështrimi i mësuesve, shumica dërrmuese e tyre kanë raportuar se nuk ka intolerancë fetare, etnike apo gjinore në shkollë: në marrëdhëniet mësues-nxënës; marrëdhëniet nxënës-nxënës dhe në marrëdhëniet brenda shkollës në përgjithësi. Më prevalente janë intoleranca gjinore (21%) dhe ajo etnike (12%) në marrëdhëniet nxënës-nxënës.

Tabela 8. Intolerance/ndjeshmëria gjinore në marrëdhëniet e ndryshme në shkolla.

Nga përvoja juaj personale në shkollë, ju lutem tregoni sa keni hasur ju incidentet e përmendura në marrëdhëniet e ndryshme në shkollën tuaj në vitin e fundit shkollor	Kurrë/Pothuajse asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh/Shumë shpesh	NA
Pandjeshmëria / intoleranca etnike në politikat e shkollës	85%	3%	1%	10%
Pandjeshmëria / intoleranca gjinore në politikat e shkollës	85%	3%	2%	11%
Pandjeshmëria / intoleranca fetare në politikat e shkollës	85%	3%	1%	11%
Pandjeshmëria / intoleranca etnike (marrëdhënia mësues-nxënës)	82%	7%	2%	8%
Pandjeshmëria/intolerance gjinore (Marrëdhëniet mësues-nxënës)	86%	5%	1%	9%
Pandjeshmëria / intoleranca fetare (marrëdhënia mësues-nxënës)	85%	4%	1%	10%
Pandjeshmëria / intoleranca etnike (marrëdhënia nxënës-nxënës)	79%	10%	2%	9%
Pandjeshmëria / intoleranca gjinore (marrëdhënia nxënës-nxënës)	71%	17%	4%	8%
Pandjeshmëria / intoleranca fetare (marrëdhënia nxënës-nxënës)	81%	7%	2%	10%
Pandjeshmëria / intoleranca etnike (marrëdhëniet midis stafit shkollor)	87%	3%	1%	9%
Pandjeshmëria / intoleranca gjinore (marrëdhëniet midis stafit shkollor)	86%	4%	1%	9%
Pandjeshmëria / intoleranca fetare (marrëdhëniet midis stafit shkollor)	86%	3%	1%	10%

Për sa i përket pyetjes se *kë shihnin mësuesit si strategjinë më të efektshme për të ndaluar shfaqjen e fenomeneve të tilla si intoleranca dhe ekstremizimi*, rreth 89% e mësuesve pohuan se janë shumë dakord që *diskutimi me nxënësit për ekstremizmin e dhunshëm dhe pasojat e tij* është strategjia më e mirë e ndjekur, në 88% të rasteve nga të mësuarit e nxënësve me *teknikat për zgjidhjen e konflikteve duke përfshirë ndërmjetësimin*, e ndjekur në vendin e tretë me 85% të mësuesve pohojnë si strategji të efektshme *informimin e prindërve dhe mësuesve për të njohur shenjat e para të ekstremizmit dhe radikalizmit*. Ndërsa si format më pak të preferuara nga mësuesit janë *“promovimi i ateizmin si zgjedhje po aq e vlefshme në jetë”* me 16% të rasteve dhe *“edukimi fetar (mësimi i një feje të caktuar dhe aspektet e saj të ndryshme: besimi, doktrina, ritualet, traditat, ritet)* ku vetëm 19% e mësuesve janë dakord me këtë strategji parandaluese.

Grafiku 47. Strategjitë për parandalimin e ekstremizmit dhe intolerancës në shkolla sipas mësuesve



3.3 Perceptimet dhe qëndrimet e prindërve mbi bullizmin në shkollë


SESIONI I. Të dhënat socio-demografike

Sikurse shihet nga grafikët e mëposhtëm pjesa më e madhe e prindërve, që morën pjesë në studim e kanë fëmijën në shkollë 9-vjeçare, 74%, ndërsa fëmijët e 22% të prindërve të pyetur ndjekin shkollën e mesme dhe pjesa tjetër ,4% vijojnë shkollën profesionale.


Ndërsa për sa i përket ndarjes sipas klasave, pjesa më e madhe e prindërve që morën pjesë në studim e kanë fëmijën e tyre në klasë të katër, 15%, e ndjekur nga klasa e 6 me 14 %, dhe klasa e 8 me 12 %.

Pjesa më e madhe e prindërve e kanë fëmijën në shkollë publike, 93% kundrejt 7% e atyre që e kanë fëmijën në shkollë private. Gjithashtu pjesa më e madhe e prindërve që morën pjesë në studim kanë fëmijë të gjinisë femërore, 58% kundrejt 42 % që kanë djem.


48. Niveli i shkollës sipas prindërve




49. Fëmija im është në klasë të:



50. Lloji i shkollës




51. Gjina e fëmijës



SESIONI II: Shkalla e përhapjes së bullizmit dhe karakteristikat me të cilat shfaqet ky fenomen


Pyetjes kryesore nëse fëmija e tyre kishte qenë ose jo viktimë e bullizmit në vitin e fundit shkollor, pjesa dërrmuese e prindërve, 77% pohuan se fëmija e tyre nuk kishte qenë viktimë e bullizmit, vetëm 23 % pohuan se fëmija e tyre kishte qenë viktimë e bullizmit dhe 7 % e prindërve nuk ju përgjigjën kësaj pyetje.

Grafiku 52. Prevalenca e bullizmit sipas perspektivës së prindërve



Sipas prindërve fëmija e tyre ka qenë viktimë e bullizmit verbal në 44 % të rasteve, i ndjekur nga bullizmi social dhe i treti është bullizmi fizik. Ndërkohë 23 % pohojnë se fëmija e tyre ka qenë pre e bullizmit virtual.


Grafiku 53. Format e bullizmit sipas prindërve



Prindërit që pohuan se fëmija e tyre kishte qenë pjesë e bullizmit virtual pohuan në 73% të rasteve se *shkrimi i fjalëve të papërshtatshme dhe lënduese online* ishte forma më e përdorur e ndjekur nga *dërgimi i mesazheve të papërshtatshme dhe lënduese*. Këto sjellje, sipas prindërve, ndodhin më shpesh në telefonat celularë, në 73% të rasteve, dhe kryesisht


në rrjetet sociale në 24% të rasteve. Por sigurisht që edhe në telefonat celularë nxënësit mund të përdorin rrjetet sociale.

Grafiku 54. Bullizmi virtual sipas prindërve



Lidhur me vendin, ku ndodh bullizmi, prindërit pohojnë se fëmijët e tyre kanë qenë më shpesh viktimë në *oborrin e shkollës/ fushën e sportit* në 50% të rasteve, vendi i dytë është në *klasë jo në praninë të mësueses* në 35% të rasteve, dhe në vendin e tretë janë prindërit që pohojnë se fëmija i tyre ka qenë viktimë *gjatë rrugës për në shkollë ose për në shtëpi* në 21% të rasteve.


Grafiku 55. Vendet ku ndodh bullizmi sipas prindërve



Pjesa më e madhe e prindërve, 62%, pohuan se pasi kishin kuptuar se fëmija e tyre ishte viktimë e bullizmit kishin raportuar në shkollë ndërsa 38% pohuan se nuk e kishin bërë një gjë të tillë. Dhe pjesa më e madhe, në 77% të rasteve, kanë raportuar tek mësuesi/ja kujdestare, në 25% të rasteve e kanë raportuar tek drejtori i shkollës, ndërsa me përqindje më të vogël, vetëm 4% e prindërve kanë zgjedhur alternativën tjetër, ku kanë pohuar se ia kanë raportuar psikologut dhe punonjësit social të shkollës.


Grafiku 56. Raportimi i bullizmit nga prindi

A e raportuat bullizmin tek ndonjë person në shkollë?




Grafiku 57: Burimet ku prindi raporton

Kujt ia raportuat bullizmin?



Ndërsa pyetjes se *ku do raportonin nëse fëmija e tyre do të ishte viktimë e bullizmit*, pjesa më e madhe e e prindërve pohuan se do ti tregonin stafit shkollor në 63% të rasteve, 35% do t'i tregonin një pjesëtar të familjes, 23% pohojnë se do t'i tregonin një të rrituri tjetër si psikologut shkollor, punonjësit social, dhe 10 % e tyre do të kërkonin këshilla në internet

Grafiku 58. Burimet ku do të raportojnë në të ardhmen (prindërit në total)



SESSION III: Perceptimi i prindërve për klimën e shkollës dhe besimin e tyre mbi rolin e shkollës për të luftuar bullizmin


Një ndër pyetjet që dëshmon klimën e shkollës ka të bëjë me nivelin e frikës që kanë prindërit se fëmija i tyre mund të bëhet viktimë e bullizmit në të ardhmen. Sikurse e shohim nga grafiku, pjesa më e madhe e prindërve pohojnë se 56% e tyre nuk kanë kurrë frikë, ndërsa 35% kanë frikë ndonjëherë dhe vetëm 9% e prindërve pohojnë se kanë shpesh frikë se mos fëmija e tyre bëhet viktimë e bullizmit.

Grafiku 59. Prindërit të cilët kanë shpesh frikë se fëmija i tij po pëson bullizëm në shkollë



Pyetjes, sa besim kanë prindërit që shkolla e fëmijës së tyre e lufton me sukses bullizmin, pjesa më e madhe, në 90% të rasteve, pohojnë se kanë shumë besim (51%) dhe disi besim (29%), ndërkohë që vetëm 12 % nuk kanë besim se shkolla se do ta luftojë bullizmin dhe 6 % nuk e dinë këtë gjë. Kjo tregon se prindërit besojnë shumë se shkolla e lufton bullizmin. Dhe kur prindërit, që kishin raportuar u pyetën se ‘si e kishite trajtuar rastin shkolla’ gjysma e prindërve, 51%, pohuan se shkolla mori masa dhe bullizmi ndaloi. Ndërsa gjysma tjetër pohuan se shkolla mori masa dhe bullizmi vazhdoi njësoj si më parë (35%), dhe se shkolla nuk mori asnjë masë, 10%.


Grafiku 60. Niveli i besimit të prindit tek shkolla dhe veprimet që shkollat kanë ndërmarrë kur prindërit kanë raportuar



Pyetjes se ‘çfarë sugjerojnë prindërit si mënyra më e mirë për të luftuar fenomenin e bullizmit në shkollë’ pjesa dërrmuese, 47%, pohuan se ishin shumë dakord se një politike kundër bulliste që diskutohet dhe bëhet e njohur për të gjithë stafin, nxënësit dhe prindërit / kujdestarët do të ishte strategjia më efektive e ndjekur me 40% të prindërve që mendojnë se janë efikase edhe bisedat me fëmijët në shkollë përmes orëve të hapura se çfarë është

bullizmi dhe si ta ndalojmë atë. Ndërsa 38 % e prindërve pohojnë se do të ishte shumë efektive, që fëmijët të dinë si të raportojnë një ngjarje bulliste dhe 35% e tyre pranojnë se është e rëndësishme edhe kur fëmijët e tyre formojnë një konceptim të qartë se çfarë është bullizmi dhe se ai është i papranueshëm.

Grafiku 61. Strategjitë e parandalimit të bullizmit sipas perspektivës së prindërve



4. DISKUTIME MBI GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT

Në vijim të paraqitjes dhe të analizës së të dhënave të mbledhura nga grupet e targetura, ky kapitull na ofron edhe një përmbledhje, si dhe një diskutim sipas strukturës konceptore të studimit. Pjesa e parë është një diskutim i rezultateve të studimit, por i ndërthurur me analizën sistematike të literaturës.

Ky studim analizon problemin e dukurisë së bullizmit në sistemin arsimor shqiptar e parë përmes këndvështrimit të tre aktorëve kryesor të shkollës: nxënësve, mësuesve dhe prindërve, si dhe perceptimin dhe besimin e mësuesve ndaj një dukurie që po bëhet gjithmonë e më shqetësuese në gjithë botën, ekstremizmin e dhunshëm.

Sjelljet agresive të fëmijëve në shkollë kanë qenë në qendër të vëmendjes së studimeve empirike në dhjetëvjeçarët e fundit. Si rrjedhojë, bullizmi, si një nënloj i agresivitetit, është identifikuar si një problem madhor që ndikon në shëndetin fizik dhe mendor të atyre fëmijëve që janë viktimë të vazhdueshme të bullizmit, si dhe të atyre nxënësve që janë agresorë që në moshë të hershme (Arseneault, 2010). Bullizmi mund të ketë disa forma, si fizike, verbale dhe psikologjike (Olweus, 2012). Megjithatë nuk ka një përkufizim të saktë të kësaj dukurie, shumë studiues kanë rënë dakord që bullizmi përfshin një fëmijë që keqtrajtohet *vazhdimisht*, që ky lloj keqtrajtimi *nuk është i provokuar*, dhe që ka një *pabarazi pushteti* midis agresorit dhe viktimës (Olweus, 2000).

Nevoja për studimin e këtij problemi erdhi nga fakti se, *së pari*, bullizmi është një dukuri shoqërore mjaft shqetësuese. Në vitet e fundit ka një perceptim të përgjithshëm se dhuna është bërë më e përhapur në shoqëri, duke përfshirë edhe sistemin e arsimit. Por në Shqipëri mungonin studime kombëtare në këtë fushë, pavarësisht se numri i ngjarjeve të tilla është në rritje dhe ka çuar edhe në plagosje dhe vrasje midis nxënësve. Ndaj rezultatet e këtij studimi japin një pasqyrë të situatës së tanishme dhe krijojnë një profil të bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në sistemin arsimor shqiptar dhe kanë për qëllim që të përgjithësojnë të dhënat dhe përfundimet e nxjerra nga 144 shkollat e 12 qarqeve të Shqipërisë. *Së dyti*, është e nevojshme që të kemi një pamje reale të situatës se si e perceptojnë dhe çfarë qëndrimesh kanë mësuesit mbi ekstremizmin e dhunshëm/ dhe; *së treti* është shumë e nevojshme që ne të bëjmë një analizë se si i trajtojnë shkollat këto sjellje problematike dhe çfarë politikash apo rregulloresh kanë ato në zgjidhjen e problemeve të tilla.

Si përfundim, mund të themi se rezultatet e këtij studimi kanë për qëllim që të rrisin vetëdijen e strukturave shtetërore për çështjen e sigurisë në shkolla, që ky fenomen është i pranishëm dhe në një shkallë të lartë përhapjeje ndaj duhen marrë masa për ta parandaluar dhe trajtuar atë.

4.1 Prevalenca dhe karakteristikat e dukurisë së bullizmit: (shpeshtësia, format, motivet , vendndodhja, dhe raportimi)

Shpeshtësia e përhapjes së dukurisë

Dhuna dhe bullizmi në shkollë shfaqen në të gjithë botën dhe ndikon një numër të konsiderueshëm fëmijësh dhe adoleshentësh. Është vlerësuar se 246 milion fëmijë dhe

adoleshentë përjetojnë dhunë dhe bullizëm në shkollë në një lloj forme çdo vit. Vlerësimet mbi raportin e fëmijëve dhe të rinjve që preken nga bullizmi në shkollë variojnë shumë midis vendeve, duke nisur nga shkalla më e ulët me më pak se 10% deri në mbi 65 %. Në një raport të fundit nga UNICEF⁴⁷, u zbulua se nga 100,000 të rinj të marrë në studim nga 18 vende të ndryshme të botës, 2/3 e tyre pohuan se ishin viktimë të bullizmit. (UNESCO, 2017)⁴⁸

Shkalla e bullizmit ndryshon përgjatë studimeve të ndryshme (nga 9% në 98%). Një meta-analizë e 80 studimeve që analizon nivelet e përfshirjes në bullizëm tek nxënësit e moshë 12-18 vjeç, tregoi se rreth 35% e tyre ishin të përfshirë në bullizmin tradicionale dhe 15% në atë virtual (Modecki, Minchin, Harbaugh, Guerra, & Runions, 2014).

Gjithsesi, ekziston shumë pak konsensus ndërkombëtar për shkallën e shpeshtësisë së bullizmit, për shkak të vështirësisë së përcaktimit të termit *bullizëm* në kultura të ndryshme. Kështu, të dhënat statistikore për shumë vende që e studiojnë këtë dukuri janë të ndryshme, duke krijuar një boshllëk të madh në krahasimin e rezultateve, sepse ato përdorin një larushi metodash për matjen e shpeshtësisë së përhapjes së bullizmit.

Megjithatë, ka pasur përpjekje për të kryer studime krahasuese rreth këtij problemi. Një i tillë është studimi i quajtur "*Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijët në Moshë Shkollore (11 vjeç-15 vjeç), 2009-2010*", i cili ofroi një mundësi për ta studiuar bullizmin në një kampion të madh ndërkombëtar, ku u përfshinë 202 056 nxënës nga 40 vende të ndryshme të Evropës, të Amerikës së Veriut dhe të Izraelit, që kishin përdorur pyetësoin e standardizuar të Oleusit (Olweus). Në këto 40 vende doli se 26.4 % e pjesëmarrësve (n=53 249) raportuan përfshirjen në bullizëm. Nga kjo shifër doli se 10.4% (n=21 192) e 202 056 nxënësve raportuan se kishin shkaktuar bullizëm tek të tjerët, 12.3% (n = 24 919) raportuan se kishin qenë viktimë dhe 3.5% (n = 7138) raportuan se kishin qenë edhe viktimë, edhe agresorë.

Në këtë studim del se 10 vendet e para për nivelin më lartë të nxënësve të përfshirë në bullizëm i mbanin vende të tilla, si : Lituania (45.2 %), Letonia (43.5%), Estonia (41.3%), Greqia (41.3%), Groenlanda (38.2%), Rumania (38.0%), Turqia (36.4%) dhe Ukraina (34.4%). Ndërsa vendet që kishin nivelet më të ulëta ishin: Hungaria (12.0%), Norvegjia (15.3%), Irlanda (14.8%), Finlanda (13.3%), Suedia (8.6%), Islanda (14.8%), Çekia (9.7%) dhe Italia (më pak se 5%).

Sipas studimeve del se këto përqindje ndryshojnë për dy arsye kryesore: së *pari*, për shkak të ndryshimeve në përcaktimin e termit bullizëm nga një vend në tjetrin. Kjo është edhe arsyeja që interpretimi i gjetjeve mbi dallimet ndërkombëtare duhet të interpretohet me kujdes, sepse diferencat e vërejtura në shpeshtësinë e përhapjes së bullizmit mund të jenë për shkak të dallimeve ndërkulturore në të kuptuarit e termit në fjalë.

Së *dyti*, në pjesën më të madhe të vendeve me shpeshtësi të ulët të dukurisë së bullizmit janë në zbatim politika dhe programe kombëtare kundërbulliste. Për shembull, në shtetet skandinave ka programe kombëtare që adresojnë bullizmin, ndërsa në vendet e Evropës Lindore nuk ka fushata kombëtare për të luftuar bullizmin. Ndryshimet në përhapjen e kësaj

⁴⁷ Prezantim special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën kundrejt Fëmijëve

⁴⁸ UNESCO (2017). "School violence and bullying" Published by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. ISBN 978-92-3-100197-0. Online: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002469/246970e.pdf>

dukurie në të vërtetë mund të pasqyrojnë suksesin e këtyre nismave kombëtare, të cilat kanë qenë të vazhdueshme për shumë vite (Olweus, 1993).⁴⁹

Rezultatet e studimit tregojnë se dukuria e bullizmit është shumë e pranishme dhe pjesë përbërëse e sistemit arsimor shqiptar. Duke u bazuar në përkufizimin e bullizmit sipas Oleusit, në këtë studim del se 19.4% e nxënësve nga klasa e IV deri në të XII janë përfshirë në dukurinë e bullizmit 2 -3 ose më shumë herë në muajt e fundit, nga ku: 9.7 % e tyre janë viktimë, 5.2% janë agresorë dhe 4.3% i përkasin edhe kategorisë më vulnerabël të atyre që janë në të njëjtën kohë edhe agresorë, edhe viktimë. Rezultatet tregojnë se shkalla e përfshirjes në sjelljet bulliste në mesin e fëmijëve të shkollave shqiptare është më e lartë se norma mesatare e përfshirjes në disa vende të Evropë sipas anketës së HBSC 2010⁵⁰.

Ndërsa nga pyetëtori i mësuesve doli se rreth 60 % e mësuesve pohonin se në shkollën e tyre ekzistonte dukuria e bullizmit dhe nga pyetëtori me prindërit doli se rreth 23% e prindërve pohuan se fëmija e tyre kishte qenë viktimë e bullizmit në muajt e fundit.

Gjithashtu është e rëndësishme të vëmë re se nxënësit që janë shprehur se kanë pësuar bullizëm “një ose dy herë”, përbëjnë një numër të konsiderueshëm prej 36%. Në shumë vende ata futen në kategorinë e nxënësve të përfshirë në bullizëm sepse së *pari* fakti, që kanë qenë një ose dy herë nuk do të thotë që fenomeni të mos rishfaqet. Ndaj për këtë gjë ata kërkojnë mbrojtje, në mënyrë që të mos bëhen subjekte të sulmeve më të ashpra. Së *dyti*, mund të ndodhë, që në momentin e plotësimit të pyetësorit, nxënësit që kanë pohuar se kjo i ka ndodhur një ose dy herë mund të jenë në fillimet e përfshirjes si viktimë apo agresorë të këtij fenomeni.

Sikurse e përmendëm më lart, nga studimi doli se 4.3% e nxënësve janë edhe agresorë, edhe viktimë, nga ku djemtë janë dy herë më të prirë të futen në kategorinë agresorë-viktimë sesa vajzat. Pavarësisht numrit të vogël të kësaj kategorie, kjo kategori nxënësish kërkon një vëmendje të veçantë, duke parë problematikat dhe sfidat me të cilat këta fëmijë përballen, pasi përjeton si problemet socio-emocionale të viktimës, ashtu dhe problemet e sjelljes të agresorit (Nansel et al., 2001; Renda, Vassallo, & Edwards, 2011). Në mënyrë të vazhdueshme studiuesit kanë zbuluar se agresorët-viktimë, veçanërisht djemtë e kësaj kategorie, mund të përjetojnë mungesë shoqërie në klasë, vetmi, arritje të dobëta akademike në rezultatet shkollore, përdorim më të madh të alkoolit dhe të duhanpirjes, vuajnë më shumë nga problemet e shëndetit mendor dhe përfshihen më shumë në konflikte sesa nxënësit e tjerë (Stein, Dukes, & Earren, 2007).

Nga studimi doli se klasat më të përfshirë në dukurinë e bullizmit ishin klasa e XI-të e ndjekur nga klasa e V-të. Kjo sepse klasa e V-të është edhe klasa që dëshiron të shkëputet nga klasat e ulta dhe ka tendencë të identifikohet me klasat më të mëdha. Por kjo i bën më të ekspozuar ndaj dukurisë së bullizmit duke u bërë viktimë të kësaj dukurie, më shumë se agresorë.

Ndërsa klasa e XI-të është dhe viti i dytë i shkollës së mesme që i takon moshës 16-17 vjeç, e cila përkon me kulmin e adoleshencës dhe shpërthimeve hormonale dhe moshë ku të rinjtë fillojnë të krijojnë identitetin e tyre dhe statusin social. Dhe këtë identitet duan ta krijojnë në raport me moshatarët, duke u përpjekur ta ulin sa më shumë statusin e

⁴⁹ Olweus D. (1993). “Bullying at School: what we know and what we can do”. Cambridge, MA: Blackwell Publishers.

⁵⁰ Health behavior in School Age children (HBSC) study (2009-2010)

bashkëmoshatarëve duke i bulluar dhe diskriminuar ata. Është mesi dhe kulmi i shkollës së mesme, që vjen pas klasës së X-të, që është viti i parë i përshtatjes me normat dhe modelin e ri të sjelljes në shkollë të mesme. Dhe pasohet nga klasa e XII-të, e fundit e shkollës së mesme, ku, statusi social është më pak i rëndësishëm se qëllimet dhe interesat për punën apo shkollën e lartë, që duhen formuar tashmë.

Nga pikëpamja gjinore del se vajzat bien më shumë viktime të bullizmit sesa djemtë, ndërsa djemtë janë më shumë agresorë sesa vajzat, dhe kjo konfirmohet edhe në studimet të tjera ndërkombëtare. Aty ku dhuna duket sikur është e lidhur me mashkulloriteti, aty edhe agresiviteti ndërmjet djemve është më i idealizuar, gjë që është një mënyrë e krijimit të një rendi social, prandaj edhe pranimi i tyre në grupin bashkëmoshatar shpesh kërkon përfshirjen në sjellje agresive. (Salmivalli, 1996)

Nga studimet del se ky mbizotërim më i madh i bullizmit tek djemtë, mund të shfaqet sepse ata kanë nevojë të ndërtojnë dominancën e tyre brenda grupit bashkëmoshatar. Mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është duke treguar fuqinë, pushtetin (Baldry & Farrington, 2000). Duke qenë se djemtë shkaktojnë bullizëm më shumë sesa vajzat, tek ata, trysnia për t'u konformuar brenda grupit bashkëmoshatar duhet të jetë shumë më e madhe. Gjatë adoleshencës sjelljet agresive mund të shihen si të fuqishme dhe joshëse dhe si një mënyrë efektive dhe e pranueshme për të arritur qëllimet. Grupet e fëmijëve formojnë aleanca pjesërisht të bazuara në sjelljet e tyre agresive (Eagle & Steffen, 2010).

Por ka edhe shumë studiues që mendojnë se djemtë dhe vajzat përfshihen njëllor në bullizëm. Vetëm se tek vajzat ai është shumë më i vështirë të identifikohet nga mësuesit, sepse vajzat pësojnë bullizëm në vende brenda shkollës që janë më të fshehura dhe të padukshme nga syri i të rriturve dhe forma bullizmi më të vështira për tu identifikuar. Po ashtu është vënë re se studimi i sjelljeve agresive të vajzat është më i vogël, sepse shoqërisë i mungojnë mjetet e duhura për të kuptuar dhe për të vëzhguar agresivitetin e tyre (Ahmad dhe Smith, 2004).

Format e bullizmit sipas gjinisë dhe klasës

Në studimin tonë, nga pikëpamja e raportimit të nxënësve viktime, dolën këto forma më të përhapura të kësaj dukurie: **bullizmi psikologjik**: *"Nxënësit e tjerë më kanë përgojuar ose kanë përhapur thashetheme të rreme rreth meje dhe janë përpjekur që të tjerët të më marrin inat ose jam kërcënuar të bëjë gjëra kundër dëshirës sime"* e cila ka ndodhur njëllor si për djemtë ashtu edhe për vajzat me 45% të rasteve e ndjekur nga **bullizmi verbal**: *"Unë jam përqeshur, më janë thënë gjëra fyese, ose jam vënë në lojë nga një ose disa nxënës?"* në 37% të rasteve e cila i ka ndodhur më shumë djemve dhe në vendin e tretë është **bullizmi fizik** *"Unë jam goditur, shkelmuar, shtyrë ose mbyllur brenda dhe më kanë marrë para ose më kanë dëmtuar sendet personale"* në 33 % të rasteve ku djemtë janë ndjeshëm më të përfshirë në këtë lloj bullizmi sesa vajzat. Ndërsa, forma më pak e përhapur e bullizmit midis nxënësve është bullizmi virtual/ kiberentik.

Nga rezultate e përfituara nga pyetësori i mësuesve doli se 78% e mësuesve pohuan se janë "dakord" dhe "shumë dakord" që bullizmi verbal është forma më e përhapur e bullizmit në shkollën e tyre, e ndjekur nga bullizmi psikologjik në 61 % të rasteve dhe pothuajse gjysma e mësuesve (51%) pohojnë se bullizmi virtual është bullizmi më i përhapur. Ndërsa format e bullizmit racor dhe seksual janë më pak të përhapurit.

Gjithashtu nga pyetësi me prindërit viktimë e bullizmit verbal me 44 % të rasteve e ndjekur nga bullizmi social dhe i treti është bullizmi fizik. Ndërkohë 23 % pohojnë se fëmija e tyre ka qenë pre e bullizmit virtual.

Nga studimi doli gjithashtu se bullizmi fizik është shumë më i pranishëm në shkollat profesionale (ku popullata e djemve është shumë herë më e madhe se ajo e vajzave) me rreth 61% të rasteve krahasuar me 41 % të shkollave të mesme dhe 48% të shkollave 9-vjeçare. Gjithashtu me një diferencë domethënëse bullizmi virtual është më i pranishëm në shkollë të mesme në 60% të rasteve krahasuar me 48% të shkollat 9-vjeçare dhe 44% profesionale. Gjithashtu edhe bullizmi racor është më i përhapur në shkollat profesionale me 39% , e ndjekur nga ato 9-vjeçare dhe më pak në shkollat e mesme me 22 % të rasteve. Sipas studimeve, bullizmi fizik ulet me rritjen e moshës, ndërsa ai verbal, social dhe virtual pësojnë një rritje midis moshës 11-15 vjeç (Archer & Cote, 2005; Espelage, 2003; & Sëearer, 2008).

Gjithashtu, bullizmi fizik është më i pranishëm në shkollat publike sesa në shkollat private me një diferencë të ndjeshme në 7 % të rasteve në shkollat private ku është edhe forma e bullizmit më pak i pranishëm kundrejt 23 % të shkollave publike ku ai përben formën e tretë më të përhapur tek këto shkolla.

Duke iu referuar edhe studimeve të ngjashme në vende të tjera, gjetjet e këtij studimi konfirmojnë se për të dyja gjinitë, nxënësit janë më shumë pre e bullizmit emocional, ku përfshihet përhapja e thashethemeve dhe kërcënimet, duke u ndjekur nga bullizmi verbal, ku ata janë ofenduar, apo u janë vënë nofkat fyese e lënduese. Ky mbizotërim i talljeve, i ofendimeve apo i vendosjes së nofkave fyese, mund të sjellë ose të përforcojë modelet e përjashtimit social, të cilat çojnë më pas në vetmi, në vetëvlerësim të ulët dhe në probleme me shëndetin.

Po ashtu, nëse bullizmi psikologjik dhe verbal është forma më e zakonshme e bullizmit si për vajzat, edhe për djemtë, Oleusi (Olweus, 2010) vëzhgoi se djemtë përgjithësisht janë viktimat të sjelljeve bulliste më të dhunshme dhe më destruktive sesa vajzat. Kështu, ata e përjetonin më shumë bullizmin fizik, ku përfshihen veprime që shkaktojnë dëmtime fizike, si shkelmimi, goditjet me grusht dhe shuplakat; marrja e parave, e drekës apo e detyrave të shtëpisë, dëmtimi i sendeve të tjerëve (Selekman & Vessey, 2004). Ndërkohë vajzat përpiqen dhe provojnë që të jenë viktimat të fshehura të bullizmit, ku futen përhapja e thashethemeve dashakeqe, manipulimi i marrëdhënieve dhe përjashtimi social (Selekman & Vessey, 2004). Ky lloj bullizmi quhet *bullizëm instrumental* dhe karakterizohet nga sjellje që orvaten të dëmtojnë miqësinë e një fëmije ose ndjenjat e tij apo të saj, duke e përjashtuar nga grupi bashkëmohatar (Crick & Grotpeter, 1995).

Gjithashtu, nga studimi doli se djemtë priren më shumë të marrin komente apo gjeste me ngjyrim seksual dhe ta shkaktojnë këtë lloj bullizmi tek të tjerët, gjë që bien disi ndesh me të dhënat që vijnë nga rishikimi i literaturës. Pyetja e instrumentit tonë nuk kishte si qëllim të maste homofobinë, por mund të ndodhë që komente të natyrës seksuale, në disa raste mund të kenë qenë me qëllime homofobike, prandaj kjo mund të shpjegojë arsyen pse djemtë kanë përqindje më të lartë për këtë lloj bullizmi. Këto gjetje mbështeten edhe nga studiues si Henkini (Henkin, 2005) dhe nga Faji (Phye, 2004), të cilët pohojnë se çdo djalë që ka disa karakteristika që janë të ndryshme nga pjesa tjetër e grupit bashkëmohatar të meshkujve në shkollë, është burim bullizmi. Djemtë që rrinë më shumë me vajza, që

pëlqejnë të ndjekin modën në veshje, që nuk reagojnë me agresivitet, kur të tjerët i ngacmojnë, që nuk dinë të luajnë futboll apo nuk marrin pjesë në veprimtaritë e djemve brenda shkollës, kanë më shumë probabilitet që të jenë pre e kësaj forme bullizmi.

Bullizmi kibernetik

Bullizmi virtual/ kibernetik, pavarësisht vëmendjes së madhe që i kushton media dhe shqetësimit të madh që ka komuniteti, nuk është aq i zakonshëm sa format e tjera të bullizmit. Studimet, kryesisht të viteve të fundit, na japin të dhëna të ndryshme për numrin e nxënësve që përjetojnë bullizmin virtual, ndryshime që vijnë nga diferencat në kampionim/në zgjedhjen e kampionit të marrë në studim dhe në teknikat metodologjike. Megjithatë ka një mendim të përbashkët të shumicës së studiuesve, që shprehen se numri i nxënësve në botë që raportojnë se kanë përjetuar bullizmin virtual është sa një e treta e atyre që përjetojnë bullizmin tradicional.

Ndaj, megjithëse bullizmi virtual mund të jetë shumë shkatërrues për ata që e përjetojnë, prapë ka një numër të vogël fëmijësh që preken prej tij, nëse e krahasojmë me format e tjera të bullizmit..

Në studimin tonë nxënësit viktimë pohojnë se 17% e tyre janë pre e bullizmit virtual. Nga mësuesit dhe prindërit marrim rezultate të ndryshme. Ata mendonin se ky lloj bullizmi ishte shumë më i përhapur sesa pohojnë vetë nxënësit. Kjo mund të ketë disa shpjegime, se *pari* nxënësit nuk arrijnë ta kuptojnë se çfarë nënkupton realisht bullizmi virtual dhe shumë sjellje agresive që bëjnë në celularë apo rrjete sociale nuk i quajnë bullizëm dhe së *dyti*, perceptimi i të rriturve mund të jetë i gabuar, pasi edhe nga të dhënat e marra nga studimet ndërkombëtare del se pak fëmijë janë përfshirë vetëm në bullizmin virtual. Nga pyetësi i mësuesve dhe prindërve doli se ata perceptonin se bullizmi virtual manifestohet përmes sjelljeve të tilla: kur nxënësit shkruajnë fjalë të papërshtatshme dhe lënduese online, e ndjekur më sjellje kur nxënësit dërgojnë mesazhe të papërshtatshme dhe lënduese dhe së treti mendojnë se nxënësit shkarkojnë/ shpërndajnë imazhe të papërshtatshme online. Të gjitha këto sjellje mësuesit dhe prindërit mendonin se ndodhin përmes telefonave celularë dhe rrjeteve sociale.

Por, gjithsesi, nuk mund të rrimë pa përmendur faktin se bullizmi virtual po rritet me shpejtësi marramendëse dhe forma më e përhapur e tij është përmes rrjeteve sociale, si fejsbuku (facebook) apo instagram etj. (Hinduja and Patchin, 2010).

Politikat shkollore duhet ta kenë në vëmendje qendrore bullizmin virtual, prindërit dhe personeli i shkollës mund të mos jenë të ndërgjegjshëm për gamën e gjerë të teknologjive të përdorura nga fëmijët e tyre. Prandaj janë të nevojshme kryerja e trajnimeve për të rritur njohuritë e tyre, për rreziqet që lidhen me teknologji të tilla.

Cilat janë “zonat e nxehta” të bullizmit?

Studiuesit e vënë shumë theksin për të ditur se kush janë “zonat e nxehta” në një shkollë, sepse shkolla mund të bëjë shumë për ta zvogëluar bullizmin, nëse ata identifikojnë ku ndodh ai më së shpeshti, që pastaj të ndërmarrin hapa për ta ndryshuar klimën në këto zona.

Nga studimet e ndryshme ka dalë se shumica e veprimtarive bulliste ndodhin jashtë syrit të të rriturve në vende të tilla, si: qoshja e klasës, një korridor i shkretuar përgjatë shkallëve, në tualete, në dhomat e zhveshjes, në oborrin e shkollës, në fushat sportive etj. Këto janë të gjitha vendet në të cilat bullizmi ndodh sepse mbikëqyrja ose mungon, ose është e pamjaftueshme. Pjesa më e madhe e nxënësve pohojnë se kanë qenë viktimat të bullizmit në klasë, kur mësuesi/mësuesja nuk ka qenë i pranishëm/e pranishme. Kjo do të thotë se këto sjellje ndodhin nën hundën e të rriturve, por personeli i shkollës e ka të pamundur t'i vëzhgojë të gjithë nxënësit në të njëjtën kohë.

Gjetjet kanë treguar se bullizmi zakonisht shfaqet në klasë, ndjekur nga oborri i shkollës, shkallët dhe tualetet (Seals & Young, 2003; Smith & Shu, 2000; Eolke et al., 2001). Statistikat e fundit gjithashtu kanë treguar se rreth 47.2% e bullizmit ndodh në oborrin e shkollës dhe 33.6% në klasë, kur mësuesi/ja nuk është i/e pranishme (Mahoney, 2012), ndërsa rreth 20% e veprimtarive bulliste ndodhin në korridoret e shkollës (Garbarino & deLara, 2002).

Gjetjet e këtij studimi përputhen në shumë drejtime me të dhënat e studimeve në vende të tjera, si psh, agresorët përpiqen t'i sulmojnë viktimat e tyre në 40% të rasteve "*në klasë, kur mësuesja nuk ishte e pranishme*", duke u ndjekur nga sulmet në "*në oborr/ fushën e sportit*" me një shifër prej 39%. Gjithashtu në 19% të rasteve nxënësit pohojnë se sjellje të tilla ndodhin "*në klasë në prani të mësueses*". Vajzat kanë një prirje më të madhe të pohojnë se ato kanë qenë viktimat të bullizmit më shumë në klasë, kur mësuesi/mësuesja nuk ishte i pranishëm/e pranishme ose kur ishte e pranishme, ndërsa djemtë pohojnë se ata kanë qenë viktimat të bullizmit më shumë në tualete dhe në oborrin e shkollës/ fushën e sportit.

Gjithashtu, rezultatet nga pyetësi me mësuesit konfirmojnë se ata pohojnë në 72% të rasteve që këto sjellje ndodhin në *oborrin e shkollës/ fushën e sportit*, e ndjekur me 57% në rastet kur nxënësit ndodhen brenda në klasë, jo në prani të mësueses, dhe në 46% të rasteve pohojnë se këto sjellje ndodhin jashtë ambientit të shkollës kur nxënësi është *rrugës për ose nga shkolla*. Ndërsa 14% e mësuesve pohojnë se këto sjellje ndodhin *në klasë në prani të mësuesit/es*.

Prindërit pohojnë se fëmijët e tyre kanë qenë më shpesh viktimat në *oborrin e shkollës/ fushën e sportit* në 50% të rasteve, vendi i dytë ku ndeshet më shpesh bullizmi është *në klasë jo në prani të mësueses* në 35% të rasteve dhe në vendin e tretë janë prindërit që pohojnë se fëmija i tyre ka qenë viktimë *gjatë rrugës për në shkollë ose për në shtëpi* në 21% të rasteve.

Vihet re se një përqindje jo e vogël e nxënësve dhe mësuesve pohojnë se kjo sjellje ndodh në prani të mësuesve, të cilët *së pari*, mund të mos e shohin këtë sjellje si një problem me pasoja në jetën e nxënësve por e shohin si një proces normal të rritjes së fëmijëve dhe së dyti, sepse ndoshta nuk kanë aftësitë e duhura për të ndërhyrë efektivisht dhe duke i bërë ata target potencial i viktimizimit.

Në të vërtetë, hulumtimet kanë treguar se kur të rriturit mbikëqyrin një zonë të caktuar dhe ndërhyjnë menjëherë, shkalla e bullizmit në ato zonat bie ndjeshëm. Gjetjet tregojnë se bullizmi ndodh në zona që janë lehtësisht të aksesueshme dhe të monitorueshme, kështu që, nëse mësuesit trajnohen si agjentë aktivë në njohjen, në reagimin dhe në parandalimin e sjelljeve bulliste, kjo dukuri do të do të ulet ndjeshëm.

Arsyet e viktimizimit/rënies viktimë

Një nga elementet e rëndësishme për të parandaluar bullizmin, është të kuptojmë pse agresorët sulmojnë dhe si i zgjedhin viktimat. Sipas studimeve ndërkombëtare, kur nxënësit pyeten pse kanë rënë pre e bullizmit, pjesa më e madhe janë përgjigjur sipas kategorive të mëposhtme:

- Paraqitja e viktimës: e dobët, e shëndoshë, e shëmtuar.
- Sjellja e viktimës: e çuditshme, flet në mënyrë të ndryshme nga të tjerët, i turpshëm/e turpshme, i/e pasigurt.
- Prejardhja sociale: kulturë të ndryshme, situata ekonomike, raca. (Frissen, 2007).

Edhe nga ky studim doli se nga këndvështrimi i mësuesve ka shumë të ngjarë dhe ndonjëherë të ngjarë, që nxënësit të bëhen viktimat për shkak të pamjes së jashtme në 73% të rasteve. Motivi i dytë më i përhapur sipas mësuesve janë nxënësit që kanë vështirësi në të folur në 68% të rasteve. Ndërsa motivi i tretë më e përhapur është për shkak të pabarazisë së nxënësve në fuqinë fizike. Në rastet më pak të përhapura që nxënësit të bëhen viktimat përfshihen nxënësit që janë të shkëlqyer në sporte dhe nxënësit e pakicave kombëtare.

Pra, në pjesën më të madhe viktimat janë nxënës që “janë të ndryshëm” nga të tjerët. Ata kanë tipare fizike pak më të mëdha se normalja, si veshë të mëdhenj, mbajnë syze, mbajnë aparat dhëmbësh, vishen jashtë mode ose çuditshëm, mendohen nga shumica si jo të paraqitshëm/paraqitshme, janë ose shumë të shëndoshë ose shumë të dobët. (Olweus, 2010).

Natyrshëm lind pyetja: *Po nxënësit që i kanë këto cilësi dhe nuk janë potencial i sjelljeve bulliste?* Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur shumë studiues, të cilët pohojnë se tipari që agresorët kërkojnë te viktimat nuk është se janë të ndryshëm, por janë më vulnerabël. Ky vulnerabilitet e lejon agresorin të abuzojë me fëmijën, por pa pasur një arsye të veçantë. Një fëmijë që përdor veshje jo shumë në modë, por që ka aftësi të mira sociale, nuk është shënjestër e sjelljeve abuzive. Në të kundërt, një nxënës që ka veshje jo shumë të modës por që është i izoluar dhe i tërhequr, është një shënjestër e shkëlqyer e kësaj sjelljeje abuzive (Sheras, 2002). Po e njëjta gjë e ngjashme ndodh me një vajzë që nuk është tërheqëse, e cila, nëse ka një imazh pozitiv dhe të shëndetshëm për veten, si dhe aftësi të mira sociale, mund ta shmangë të qenët viktimë e bullizmit. Studimet kanë treguar se karakteristikat e mëposhtme, të cilat janë tregues i vulnerabilitetit dhe e bëjnë një nxënës më vulnerabël ndaj viktimizimit janë: pafuqia fizike; të qenët i turpshëm; vetëvlerësimi dhe vetëbesimi i ulët; aftësi të dobëta sociale.

Studiuesit mendojnë se viktimat kanë prirje të kenë aftësi të dobëta ndërpersonale, nuk janë shumë në gjendje të përdorin mekanizma të përshtatshëm përballues dhe janë më të prirë që të përjetojnë nga brenda probleme psikologjike, si ankthi dhe depresioni (Bond, 2001). Por është shumë e vështirë të përcaktohet nëse këto karakteristika veprojnë si një shkak për agresorët apo ato vijnë si rrjedhim a pasojë e të qenit viktimat.

Gjithashtu, shumë studime kanë dokumentuar faktin se agresorët i sulmojnë të tjerët si një mundësi për të fshehur problemet ose ata imitojnë atë që shohin në familje. Ata janë fëmijë që në të shumtën e rasteve kanë pësuar dhunë në familje. Kur vijnë në shkollë, ata e çlirojnë frustacionin e tyre duke sulmuar nxënësit më të dobët të klasës. Gjithsesi është e nevojshme

që të studiohet më tej se si karakteristikat e familjes ndikojnë në përfshirjen e nxënësve në bullizëm.

Profesionistët sugjerojnë se çdo shkollë duhet të ketë projekte të planifikuara këshillimi për nxënësit që vijnë nga familje problematike, në mënyrë që t'i ndihmojnë ata në zhvillimin e tyre psikologjik, dhe sidomos kur nuk kanë prindër që t'ia sigurojnë këtë gjë në këtë moshë delikate. Ndërsa për viktimat duhet të ofrohen trajnime, në mënyrë që të mësojnë aftësi sociale, si dhe të punohet me ta për t'u rritur vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e tyre.

Raportimi i bullizmit

Është e rëndësishme që fëmijët të informojnë të rriturit, në mënyrë që të luftohet bullizmi në shkollë. Sistemi i raportimit është shumë i rëndësishëm, sepse në këtë mënyrë nxënësit duhet të dinë se ku të shkojnë dhe me kë të flasin, nëse ata duan mbështetje emocionale dhe psikologjike.

Në shumë studime ndërkombëtare del se shumica e nxënësve nuk e raportojnë bullizmin tek të rriturit. Studimet e kryera në shumë vende konfirmojnë se shumë viktimat dhe dëshmitarë nuk arrijnë t'ua tregojnë mësuesve apo edhe prindërve. Një gjë e tillë sjell si pasojë që mësuesit mund ta nënvlerësojnë shkallën e përhapjes së bullizmit në shkollën e tyre dhe mund të jenë në gjendje të identifikojnë vetëm një pjesëz të vogël të tij (Banks, Kaplan & Groves, 2001).

Kjo mungesë raportimi mund të ketë disa arsye. Studiues të tillë, si Mekartni (McCartney, 2005), Limberi (Limber, 2002) dhe Olweusi (Olweus, 1999) kanë zbuluar se viktimat nuk raportojnë sepse historikisht reagimi i të rriturve ka qenë shumë zhgënjyes për ta. Si pasojë ata nuk besojnë se mësuesit do t'i ndihmonin, nuk duan që nxënësit e tjerë të marrin vesh që ata kanë probleme, kanë frikë se mos bëhen objekt talljesh ose nuk do të besohen, kanë frikë se kjo do ta përkeqësonte situatën dhe nuk duan që të rriturit t'i thonë "injoroje atë/shpërfille ose mos ia var fare atij".

Nga studimi del se shumica e nxënësve viktimat parapëlqejnë që ta raportojnë bullizmin, kur ai ndodh. Pjesa më e madhe e nxënësve (73%) pohojnë se i kanë treguar dikujt, kundrejt 27% që nuk kanë parapëlqyer t'i tregojnë dikujt. Nga pikëpamja gjinore del se vajzat janë më të prira sesa djemtë t'i tregojnë dikujt që kanë qenë viktimat të bullizmit. Studimet ndërkombëtare argumentojnë se kultura e djemve e pranon më shumë bullizmin dhe tregon se ndjeshmëria e normave të grupit tek djemtë, të cilët kanë kulturën e heshtjes, është më e madhe sesa te e vajzave. Ndërsa nënkultura në të cilën jetojnë vajzat, e krahasuar me atë të djemve, karakterizohet nga grupe të vogla dhe intime, si dhe nga një afërsi më e madhe dhe një lidhje më e fortë me të rriturit, kështu që ato socializohen që në fëmijëri që të ankohen dhe të kërkojnë ndihmë më shumë tek të rriturit.

Ndërsa për sa i përket faktit se ku kanë raportuar viktimat e bullizmit, pjesa më e madhe e tyre pohojnë se kanë raportuar tek prindërit/kujdestarët, e ndjekur në përqindje të barabartë me shokët/ shoqet dhe mësuesin kujdestar. Ndërsa tek alternativa tjetër që zë edhe përqindjen më të vogël nxënësit cituan punonjës social dhe psikologun shkollor si mundësi referimi.

Nxënësit që raportojnë më shumë janë në klasën e VIII-të (16%), në klasën e VI-të (15%) dhe klasën e IX –të (13.4%). Ndërsa nxënësit që raportojnë më pak janë në klasën e XII-të

(15.3%). Tërheq vëmendjen klasa e V-të, ku nxënësit, megjithëse janë më të përfshirë në dukurinë e bullizmit, nuk e raportojnë në krahasim me klasat e tjera.

Gjithashtu edhe pjesa më e madhe e prindërve, 62%, pohuan se pasi ishin informuar se fëmija e tyre ishte viktimë e bullizmit kishin raportuar në shkollë, ndërsa 38% e tyre pohuan se nuk e kishin bërë një gjë të tillë. Pjesa më e madhe në 77% të rasteve kanë raportuar tek mësuesi/ja kujdestare, në 25% të rasteve e kanë raportuar tek drejtori i shkollës. Ndërkohë që vetëm 4% e prindërve kanë zgjedhur alternativën tjetër ku kanë pohuar se ia kanë raportuar psikologut dhe punonjësit social të shkollës.

Gjithashtu nga pyetësi me mësuesit doli se pjesa më e madhe e mësuesve pohojnë se kanë pasur më pak se dhjetë raste bullizmi të raportuar në vitin e fundit shkollor, 27% nuk i janë përgjigjur pyetjes duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë rast raportimi dhe 9% e tyre pohojnë se kanë më shumë se njëmbëdhjetë raste të raportuara.

Psikologët shprehen se me rritjen e moshës kontakti me të rriturit për të dyja gjinitë fillon të ulet dhe gjatë adoleshencës bashkëmoshatarët shërbejnë si një faktorë i fuqishëm socializues. Trysnia e tyre është më e fortë dhe më efektive sesa trysnia e prindërve ose e mësuesve. Kjo do të thotë se të rriturit brenda shkollës, në mënyrë që të kenë sukses, duhet t'i marrin parasysh diferencat gjinore dhe ato moshore, kur japin mesazhe apo kur krijojnë strategji kundërbulliste.

Gjithsesi një përqindje e mjaftueshme nxënësish që kanë qenë viktimë nuk kanë raportuar, gjë që duhet të tërheq vëmendjen e autoriteteve shkollore, pasi një gjë e tillë flet për faktin që viktimat nuk kanë besim ose nuk mendojnë se raportimi do ta ndryshonte situatën. Nga ana tjetër, kjo gjë i nxit agresorët që t'i vazhdojnë sjelljet e tyre abuzive ndaj bashkëmoshatarëve, pasi e dinë se nuk do merret asnjë masë kundër tyre.

Mësuesi është në vijën e parë të betejës kundër bullizmit. Por edhe psikologu, punonjësi social shkollor dhe prindëri duhet ti pyesin në mënyrë të vazhdueshme fëmijët rreth jetës së tyre në shkollë, sepse ata ka pak gjasa që rastësisht të tregojnë atë që i ka ndodhur.

Prania e disa treguesve, si: mungesa apo dëmtimi i gjërave personale, shenjat e pashpjegueshme të dhunës, gërricjet në lëkurë, izolimi social, shmangia e shkollës, humbja e interesit për të detyrat në shkollë, rënia nga mësimet, ankesat somatike, si dhimbje koke apo stomaku pa arsye, vështirësitë në të fjetur etj. janë tregues që çdo prind, mësues dhe profesionist duhet t'i ketë parasysh. Nëse këto shfaqen te fëmija, ata duhet ti eksplorojnë dhe t'i shkojnë më thellë çështjes, sepse secili nga elementet e mësipërme mund të tregojë se fëmija mund të jetë viktimë e potenciale e bullizmit (Limber, 2002).

4.2 Qëndrimet, besimet dhe reagimet e aktorëve të ndryshëm në shkollë (bashkëmoshatarët, mësuesit dhe prindërit) kundrejt sjelljeve bulliste

Një tregues që na paraqet se sa efektivisht shkolla e adreson bullizmin në mjediset e saj, është shkalla e reagimit të mësuesve dhe bashkëmoshatarëve ndaj bullizmit. Studimi nxorri një fakt shumë pozitiv: se në përgjithësi mësuesit, prindërit dhe më pak bashkëmoshatarët ndërhyjnë dhe reagojnë ndaj shfaqjeve bulliste në shkollë.

1. Bashkëmoshatarët

Empatia, në thelb, është aftësia për të vendosur veten në pozicionin e tjetrit. Pavarësisht se duhen më shumë të dhëna empirike për të studiuar efektet e mundshme që ka empatia në zvogëlimin e sjelljeve bulliste, është shpresëdhënëse fakti se shumica e nxënësve në këtë studim raportojnë ndjenja empatie kundrejt viktimave.

Nga studimi doli se 79% e nxënësve raportuan se në rastet kur janë ndodhur para një situatë bullizmi, atyre u ka ardhur keq dhe kanë dashur ta ndihmojnë nxënësin viktimë të kësaj dukurie, duke shprehur në këtë mënyrë një qëndrim në **përkrahje të viktimës**. Ky nivel i lartë empatie do të thotë se shumë nxënës nuk e pranojnë që bullizmi të ndodhë në shkollën e tyre. Megjithatë, pavarësisht niveleve të larta të empatisë, një numër i mjaftueshëm nxënësish, që kap një shifër prej 17%, kanë qëndrime në **përkrahje të agresorit**, duke u shprehur se viktima e meritonte të trajtohej në atë mënyrë ose se ata nuk ndienin asgjë për viktimën.

Ndërsa për sa i përket faktit se çfarë qëndrimesh mbajnë nxënësit kur kanë qenë dëshmitarë të veprimtarive bulliste, nga ky studim deli se 33.4% e nxënësve pohojnë se do ta ndihmonin nxënësin/nxënësen që po pëson bullizëm, nga ku vajzat zënë një përqindje më të lartë se djemtë. Ndërsa 13 % e nxënësve pohojnë se nuk bëjnë asgjë po mendojnë se duhet të ndihmojë nxënësin që po pëson bullizëm, 3% e tyre vetëm shikojnë dhe janë spektator pasivë të këtij fenomeni dhe 2% e nxënësve marrin pjesë në bullizëm ata janë spektatorë në mbështetje të agresorit, ku vendin më të madh e zënë djemtë.

Nëse ata që shkaktojnë bullizëm ose ata që e mbështesin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë bullizmin bëhen forca mbizotëruese në një klasë, atëherë ekziston rreziku që edhe kultura e bullizmit të bëhet po aq mbizotëruese. Djemtë janë më të prirë sesa vajzat që të mos reagojnë dhe janë gjithashtu më të prirë se vajzat të pohojnë se marrin pjesë në bullizëm, kur kanë një nxënës që nuk e pëlqejnë.

Gjithashtu, kur nxënësit u pyetën se sa kishin ndërhyrë bashkëmoshatarët në situata kur bullizmi ishte shfaqur në shkollë, rreth 19% e nxënësve kanë perceptimin se bashkëmoshatarët janë përpjekur *pothuajse gjithmonë* dhe *shpesh* të ndalojnë dukurinë e bullizmit. Ndërsa pjesa më e madhe, rreth 63%, pohojnë se bashkëmoshatarët nuk ndërhyjnë *asnjëherë* (28.2%), *ndonjëherë* (18.4%) dhe *rallëherë* (15.9%).

Kjo mospërputhje midis empatisë dhe reagimit tregon se nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë mjetet efektive për të ditur se si të veprojnë kur janë dëshmitarë të incidenteve bulliste (Ttofi and Farrington 2009, 2011). Studiues si Rigbi kanë zbuluar se një numër i lartë nxënësish dëshirojnë që kjo dukuri të mos shfaqet në shkollat e tyre por ndjehen të pafuqishëm për ta bërë një gjë të tillë, prandaj një pikënisje mjaft frytdhënëse do të ishte promovimi i veprimeve pozitive të dëshmitarëve/spektatorëve. (Rigby, 2012)

Sot, ndër studiuesit dhe politikbërësit, gjithnjë e më shumë po zë vend mendimi se ndërhyrjet në luftën kundër dukurisë së bullizmit duhet ta vënë më shumë theksin në nivel bashkëmoshatarësh sesa në nivel individual (viktime ose agresori), duke qenë se pjesa më e madhe e veprimtarive bulliste ndodhin në prani të nxënësve të tjerë dhe ka pak gjasa të ndodhë pa këta të fundit. Agresori është pjesërisht i motivuar nga kërkesa për status të lartë dhe për pozitë të fuqishme brenda grupit të tij bashkëmoshatar dhe është ky i fundit që luan rolin e rregullatorit për sjelljet abuzive që ngjasin ndërmjet pjesëtarëve të tij. Nëse agresorët

dëshirojnë status, atëherë ata zgjedhin viktimat që janë pasivë, të pasigurt në vetvete, fizikisht të dobët dhe me një fuqi të pakët ose në një pozitë përjashtuese nga grupi (Salmivalli & Isaacs, 2005). Duke dominuar viktimat të tilla, agresorët vazhdimisht mund t'ia tregojnë haptas fuqinë e tyre pjesës tjetër të grupit dhe kështu ata mund të riafirmojnë pozitën e tyre me status të lartë, pa pasur frikën e përballjes. Gjithashtu, studimet e ndryshme kanë treguar se më shumë se gjysma e incidenteve bulliste ndalon (58%), kur bashkëmoshatarët ndërhyjnë për të ndihmuar viktimën. (Hawkins, Pepler, & Craig, 2001).

Bashkëmoshatarët kanë fuqinë që ta ristrukturojnë dhe ta fuqizojnë mjedisin e shkollës, duke i mësuar nxënësit që t'i identifikojnë veprimet bulliste, të mësojnë se si të reagojnë ndaj bullizmit dhe se si të punojnë së bashku për të ulur mundësitë e shfaqjes së kësaj dukurie.

Një nga funksionet themelore të shkollës është që të sigurojë një mjedis të sigurt për të gjithë nxënësit. Një mënyrë që shërben për të matur klimën e sigurt dhe të shëndetshme në shkollë, është ajo e përcaktimit të përqindjes së nxënësve që shprehen se kanë frikë se mos bëhen objekt bullizmi në shkollë. Gjetjet e këtij studimi zbuluan se pjesa dërrmuese, rreth 60% e tyre shprehen se nuk kanë *kurrë* frikë se mos bëhen viktimat të bullizmit dhe vetëm 21 % e nxënësve kanë frikë *ndonjëherë* dhe *më shumë* se mos bëhen viktimat të bullizmit. Gjithashtu, pjesa më e madhe e prindërve (56%) pohojnë se ata nuk kanë kurrë frikë se mos fëmija e tyre bëhet viktimë e bullizmit, 35% e prindërve kanë frikë *ndonjëherë* dhe vetëm 9% e tyre pohojnë se kanë shpesh frikë. Kjo frikë mund të ketë pasoja negative në arritjet e rezultateve të dhura në procesin e të mësuarit.

2. Mësuesit

Për sa i përket ndërhyrjes së mësuesve, nga studimi doli se shumica e nxënësve (43.4%) kanë perceptimin se mësuesit janë përpjekur *gjithmonë* dhe *shpeshherë* që ta ndalojnë dukurinë e bullizmit. Ndërsa 45.5% kanë perceptimin se mësuesit nuk kanë bërë *asnjëherë*, *rallëherë* dhe *ndonjëherë* përpjekje për të ndaluar dukurinë e bullizmit, dhe 11.2 % e nxënësve nuk kanë preferuar ti përgjigjen kësaj pyetje.

Ndërsa kur agresori u pyet nëse mësuesi kujdestar apo ndonjë mësues tjetër ka kontaktuar me të rreth faktit që po ushtron bullizëm tek një ose disa nxënës të tjerë pjesa më e madhe e nxënësve në 33% të rasteve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje, e ndjekur nga nxënësit që pohojnë se *ata nuk kanë folur me mua për këtë çështje* në 28% të rasteve dhe vetëm 40% e agresorëve pohojnë se mësuesit kanë kontaktuar me ta *një herë* (20%) ose *disa herë* (20%) rreth faktit që po ushtrojnë bullizëm.

Pyetjes *“Sa besim kanë prindërit që shkolla e fëmijës së tyre e lufton me sukses bullizmin?”*, pjesa më e madhe e tyre pohojnë se *“kanë shumë besim”* (51%) dhe *“disi besim”* (29%), se shkolla do ta luftojë bullizmin dhe vetëm 12 % e prindërve pohuan se *“nuk kanë besim”*. Kjo tregon se prindërit besojnë shumë se shkolla e lufton bullizmin. Madje kur prindërit që kishin raportuar u pyetën se si e kishte trajtuar rastin shkolla, gjysma e prindërve (51%) pohuan se shkolla *mori masa dhe bullizmi ndaloi*, ndërsa 35% pohuan se *shkolla mori masa dhe bullizmi vazhdoi njësoj si më parë* dhe vetëm 10% e prindërve pohuan se *shkolla nuk mori asnjë masë*.

Mësuesit luajnë një rol jetësor në identifikimin e bullizmit dhe në ndërmarrjen e veprimeve që mund ta parandalojnë problemin që në hapat e parë. Mësuesit duhet të trajtohen në lidhje me format e bullizmit që shfaqen në shkolla dhe si të përballen me to.

Shpesh mësuesit janë në dijeni dhe ka raste që janë dëshmitarë dhe i lejojnë që këto sjellje të shfaqen, sepse ata nuk janë të trajnuar mjaftueshëm për të kuptuar problematikën e madhe që mbart ky fenomen. Por vlen të theksohet edhe fakti se është e vështirë që mësuesit të përfshihen dhe të edukohen plotësisht mbi çështjet e bullizmit, për shkak të natyrës së punës së tyre, e cila është shumë kërkuese dhe nën një trysni të madhe.

Megjithatë, nëse mësuesit ndërgjegjësohen me faktin se parandalimi i bullizmit në shkollë e përmirëson punën e tyre, ata do të jenë më të ndërgjegjësuar dhe të ndjeshëm ndaj sjelljeve agresive në shkollë. Mësuesit përqendrohen më shumë drejt mësimdhënies duke anashkaluar një ndër rolet themelore që luan shkolla në jetën e fëmijës atë të socializmit dhe të kujdesit social. Nxënësve u kërkohen standarde të larta për arritjet në mësimdhënie, por u kërkohet shumë pak arritja e standardeve nga ana sociale.

3. Prindërit

Prindërit luajnë një rol kryesor në fenomenin e bullizmit duke ndërmarrë veprime pozitive kundër bullizmit dhe duke u ndërgjegjësuar për sjelljen e fëmijës së tyre. Nëse ata vënë re ndryshime të jashtëzakonshme e të menjëhershme në sjelljen e përditshme të fëmijës, atëherë është shumë e rëndësishme ta eksplorojnë më tej atë. Ajo që doli nga studimi është se për të dyja gjinitë shumica e prindërve nuk kanë komunikuar me nxënësit për faktin se ata kanë qenë viktimë apo agresor në dukurinë e bullizmit.

Kështu, pjesa më e madhe e familjarëve të agresorit, në 32% të rasteve nuk kanë kontaktuar me shkollën, ndërsa 21% e tyre kanë kontaktuar një herë dhe 16% disa herë me shkollën.

Ndërsa kur pyeten viktimat e kësaj dukurie nëse ka kontaktuar ndonjë person madhor i familjes me shkollën për të ndaluar bullizmin duket se perceptimi i viktimave në 36% të rasteve është se familja nuk ka kontaktuar me shkollën, ndërsa 15% pohojnë se familja e tyre ka kontaktuar një dhe 24% disa here me shkollën për faktin se ai/ajo ishte objekt sulmi nga nxënësit e tjerë.

Për prindërit është shumë e rëndësishme përfshirja e tyre në jetën e fëmijës, në mënyrë që të kuptojnë se çfarë po ndodh në shkollë, si dhe t'i nxitin fëmijët që të jenë të hapur. Në fillim të adoleshencës dhe gjatë saj fëmijët kanë prirje që t'i mbajnë prindërit larg jetës dhe problemeve të tyre, por e rëndësishme është që prindërit të jenë vazhdimisht të pranishëm. Nëse një fëmijë në një çast të caktuar nuk dëshiron të shkojë në shkollë, të marrë pjesë në aktivitete sportive, të ndjekë një veprimtari sociale ose fillon të shfaqë simptoma psikometrike, atëherë prindërit duhet të shqetësohen dhe të fillojnë të eksplorojnë më tej këto shenja (Olweus, 2014).

4.3 Qëndrimet dhe perceptimet që kanë mësuesit mbi ekstremizmin e dhunshëm në shkollë

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi janë ndër sfidat më të mëdha të kohës sonë. Megjithëse ekstremizmi i dhunshëm nuk kufizohet në asnjë moshë, seks, grup apo komunitet, sipas studimeve të rinjtë janë veçanërisht të ndikueshëm ndaj mesazheve të dhunshme të ekstremistëve dhe organizatave terroriste. Përballë kërcënimeve të tilla, të rinjtë kanë nevojë për një edukim të përshtatshëm për të zvhilluar në kohën e duhur njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që mund t'i ndihmojnë ata të mos ndikohen ndaj një propagande të tillë.

Nxënësit, specifikiisht ato të shkollave të mesme, janë objektiva ideale për rekrutimin nga ana e ekstremistëve të dhunshëm, të cilët kërkojnë mbështetje për ideologjitë e tyre radikale. Shkollat duhet të mbeten vigjilente në edukimin e nxënësve për katalizatorët që nxisin ekstremizmin dhe pasojat potenciale që ka përqafimi i besimeve ekstremiste.

Sot, të rinjtë po hasen gjithnjë e më shumë me forma të ekstremizmit të dhunshëm, nga organizata terroriste apo lëvizje që ruajnë paragjykime ndaj të tjerëve për shkak të racës, fesë apo orientimit seksual. Të rinjtë e moshës 13-18 vjeç janë angazhuar aktivisht në aktivitete ekstremiste, duke përfshirë komunikimin në internet me grupe ekstremiste, duke udhëtuar në zonat e konfliktit apo duke u përfshirë në aktivitete të rekrutimit. Këta faktorë nënkuptojnë potencialin për rritje të rreziqeve brenda shkollave tona dhe komuniteteve lokale. (FBI, 2016)

Sipas tendencave të fundit ky kërcënim po zhvillohet me ritme të shpejta duke bërë që gjithnjë e më shumë të rinj të përqafojnë ideologjitë ekstremiste. Kjo ka shtuar një barrë në rritje për sistemin tonë arsimor, e cila duhet të ofrojë shërbime të përshtatshme për nxënësit që e shohin urrejtjen ose dhunën si rrugëdalje të vetme dhe të pranueshme për problemet e tyre.

Mësuesit tanë janë në një pozitë unike për të ndikuar ndryshimet, për të dhënë mesazhe afirmative ose për të lehtësuar aktivitetet e ndërhyrjes për shkak të ndërveprimeve të përditshme me nxënësit. Këto ndërveprime lejojnë vëzhgimin dhe vlerësimin e sjelljeve tek nxënësit që përqafojnë ideologjitë ekstremiste dhe përparojnë në trajektoren ndaj dhunës.

Roli i edukimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizimit të të rinjve kohët e fundit ka fituar pranim global. Edukimi, ndërtimi i aftësive dhe ndihma që duhet ti jepet nxënësit që ky i fundit të zhvillojë një mirëqenie sociale dhe emocionale janë komponentë thelbësorë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe llojeve të tjera të akteve të dhunshme. Këto masa parandaluese pakësojnë gjasat që shkollat të bëhen nyje potenciale të radikalizimit ose qendra të rekrutimit për ekstremistët e dhunshëm.

Kështu nga studimi doli se rreth 22% e mësuesve pohojnë se në shkollën e tyre nxënësit përdorin tema urrejtje ose ekstremiste, dhe 19% e tyre pohojnë se nxënësit kanë bërë mbishkrime me simbole, me shkrim apo vepra arti që promovojnë mesazhet ose imazhe ekstremiste dhe 18% e mësuesve mendojnë se nxënësit kanë akses në materiale ekstremiste online, duke përfshirë faqet e rrjeteve sociale. Ndërsa vetëm 12% e mësuesve pohojnë se kolegët e tyre përdorin terma urrejtje dhe ekstremiste.

Gjithashtu, pjesa dërrmuese e mësuesve në studim pohuan se në shkollë nuk ka intolerancë/ pandjeshmëri fetare, etnike apo gjinore si në marrëdhëniet mësues-nxënës; nxënës- nxënës, mësues-staf shkollor. Ajo që shfaqet më shumë është intoleranca/ pandjeshmëria gjinore (21%) dhe etnike (12%) midis marrëdhënieve nxënës-nxënës.

Rreth 90% e mësuesve mendonin se strategjia më efektive për të ndaluar shfaqjen e fenomeneve të tilla si intoleranca dhe ekstremizmit ishte *diskutimi me nxënësit për ekstremizmin e dhunshëm dhe pasojat e tij*, e ndjekur në 88% të rasteve nga *të mësuarit e nxënësve me teknikat për zgjidhjen e konflikteve duke përfshirë ndërmjetësimin*.

Mund të themi se nga studimi doli se në shkollat shqiptare kjo problematikë në rritje në botë nuk është shumë e pranishme pavarësisht se ekziston terreni që sjelle të tilla të bëhen më problematike nëse shkolla nuk është vigjilente dhe nuk merr masa.

Në manualin që UNESCO (2016)⁵¹ ka publikuar për mësuesit se si të ndalojnë sjelljet e ekstremizmit të dhunshëm pohohet se sjelljet e mëposhtme mund të jenë shenja që tregojnë që nxënësi mund të ketë filluar të përqafojë ideologji radikale dhe mësuesit dhe prindërit duhet të dinë ti identifikojnë dhe të marrin masa për ti ndaluar:

- Ndërprerje e papritur e lidhjeve me familjen dhe shoqërinë e vjetër.
- Braktisja e papritur e shkollës dhe konflikte të vazhdueshme në shkollë.
- Ndryshim i menjëhershëm në sjelljen që lidhet me ushqimin, veshmbathjen, gjuhën, financat.
- Ndryshimet në qëndrime dhe sjellje ndaj të tjerëve: komente antisociale, refuzimi i autoritetit, refuzimi për të bashkëvepruar në mënyrë shoqërore, shenjat e tërheqjes dhe izolimit.
- Shqyrtimi i rregullt i faqeve të internetit dhe pjesëmarrja në rrjetet e mediave sociale që shfaqin pikëpamjet radikale apo ekstremiste.
- Referenca ndaj teorive apokaliptike dhe konspiracioneve.

4.4 Politikat dhe ndërhyrjet që përdor shkolla në trajtimin e rasteve të bullizmit

Fenomeni i bullizmit do të vazhdojë të shfaqet dhe viktimat do të vazhdojnë të vuajnë, nëse shkollat nuk kanë një strategji dhe nuk zhvillojnë politika bashkëkohore për të krijuar një mjedis edukativ të sigurt dhe mbështetës, ku të sigurohet që çdo nxënës të jetë i pranuar dhe i përfshirë. Për parandalimin e bullizmit ka shumë programe, të cilat mund të zbatohen brenda shkollës (Garret, 2003), por studiuesit pohojnë se programet më të suksesshme për parandalimin e bullizmit janë ato që kërkojnë të ndryshojnë kulturën dhe klimën e shkollës. Që këto programe të jenë efektive, ato duhet të përfshijnë shkollën, familjen, klasën dhe vetë individët e përfshirë. Studiues si Rigby, Smithi dhe Pepleri (Rigby, Smith & Pepler, 2004) e përshkruajnë këtë metodë si “*përqasje mbarëshkollë*”, ku elementet e programit përzgjidhen në mënyrë të kujdesshme dhe bashkërendohen në nivele të ndryshme si në nivel politikash shkollërore ashtu edhe në nivel rregullor të klasës.

Ekzistenca e politikave kundër-bullizëm në shkolla

Në këtë studim, kur mësuesit u pyetën për ekzistencën e një politikë kundër bullizmit në shkollën e tyre pjesa më e madhe e mësuesve (56%) pohojnë se ata kanë politika kundër bullizmit në shkollën e tyre, 17% pohojnë se nuk kanë dhe 27% e mësuesve nuk janë në dijeni të këtij fakti.

Por, në dijeninë e studiuesve shkollat nuk kanë një politikë specifike kundër bullizmit duke nxjerr në pah se ndoshta mësuesit nuk e kanë shumë të qartë çfarë do të thotë pasja e një politikë të tillë. Mësuesit janë në dijeni të rregullores që ka shkolla dhe të politikave kundër dhunës por që nuk janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të trajtuar rastet e bullizmit që sikurse e kemi thënë përgjatë gjithë këtij raporti duhet të jenë të ndryshme nga rastet e

⁵¹ UNESCO (2016). “Teacher’s Guide on the Prevention of Violent Extremism”. Retrieved from: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf> in 22 March 2017

konflikteve të zakonshme që ndodhin në shkollë. Gjithashtu ajo që bie ndesh me faktin që gjysma e mësuesve mendojnë se ka politika kundërbulliste është se ku mësuesit pyeten se sa e shohin të nevojshme pasjen e politikave/ udhëzimeve kundër bulliste rreth 87% e tyre pohojnë se ka një nevojë shumë të madhe dhe vetëm 9% e mësuesve nuk janë shumë dakord me ekzistencën e politikave të tilla.

Ndërkohë që tërheq vëmendjen edhe fakti që një numër i konsiderueshëm mësuesish rreth 27%, nuk janë në dijeni nëse ekziston ose një politikë e tillë duke na çuar në idenë që shumë politika në shkollë hartohen nga një grup i vogël njerëzish sa për ti pasur në letër por që vështirë se vihen në zbatim. Në hartimin e politikave në shkollë duhet të përfshihen mësuesit, prindërit dhe nxënësit për të pasur një politikë sa më gjithëpërfshirëse dhe kjo politikë ti bëhet e njohur çdo personi që është përgjegjës për edukimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Studiues, si Pjetrovski dhe Huti (Piotroëski and Hoot, 2009) kanë pohuar se, në mënyrë që mësuesit të reagojnë në rastet e bullizmit, fillimisht ata duhet të marrin trajnime që t'i njohin këto lloj sjelljesh, të kuptojnë shkaqet, pasojat dhe masat që duhet të marrin hap pas hapi për t'i luftuar ato.

Pavarësisht se shumë studime pohojnë se bullizmi ka pasoja të rënda për viktimën, por edhe për agresorin, shumë mësues nuk marrin masa për ta parandaluar apo trajtuar atë. Kjo gjë ndodh sepse mësuesit mund të ndjejnë se nuk janë të pajisur me njohuri të mjaftueshme për t'u marrë me rastet e bullizmit dhe të tjerë mësues nuk janë të ndërgjegjshëm plotësisht për madhësinë dhe rëndësinë e problemit. Një ndërhyrje shumë ndihmuese në parandalimin e bullizmit, është trajnimi i personelit mësues rreth karakteristikave apo profilit tipik të nxënësve që janë viktimë dhe agresorë, për shembull, nëse një nxënës shfaq vetëbesim të ulët, ka më shumë të ngjarë të jetë pre e bullizmit. Kjo kategori nxënësish mund të identifikohet dhe të vëzhgohen vazhdimisht nga mësuesit dhe kur është e nevojshme të ndihmohen në mënyrë që të ndryshojnë për të përmirësuar situatën e tyre. Zakonisht këta nxënës janë të qetë, më të izoluar dhe kanë më pak kontakt me mësuesit, prandaj do të ishte shumë ndihmuese për ta që dikush t'i vinte re rrethanat ku ata ndodhen dhe t'u ofronte ndihmë.

Nga studimi doli se për sa i përket nivelit të trajnimeve që kanë marrë mësuesit për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të tilla vetëm 23 % e mësuesve pohuan se kishin marrë trajnime dhe 77 % e tyre nuk kishin pasur asnjë trajnim në lidhje me këtë fenomen. Duke theksuar nevojën shumë të madhe për zhvillimin profesional të mësuesve në fushën bullizmit ku edhe rreth 83% e mësuesve pohuan se do ishin shumë të interesuar të merrnin trajnime, në mënyrë që ta njihnin më mirë këtë dukuri dhe vetëm 7 % nuk ishin dakord në marrjen e trajnimeve të tilla.

Ndërhyrjet e shkollës ndaj dukurisë së bullizmit

Një ndihmë shumë e madhe për shkollën do ishte që të kishin një procedurë që të përshkruante hap pas hapi veprimet që duhet të ndiqnin kur një veprimtari bulliste shfaqet (Olweus, 1993). Kjo, sepse mund të ndodhë që mësuesit të mos dinë se si të ndërhyjnë sa më efektivisht në këto situata, për shembull, si t'i përjasen nxënësve që janë të përfshirë në këtë dukuri ose kur duhet të kërkojnë përfshirjen e prindërve, të drejtorisë së shkollës ose të psikologut, si dhe të punonjësve socialë shkollor.

Në studim ne i analizuar ndërhyrjet që marrin shkollat sipas katër niveleve. Për sa i përket ndërhyrjeve dhe masave parandaluese **në nivel shkolle** se pjesa më e madhe e mësuesve pohuan se masa që marrin më shpesh është *supervizimi efektiv i nxënësve jashtë klasës* në 39% të rasteve, **në nivel klase** pjesa më e madhe shkollave *kanë zhvilluar dhe vendosur rregulla në klasë*; **në nivel individual** pjesa më e madhe e mësuesve pohojnë se shkolla ofrojnë *këshillim individual për agresorin* në 59% të rasteve dhe në **nivel komuniteti** masat që merren shkolla në 23 % të rasteve është *ofrim i informacionit që i japin prindërve mbi fenomenin e bullizmit*.

Po të bëjmë një analizë se kush janë ndërhyrjet më të shpeshta që marrin shkollat na del që pjesa më e madhe realizojnë ndërhyrje kryesisht në nivel klase dhe individual si më poshtë:

1. Zhvillimi dhe vendosja e rregullave në klasë (75%)
2. Këshillim individual për nxënësit që kanë qenë agresorë (69%)
3. Këshillim individual për nxënësit që kanë qenë viktimë (61%)
4. Diskutime të rregullta në klasë rreth bullizmit (59%)

Ndërsa për sa i përket pyetjes se çfarë masash kanë marrë shkollat kur janë përballur me një incident bullist, 63 % e mësuesve pohojnë se e kanë referuar rastin tek drejtoria e shkollës, ndërkohë gjysma e mësuesve 50% pohojnë se e kanë referuar rastin tek punonjësi social dhe psikologu shkollor, dhe në 11% të rasteve nxënësit agresor nuk janë lejuar të marrin pjesë në aktivitet jashtëshkollore dhe si masa më pak e përdorur në 3 % të rasteve mësuesit pohojnë se nxënësit janë përjashtuar nga shkolla.

Sikurse duket nga të dhënat e studimit, shkolla ka një qasje individuale ku i trajton si të izoluara rastet e bullizmit. Kjo bie ndesh me përjashtimin mbarë-shkollore që promovohet nga studiuesit më në zë të kësaj fushe, e cila shihet si e vetmja mënyrë efektive për t'u përballur me agresivitetin në shkollë. Kjo metodë siguron një qëndrim të qartë të mësuesve ndaj bullizmit dhe i jep një mesazh të pakundërshtueshëm agresorëve, se sjellja e tyre dënohet nga të gjithë dhe se do të ketë masa ndëshkuese në vazhdim, nëse ajo përsëritet. Qasja mbarë-shkollore për të parandaluar bullizmin e lehtëson barrën e mësuesve për mënyrën se si ata duhet të reagojnë kur shfaqet një situatë e tillë.

Nëse shkolla do të kishte një politikë të caktuar dhe një kod sjelljeje që udhëheq parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj bullizmit dhe një komunitet mbështetës të shkollës, mësuesit do të ishin në gjendje që efektivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme t'i përballonin sjelljet bulliste. Mirëpo në shkollat e marra në studim nuk ekziston një politikë e tillë. Kjo sjell edhe pasigurinë, dhe mungesën e profesionalizmit në përgjigjet që mësuesit jepen në lidhje me reagimet ndaj bullizmit.

Duke u bazuar në gjetjet e mësipërme, mund të themi se do të ishte e arsyeshme organizimi i një fushatë për rritjen e ndjeshmërisë ndaj kësaj dukurie të nxënësit, të prindërit dhe të komuniteti, në mënyrë që dukuria e bullizmit, format e saj dhe pasojat që ka tek nxënësit të identifikohen dhe përvetësohen akoma më mirë.

Si përfundim, mund të themi se në shkollat shqiptare ka strategji të kufizuara për të parandaluar dhe trajtuar bullizmin. Aktualisht funksionon vetëm rregullorja e shkollës, që përfaqëson një formë politike disiplinimi e që tregon se nuk është shumë efektive për të trajtuar problemin në fjalë. Rregullorja që është sot në fuqi duket se është e paqartë në lidhje

me problemet e bullizmit dhe rrjedhimisht aspak efektive, sepse nuk siguron asnjë masë ligjore ose udhëzuese për nxënësit që janë të përfshirë në rastet e bullizmit. Megjithatë, problemi i bullizmit kërkon përpjekje të përqendruara nga të gjithë aktorët që janë të përfshirë dhe që kanë përgjegjësi për edukimin e fëmijëve.

Mësuesit, nëpërmjet kualifikimeve të ndryshme, duhet të njihen me ligjet dhe udhëzimet në fuqi që janë lidhura me mbrojtjen dhe me të drejtat e fëmijëve, ata duhet të ndërgjegjësohen për dhunën dhe dukurinë e bullizmit në të gjitha format që ajo shfaqet tek nxënësit. Është shumë i nevojshëm miratimi i rregulloreve apo udhëzimeve që i dënojnë fëmijët që përdorin dhunën, frikën, fyerjet ndaj nxënësve të tjerë apo mësuesve. Rregulloret e detyrueshme e që i përcaktojnë qartë këto të drejta dhe detyrime, duhet të jenë në dorë dhe në dijeni të të gjithëve: të nxënësve, të prindërve dhe të mësuesve të çdo shkolle. Ato duhet të bëhen publike, në mënyrë që edhe shkelja e këtyre rregulloreve të jetë krejtësisht e qartë dhe pa keqinterpretime.

5. BIBLIOGRAFIA

1. A. Laas; T. Boezaart (2014). "Legislative framework regarding bullying in South African Schools". Retrieved from :<http://dx.doi.org/10.4314/pej.v17i6.12>
2. Ahmad, Y., & Smith, P. K. (2006). Bullying in schools and the issue of sex differences. Retrieved from: John Archer (Ed.), *Male Violence*. London: Routledge
3. Archer, J., & Cote, S. (2005). Sex differences in aggressive behavior. In: Tremblay, R. E., Hartup, W. W., & Archer, J. (Eds.), *Developmental origins of aggression* (pp. 425-443). New York: Guilford Press.
4. Arseneault, L., Milne, B.J., Taylor, A., Adams, F., Delgado, K., Caspi, A., Moffitt, T.E., (2008). Being bullied as an environmentally mediated contributing factor to children's internalizing problems. *Archives of Pediatrics and Adolescent Medicine* 162, 145–150.
5. Baldry, A. C., & Farrington, D. P. (1999). Types of bullying among Italian school Children. *Journal of Adolescence*, 22: 423-426. 10.
6. Banks, S., Kaplan K., & Groves, M. (2001). Web Site Where Students Slung Vicious Gossip Is Shut Down. *Los Angeles Times*, p. A1.
7. Benton T. (2011). Sticks and stones may break my bones, but being on left on my own is worse: An analysis of reported bullying at school within NFER attitude survey. Slough: NFER
8. Bond, L., Carlin, J.B., Thomas, L., Kerryn R. and Patton G. (2001). Does bullying cause emotional problems? A prospective study of young teenagers. *BMJ*, 323, 480-484.
9. Boulton, M. J., & Smith, P. K. (1994). Bully/victim problems in middle-school children: Stability, self-perceived competence, peer perceptions, and peer acceptance. *British Journal of Developmental Psychology*, 12,315-329.
10. Ch. Sanderson; G.D. Phye (2004). *Bullying: Implications for the Classroom*. Academic Press.
11. Crick, N. R., & Grotpeter, J. K. (1995). Relational aggression, gender, and social psychological adjustment. *Child Development*, 66, 710–722.
12. Due P, Holstein BE, Lynch J, Diderichsen F, Nic Gabhain S, Scheidt P et al. Bullying and symptoms among school-aged children: international comparative cross sectional study in 28 countries. *Eur J Public Health* 2005;15(2):128–32. 2.
13. Department of Education and Skills. (2013). "Anti bullying policy for primary and post primary school". Retrieved from <http://www.solaschriost.ie/files/resource-Anti-Bullying-Procedures-for-Primary-and-Post-Primary-Schools-DWEC-Princ.doc>
14. E. Ismaili (2015) "Bullying in secondary schools of Tirana". Doctoral thesis. Retrieved from: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/2015/09/doktoratura-emanuela-ismaili>
15. Egan, S. K., & Perry, D.G. (1998). Does low self-regard invite victimization?. *Developmental Psychology*, 34, 299-309.
16. Espelage, D. L., & Swearer, S. M. (2003). Research on school bullying and victimization: What have we learned and where do we go from here?. *School Psychology Review*, 32, 365-383.
17. Fabre-Cornali, D., Emin, J-C., & Pain, J. (1999) France. In P. K. Smith, Y. Morita, J. Junger-Tas, D. Olweus, R. Catalano, & P. Slee (Eds.), *The nature of school bullying: a cross-national perspective*. London: Routledge. Pp. 128-139.

18. Flynt, S. W. & Morton, R. C. (2008). Alabama elementary principals' perceptions of bullying. *Education*, winter, 187–191
19. Frissen, J. P. (2007). Adolescents' Perception of Bullying: Who is the Victim? Who is the Bully? What can be done to stop the Bullying? *Adolescence*, 749-761
20. Garbarino, James & deLara, Ellen (2002). *And Words Can Hurt Forever: How to Protect Adolescents from Bullying, Harassment, and Emotional Violence*. New York: The Free Press.
21. Georgiou, St., & Stavrinides, P. (2013). Parenting at home and bullying at school. *Social Psychology of Education: An International Journal*.
22. Haynie DL, Nansel T, Eitel P, Crump AD, Saylor K, Yu K et al. Bullies, victims, and bully/victims: distinct groups of at-risk youth. *J Early Adolesc*. 2001;21(1):29.
23. Henkin, R. (2005). *Confronting bullying: Literacy as a tool for character education*. Portsmouth, NH: Heinemann.
24. Hindjua, S., & Patchin, J.W. (2010). Cyber bullying: An exploratory analysis of factors related to offending and victimization. *Deviant Behavior*, 29, 129-156.
25. Hodges, E. V. E., Malone, M. J., & Perry, D. G. (1999). Individual risk and social risk as interacting determinants of victimization in the peer group. *Developmental Psychology*, 33, 1032-1039.
26. Hoover, J.H., Oliver, R.L., & Thomson, K.A. (1993). Perceived victimization by school bullies: New research and future direction. *Journal of Humanistic Education and Development*, 32, 76-84.
27. Janowski, A. & Poland (2003). In Smith, P. K., Morita, Y., Junger-Tas, J., Olweus, D., Catalano, R., & Slee, P. (Eds.), *The nature of school bullying: a cross-national perspective*. London: Routledge. Pp. 264-275.
28. Kaltiala-Heino R, Rimpelae M, Rantanen P, Rimpelä A. Bullying at school – an indicator of adolescents at risk for mental disorders. *J Adolesc*. 2000;23(6):661–74.
29. Kochenderfer, B. J., & Ladd, G. W. (1997). Peer victimization: Cause or consequence of school maladjustment?. *Child Development*, 67, 1305– 1317.
30. Koo, H. (2007). A Time Line of the Evolution of School Bullying in Differing Social Context. *Asia Pacific Education Review*, Vol. 8, No. 1, 107-116. Retrieved from <https://webpace.utexas.edu/lab3346/School20Bullying/Koo2007>
31. Limber, S. P., & Small, M. A. (2003). State laws and policies to address bullying in schools. *School Psychology Review*, 32, 445–455.
32. Lösel, F., & Bliesener, T. (1999) Germany. In : Smith PK, Morita Y, Junger-Tas J, Olweus D, Catalano R, Slee P, editors. *The nature of school bullying: a crossnational perspective*. London and New York: Routledge. fq 224–249
33. M. Cabran; M. Finelli; B. Bradford (2015) " Mapping and Analysis of the Albania CP System". Maestral International. Retrived from: <https://www.unicef.org/albania/CPS-report2015.pdf>
34. Moon, B., Hwang, H.W., and McLuskey, J.D. (2008). Causes of school bullying. *Crime and delinquency*. Vol. XX Number X Sage publication.
35. Nansel TR, Craig W, Overpeck MD, Saluja G, Ruan WJ, the HBSC Bullying Analyses Working Group. Cross-national consistency in the relationship between bullying behaviors and psychosocial adjustment. *Arch Pediatr Adolesc Med*. 2004;158(8):730–36. 3.

36. Nansel, T. R., Overpeck, M., Pilla, R. S., Ruan, W. J., Simons-Morton, B., & Scheidt, P. (2001). Bullying behaviors among US youth: Prevalence and association with psychosocial adjustment. *Journal of the American Medical Association*, 285: 2094
37. Olafsen, R.N. & Viemro, V. (2000). Bully/victim problems and coping with stress among 10- to-12 year old students in A land, Finland. *Aggressive Behaviour*, 26, 5665.
38. Olweus, D. (1994). Annotation: Bullying at school: Basic facts and effects of a school based intervention program. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 35, 1171-1190.
39. Olweus, D. (1997). Bully/victim problems in school: facts and intervention. *European Journal of Psychology of Education* 12: 495.
40. Olweus, D. (2001). Bullying at School: Tackling the Problem. E aksesushme me 05.06.2014: <http://www.ocedbystander.org/news/fullstory.php/aid/434>
41. Olweus, D. (2001). Bullying at School: Tackling the Problem. E aksesushme me 05.06.2014: <http://www.ocedbystander.org/news/fullstory.php/aid/434/> 181.
42. Olweus, D., & Limber, S. P. (2009). The Olweus Bullying Prevention Program: Implementation and Evaluation over Two Decades. *Tek Handbook of Bullying in Schools*, edited by S. R. Jimerson, S. M. Swearer, and D. L. Espelage, 377–402. New York: Routledge.
43. Olweus, D., (1991). Bully/victim problems among school children: Basic facts and effects of a school based intervention program. In D. Pepler & K. Rubin (Eds.), *The Development and Treatment of Childhood Aggression*, Hillsdale, NJ: Erlbaum, 411-448.
44. Ortega, R., & Mora-Merchan, A. (1999) Spain. In P. K. Smith, Y. Morita, J. Junger-Tas, D. Olweus, R. Catalano, & P. Slee (Eds.), *The nature of school bullying: a cross-national perspective*. London: Routledge. pg. 157-173. 188.
45. P. K. Smith; H. Cowie, R. F. Olafsson; A P. D. Liefoghe (2002). Definitions of Bullying: A Comparison of Terms Used, and Age and Gender Differences, in a Fourteen-Country International Comparison. Volume 73, Issue 4. 10.1111/1467-8624.00461
46. P. Smith (2014). *Understanding School Bullying: Its Nature and Prevention Strategies*. Saga Publication.
47. Piotrowski, D. & Hoot, J. (2009). Bullying and Violence in Schools: What Teachers Should Know and Do. *Childhood Education*, 84 (6): 357-363.
48. Plan of Action to Prevent Violent Extremism. Report of the Secretary-General (A/70/674) http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf
49. Rigby, K., Smith, P.K & Pepler, D. (2004). *Bullying in schools, how successful can interventions be?*. Cambridge: Cambridge University Press.
50. Salmivalli C., Huttunen A., Lagerspetz K.M.J. (2005). Peer networks and bullying in school. *Scandinavian Journal of Psychology*, 38 (4) 305-312. 225.
51. Salmivalli, C., Lagerspetz, K., Björkqvist, K., Österman, K., & Kaukiainen, A. (1996). Bullying as a group process: participant roles and their relations to social status within the group. *Aggressive Behavior*, 22, 1-5
52. Seals, D., & Young, J. (2003). Bullying and victimization: Prevalence and relationship to gender, grade level, ethnicity, self-esteem, and depression. *Adolescence*, 38, 735-747.
53. Selekman, J., & Vessey, J. (2004). Bullying: It isn't what it used to be. *Kidbits Vol 30 No 3*. 241. Sharp, S. (1995).

54. Sheras, P. (2002). Characteristics, environmental factors, and interventions for bullies/victims. *You're Child: Bully or Victim?. Understanding and Ending School Yard Tyranny*. 1-9, 13, 40-57, 59-64, 71, 73-82, 85-91, 171-176.
55. Smith & Shu, S. (2000). What good schools can do about bullying: Findings from a survey in English schools after a decade of research and action. *Childhood* 7:193–212.
